



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

PARABURGIMI NË SHQIPËRI

RAPORT STUDIMOR

MBI STANDARTET
NDËRKOMBËTARE DHE
SFIDAT E SISTEMIT TONË
TË DREJTËSISË



Komiteti Shqiptar i Helsinkit

RAPORT STUDIMOR

PARABURGIMI NË SHQIPËRI

**(MBI STANDARTET NDËRKOMBËTARE DHE SFIDAT E SISTEMIT TONË TË
DREJTËSISË)**

Publikuar në, Maj 2020

Ky publikim është realizuar në kuadër të zbatimit të projektit të mbështetjes institucionale nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), financuar nga Open Society Foundations (OSF).

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH-së) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Përgatitën raportin:

Av. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH
Dr. Klodian Rado, Ekspert Ligjor
Prof.Dr Sokol Berberi, Ekspert Ligjor

**Ekspertët e angazhuar për
studimin e vendimeve gjyqësore:**

Av. Entela Memishaj, Eksperte Ligjore
Prof.Asoc.Dr Klodian Skënderaj, Pedagog (UT)
Prof.Dr Sokol Mëngjesi, Pedagog, Fakulteti i
Drejtësisë (UT)
Z. Elvis Koçi, Ekspert Ligjor
Znj. Blerina Çinari, Eksperte Ligjore

Konsulencë Ligjore:

Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Autor: @ Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Publikuar në, Maj 2020

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Ap. 10, K 5,

P.O BOX 1752

Tirana, Albania

Tel / Fax ++355 (0)4223 36 71, ++355 (0) 69 407 57 32

web address: www.ahc.org.al E-mail office@ahc.org.al

[https:// www/facebook.com /Komiteti Shqiptar i Helsinkit](https://www.facebook.com/Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit)

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Hyrje.....	5
2. Përmbledhje ekzekutive	7
3. Metodologjia.....	13
4. Legjislacioni ndërkombëtar dhe vendas.....	16
4.1 Hyrje	16
4.2 Vendimarrja për arrestin në burg dhe garancitë procedurale.....	17
4.3 Arsyetimi i vendimeve për masën e arrestit në burg.....	26
4.4 Masat alternative	30
4.5 Rishikimi.....	34
4.6 Përfundime dhe Rekomandime.....	40
5. Statistika zyrtare dhe vështrim mbi zbatimin e arrestit në burg dhe alternativat e tij, në nivel kombëtar	42
6. Gjetjet e rezultuara nga monitorimi i seancave gjyqësore për masat e sigurimit personal (në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës)	50
6.1. Objekti i monitorimit	50
6.2. Objekti i kërkesës së Prokurorisë.....	51
6.3 Aspektet e procesit të rregullt gjyqësor dhe mbarëvajtja e proceseve gjyqësore për masat e sigurimit personal	52
6.4 Kategorizimi i të dhënave të personave ndaj të cilëve janë kërkuar dhe/ose caktuar masa të sigurimit personal.....	56
6.5 Vendimarrja e gjykatës	58
7. Gjetjet e rezultuara nga studimi sasior dhe cilësor i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës.....	60
7.1 Objekti i studimit	60
7.2 Mbrojtja me avokat	61
7.3 Zhvillimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm (afati i parashikuar në K.Pr.P)	67
7.4. Barazia e armëve juridike	67
7.5 Respektimi i kushteve për caktimin e masave të sigurimit personal	69
7.6 Respektimi i kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal	74
7.7 Kategorizimi i të dhënave të personave ndaj të cilëve janë kërkuar dhe/ose caktuar masa të sigurimit personal.....	81
7.8 Vendimarrja e Gjykatës	84
7.9 Zgjatja e paraburgimit.....	92

7.10 Informacioni me shkrim nga prokuori	95
7.11 Revokimi apo zëvendësimi i masës së sigurimit (Subjekti kërkues).....	95
8. Rekomandime.....	97
8.1 Rekomandime për Kuvendin / Ministrinë e Drejtësisë.....	97
8.2 Rekomandime për Gjykatat	100
8.3 Rekomandime për Prokurorinë	101
8.4 Rekomandime për Institucionet e Policisë së Shtetit.....	102
8.5 Rekomandime për strukturat e Avokatisë/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas	103
8.6 Rekomandime për Shkollën e Magjistraturës	103
Aneksi I	105
Situata e Mbipopullimit të personave me masë sigurie “Arrest në Burg” në IEVP Vaqarr, Mine Peza, Jordan Misja dhe Durrës për periudhën 2015-2016.....	105
Aneksi II.....	109
Neni 5 KEDNJ në vështrim të Jurisprudencës së GJEDNJ-së deri në fund të vitit 2016.....	109

1. Hyrje

Të dashur lexues,

Standardet ndërkombëtare inkurajojnë me forcë mos përdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykitimit penal, deri në dhënien e vendimit. Heqja e lirisë duhet të zbatohet vetëm kur masat jokufizuese të lirisë nuk mjaftojnë.

Në rastet përjashtimore, kur kufizimi i lirisë vlerësohet si i domosdoshëm, ai duhet të garantojë respektimin e të drejtave dhe garancive me natyrë procedurale të parashikuara në aktet ndërkombëtare ku vendi ynë ka aderuar, si dhe në legjislacionin tonë brendshëm.

Përkundrejt standarteve ndërkombëtare, përdorimi i tepruar i arrestit në burg në vendin tonë evideton një njohje jo të mirë të tyre nga aktorët e sistemit të drejtësisë penale (avokatë, prokurorë dhe gjyqtarë). Megjithatë, roli i gjykatave ngelet themelor, jo vetëm për korigjimin e veprimeve procedurale të kryera nga prokuroria dhe policia, por sidomos për garantimin e lirive dhe të drejtave themelore si dhe të parimeve të shtetit të së drejtës.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në përputhje me misionin e tij prezanton këtë raport studimor, i cili analizon aktet më të rëndësishme ndërkombëtare që njohin dhe promovojnë të drejtën për liri dhe siguri, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, legjislacionin tonë të brendshëm në këtë fushë, raportet e organizatave ndërkombëtare dhe të institucioneve vendase si Komiteti për Parandalimin e Torturës, Departamentit Amerikan të Shtetit, Komisionit Evropian, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Avokatit të Popullit, të dhënat zyrtare të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, etj.

Një shtyllë të rëndësishme të këtij raporti përbëjnë gjetjet dhe analiza e kujdesshme e të dhënave sasiore dhe cilësore që kanë rezultuar nga monitorimi i seancave gjyqësore dhe vendimet gjyqësore për vleftësimin e arresimit ose të ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit, në dy Gjykatat më të mëdha të vendit (Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës). Monitorimi i KShH-së nuk ka qënë i lehtë dhe është i pari i këtij lloji që realizohet në vendin tonë. Monitorimi merr shkas nga gjendja shqetësuese e mbipopullimit në sektorët apo institucionet e paraburgimit.

Gjetjet dhe rekomandimet e pasqyruara në këtë raport shpresojmë të kontribuojnë pozitivisht për aktorët e sistemit të drejtësisë penale për një njohje dhe zbatim më të mirë të legjislacionit procedural-penal si dhe standarteve ndërkombëtare, me qëllim që kufizimi ekstrem i lirisë në kuadër të një procesi penal, veçanërisht në formën e “arrestit në burg” të bëhet në raste përjashtimore. Përveç rekomandimeve drejtuar gjykatës dhe prokurorisë, ky raport përmban një sërë rekomandimesh drejtuar edhe institucioneve të pushteteve të tjera si Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, të cilat mund të kontribuojnë në përputhje me kompetencat e tyre për të përmirësuar dhe qartësuar më tej legjislacionin proceduralo – penal lidhur me dispozitat për masat e sigurimit personal, lidhur me mënyrën e caktimit të avokatëve kryesisht referuar dispozitave në legjislacionin për ndihmën juridike të garantuar

nga shteti dhe aktet nënligjore të tij, etj. Gjithashtu, rekomandime të veçanta i janë drejtuar me anë të këtij raporti, Shkollës së Magjistraturës, organeve drejtuese dhe vendimmarrëse të avokatisë, duke përfshirë këtu edhe Shkollën e Avokatisë, Drejtorisë së ndihmës juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë, Akademisë së Sigurisë në Policinë e Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Gjej rastin të falenderoj për kontributin profesional, ekspertët dhe monitoruesit e angazhuar në monitorimin e seancave gjyqësore, studimin e vendimeve gjyqësore, studimin e legjislacionit ndërkombëtar, përpunimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, dy kryetaret e gjykatave të monitoruara (Tiranë dhe Durës) në periudhën përkatëse, Znj. Enkelejdi Hajro dhe Znj. Joana Qeleshi si dhe stafin administrativ të këtyre gjykatave, stafin ekzekutiv të KShH-së për koordinimin dhe mbarëvajtjen e procesit të monitorimit, si dhe Open Society Foundations për mbështetjen institucionale që bëri të mundur realizimin e kësaj nisme.

Singerisht,

Erida Skëndaj
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

2. Përmbledhje ekzekutive

Në problematikën e përcjellë në këtë raport studimor, KShH është ndalur fillimisht tek analiza e akteve ndërkombëtare, jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, tek gjetjet dhe të dhënat e pasqyruara për vendin tonë në raportet e organizatave ndërkombëtare dhe të institucioneve vendase në këto tre katër vitet e fundit (2016 – 2019), si Komiteti për Parandalimin e Torturës, Departamenti Amerikan i Shtetit, Komisioni Evropian, Ministria e Drejtësisë, Prokurori u Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, etj. Në mënyrë të përmbledhur, nga kjo analizë rezulton se:

i. Përdorimi i zgjeruar i arrestit në burg (paraburgimit) shpesh është një simptomë e mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale, që mund të rezultojë në mungesë të mbrojtjes së të drejtave të të paraburgosurve. Kjo mund të sjellë trajtimin e tyre ç'njerëzor dhe degradues, si rezultat i kushteve të dobëta infrastrukturore që kanë një pjesë e institucioneve në sistemin tonë të burgjeve dhe si rezultat i kapaciteteve të kufizuara për akomodimin e këtyre shtetasve, duke krijuar në jo pak raste mbipopullim shqetësues.

ii. Monitorimet e kryera në dekadën e fundit nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Avokati i Popullit evidentojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të ndaluar, arrestuar në flagrancë dhe të paraburgosur në sistemin e burgjeve, të tilla si keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit në flagrancë, të ndalimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë (në disa raste në mungesë të avokatit), mosnjohje me të drejtat dhe garancitë ligjore, tejkalim i afateve ligjore të ndalimit/arrestimit në flagrancë deri në kontrollin e tyre nga gjykata, trajtim jo human në mjediset e organeve të policisë apo në dhomat e paraburgimit, fjetje në tokë në dhoma në kapërcim të kubaturës së lejuar, duke krijuar mbipopullim shqetësues, etj.

iii. Paraburgimi, kur nuk respektohen standartet ndërkombëtare dhe legjislacioni ynë i brendshëm (Kodi i Procedurës Penale), përveç se rezulton me shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ka gjithashtu një kosto tepër të lartë për buxhetin e shtetit. Kostoja ditore e shpenzimeve për mbajtjen e një të paraburgosuri në sistemin tonë penitenciar gjatë vitit 2019 është 2,910 Lek të reja. Kostoja totale financiare në buxhetin e shtetit, për akomodimin e personave të paraburgosur në vendin tonë për vitin 2019, paraqitet në nivele të larta, përkatësisht rreth 2.29 miliard Lek (të reja).

iv. Në dt.1 Janar të vitit 2019, në sistemin tonë të burgjeve figurojnë të akomoduar në total 5580 shtetas. Raporti midis shtetasve të dënuar dhe atyre të paraburgosur të akomoduar në këtë sistem, po në këtë datë, paraqitet mjaft i ngushtë. Konkretisht, 2268 persona ose 40.6% janë shtetas ose individë të paraburgosur dhe 3033 ose 54.3% janë shtetas apo individë të dënuar. Përgjatë 12 muajve të vitit 2019, në sistemin e burgjeve ka patur 3864 pranime të reja. Nga kjo shifër, përkatësisht 3258 individë ose 84.3% e numrit total përbëhet nga persona të paraburgosur.

v. Referuar të dhënave në raportet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në vend, për vitin 2018 dhe për vitin 2019, evidentohet se është ndjekur një politikë penale më e butë ndaj të miturve në konflikt me ligjin (të pandehur), përfshi këtu

edhe politikën e ndjekur për masat e sigurimit që janë kërkuar nga prokurori për këtë kategori. Kjo në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, i hyrë në fuqi me datë 1 Janar 2018. Zbatimi i masës së arrestit në burg ndaj të miturve për vitin 2018, paraqitet në masën 5.18%, krahasimisht në një nivel pak më të ulët në krahasim me vitin 2019 (6%).

vi. Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson se rekomandimet e Kuvendit drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të ashpërsuar politikën penale në drejtim të masave të sigurimit, nuk marrin në konsideratë standartet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut që inkurajojnë se masa e sigurimit “arrest në burg” duhet të aplikohet si një masë e fundit dhe në raste përjashtimore.

vii. Referuar të dhënave të ofruara në vjetarin statistikor të Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se gjatë vitit 2016, 39% e të pandehurve kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”; gjatë vitit 2017 (po në këtë vit apo të mbartura nga vitet e tjera), 37% e të pandehurve kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg” dhe gjatë vitit 2018 kemi një rënie më të ndjeshme të të pandehurve me këtë masë, në nivelin 28.9%. Këto të dhëna përfshijnë edhe të pandehurit, çështjet penale të të cilave mbarten në vitin pasues. Edhe pse kemi një rënie të ndjeshme të numrit total të paraburgosurve në vitin 2018, sërish vërehet se “arresti në burg” është masa që është aplikuar më së shumti në krahasim me masat e tjera të sigurimit personal nga gjykatat tona.

viii. Monitorimet ndër vite të KShH-së në sistemin e burgjeve evidentojnë se një pjesë e individëve të paraburgosur i përkasin grupeve në nevojë, të cilat përballen me vështirësi të shumta të natyrës sociale-ekonomike dhe kryesisht janë përfaqësuar në proceset e tyre për masat e sigurimit por edhe në procesin penal, nga avokat të caktuar nga shteti. Një pjesë e këtyre individëve janë paraburgosur për vepra penale që nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore.

Një shtyllë të rëndësishme të këtij raporti studimor përbëjnë gjetjet dhe analiza profesionale e të dhënave sasiore dhe cilësore që kanë rezultuar nga monitorimi i 400 seancave gjyqësore në periudhën Shkurt – Prill 2017, si dhe studimi i 1821 vendimeve gjyqësore, për vleftësimin e arresimit ose të ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit, në dy Gjykatat më të mëdha të vendit (Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës). Monitorimi i KShH-së nuk ka qënë i lehtë dhe është i pari i këtij lloji që realizohet në Shqipëri. Mangësitë e konstatuara në praktikën e prokurorisë dhe të gjykatës lidhur me përdorimin e arrestit në burg, edhe pse të hershme në kohë, vijojnë të mbeten aktuale për sistemin e drejtësisë dhe kërkojnë reflektimin serioz të aktorëve të këtij sistemi, avokatëve si dhe të aktorëve të tjerë, përfshi këtu Kuvendin dhe Ministrinë e Drejtësisë. Të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara, nga vëzhguesit dhe ekspertët e KShH-së evidentojnë në mënyrë të përmbledhur se:

i. Në 2015-ën, një vit pas ndryshimeve në Kodin Penal, vërehet një rritje të numrit të ndalimeve/ arrestimeve nga policia dhe prokuroria, për personat e dyshuar për vepra me rrezikshmëri jo të lartë shoqërore, të parashikuara në nenin 137 të Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” dhe nenin 291 “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (vepra të kriminalizuara ose të ashpërsuara në masën e dënimit me

ndryshimet që pësoi Kodi Penal në vitin 2014). Për një numër të konsiderueshëm të këtyre shtetasve që ndalohehin/arrestoheshin në flagrancë për këto vepra, prokuroria kërkonte caktimin e masës “arrest në burg” dhe gjykata vendoste pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe rrjedhimisht caktimin e kësaj mase.

ii. Studimi evidenton se, arresti në burg aplikohet në masë të konsiderueshme edhe për “Dhunën në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për veprat penale për vjedhjen e pasurisë, të parashikuara nga nenet 134, 135, 136, 137 të Kodit Penal, si dhe për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuara nga neni 283 dhe neni 283/a i Kodit Penal.

iii. Shumica e problemeve të evidentuara për aplikimin e tepruar të masës “arrest në burg” janë të lidhura me zbatimin dhe interpretimin e gabuar të legjislacionit procedural penal në fuqi, si dhe nivele të ulëta të njohjes dhe për rrjedhojë edhe të referimit të praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Pasojat e zbatimit/interpretimit të gabuar të ligjit apo njohurive të cekëta mbi të nga aktorët e sistemit të drejtësisë, janë të tilla që çenojnë drejtpërdrejtë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

iv. Edhe pse ky raport studimor ka në fokus masat e sigurimit personal, kryesisht nga këndvështrimi i pushtetit gjyqësor, problemet në lidhje me këto masa shtrihen përtej gjykatave, duke përfshirë edhe organin e akuzës dhe policinë gjyqësore. Problemet e shfaqura nga këta dy aktorët e fundit mund të konsiderohen edhe më të rënda se sa të gjyqësorit.

v. Si rregull, seanca duhet të bëhet publike, përveç rastit kur, për arsye të parashikuara nga ligji, gjykata vendos që seanca të zhvillohet e mbyllur. Sipas Kodit të Procedurës Penale nuk zhvillohet seancë publike dhe nuk kërkohet marrja e një vendimi për të zhvilluar seancë me dyer të mbyllura. Por, KShH është ndeshur me praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që një pjesë të këtyre seancave i zhvillonte pa pjesëmarrjen e publikut, duke mos e justifikuar me vendim përkatës zhvillimin e procesit me dyer të mbyllura. Mgjth, stafi i KShH-së pati akses në realizimin e monitorimit të seancave në këtë gjykatë, në sajë të marrëveshjes me kryetaren e gjykatës.

vi. Në kampionet e seancave gjyqësore të monitoruara për vitin 2015 u vërejt se 56.5% e personave ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit mbrohen me avokat privat dhe 40.2% mbrohen me avokat të caktuar kryesisht. Në pothuajse të njëjtat raporte rezulton ndarja me avokat të zgjedhur dhe ata të caktuar kryesisht, edhe për seancat gjyqësore të monitoruara për vitin 2017 (shkurt-prill). Konkretisht, rreth 57.8% e personave janë përfaqësuar me avokat të zgjedhur ndërkohë që vijon të ketë një numër të lartë personash të përfaqësuar me avokat të caktuar kryesisht, përkatësisht 39%. Tërheq vëmendje gjithashtu fakti se një numër i ulët avokatësh të caktuar kryesisht marrin pjesë në seancat gjyqësore më të njëjtët prokurorë dhe gjyqtarë, duke i dhënë karakter mekanik procesit. Vëzhguesit e KShH-së vërejtën tendencën e monopolizimit të skemës për caktimin e avokatëve kryesisht në këto seanca, të cilët kanë qenë pothuaj të njëjtët, në total rreth 6 avokatë.

vii. Në tërësi, proceset e monitoruara dhe vendimet e studiuara evidentojnë se mbrojtja e personave në seancat lidhur me vleftësimin e ndalim/arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ka karakter formal, nuk është cilësore dhe rrjedhimisht nuk është efektive. Kjo ka ndikuar negativisht duke sjellë pasoja edhe në nivelet e larta të paraburgimit në vendin tonë. Në rreth gjysmën e vendimeve të studiuara (51.8%), mbrojtja ka pretenduar se nuk ishte njohur me materialet e organit të akuzës. Në 72% të rasteve avokati mbrojtës nuk ka paraqitur prova për të mbrojtur të drejtat/interesat e personit të ndaluar/arrestuar në këto seanca. Veçanërisht kur mbrojtësit janë caktuar kryesisht, shpesh ka rezultuar se nuk është studiuar dosja apo çështja më parë nga ana e tyre, nuk është realizuar asnjë takim apo bisedë me personin nën hetim për të hartuar/diskutuar së bashku me të strategjinë e mbrojtjes. Kjo vjen përveç të tjerash edhe për arsye praktike, pasi mbrojtësit e caktuar kryesisht nga ana e gjykatës nuk kanë patur mundësi objektive të flasin me vetë personin e ndaluar/arrestuar apo me familjarët e tyre. Këto të dhëna evidentojnë në përgjithësi një mbrojtje jo aktive, jo efektive dhe shpesh herë edhe formale.

viii. Një fenomen i vërejtur rëndom në vendimet e studiuara është se edhe në ato raste kur gjykata nuk e ka vleftësuar si të ligjshëm “arrestin në flagrancë” të personit, ajo ka vijuar në caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg” pa vendosur më parë lirinë e tij të menjëhershëm, në kundërshtim me nenin 259/4 të KPrP.¹ Gjithashtu janë vërejtur raste kur gjykata ka vleftësuar “arrestin në flagrancë”, ndërkohë që faktet dhe provat lidhur me çështjen nuk vërtetojnë ekzistencën e kushteve të domosdoshme për gjendjen e flagrancës, të parashikuara në nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale.

ix. Në praktikën gjyqësore është vërejtur gjithashtu mungesë konsistence në kërkimin nga prokuroria dhe vendimmarrjen e gjykatës për masat e sigurisë për vepra të ngjërta ose kur autorët e dyshuar kanë patur profil të ngjashëm e rrezikshmëri të ulët.

x. Gjatë studimit, janë ndeshur raste kur mund të shmangej nga aktorët e sistemit të drejtësisë kërkimi / caktimi i masës “arrest në burg” dhe të zbatoheshin alternativat më të lehta të kësaj mase, veçanërisht kur autorët e akuzuar të veprave penale kanë qënë gra, të moshuar apo të sëmurë. Gjendja shqetësuese e mbipopullimit në sistemin e burgjeve si dhe efektet negative që ka ky sistem, sidomos tek të miturit dhe të rinjtë, nuk janë konsideruar asnjëherë të vetme nga gjykata.

xi. Trajtimi i të miturve kërkon një vëmendje dhe vlerësim të veçantë duke patur në konsideratë nevojat e tyre sociale dhe edukative, të cilat nuk mund të plotësohen efektivisht në kushtet e kufizimit të lirisë. Caktimi i masës së sigurisë “arrest në burg” për kategorinë e të miturve dhe të rinjve nën 21 vjeç (jean juvenile) mund të ishte më i reduktuar, pavarësisht se në disa raste veprat e kryera prej tyre nuk konsiderohen të lehta. Kryesisht të miturit dhe të rinjtë e kësaj moshe, ndaj të cilëve është caktuar arrest në burg akuzohen për vepra penale kundër pasurisë, shitjen e narkotikëve apo armëmbajtje pa leje. Ndër rastet e studiuara është caktimi i masës së sigurisë “arrest në burg” për të miturin 15 vjeçar për veprën penale “vjedhje” të objekteve me vlerë shumë të vogël monetare (kryesisht ushqime dhe pije).

¹ Sipas kësaj dispozite, nëse gjykata vëren se arresti në flagrancë është i paligjshëm, ajo duhet të lirojë menjëherë personin.

xii. Në raste shumë të rralla është përdorur masa e sigurimit personal “garancia pasurore”. Zbatimi i kësaj mase apo alternativave të masave të tjera të sigurimit mund të ndikonte pozitivisht jo vetëm tek vetë individit i akuzuar por do t’i shërbente, qoftë edhe në një masë të kufizuar, shpopullimit të institucioneve të burgimit dhe paraburgimit. Kjo nuk do të thotë që për të justifikuar uljen e mbipopullimit, gjykatat të mos zbatojnë masën e arrestit kur kjo do të ishte e domosdoshme. Megjithatë, referimi në statistikën zyrtare të mbipopullimit është një nga treguesit që gjykata mund ta marrë në konsideratë e vlerësuar në raport me rrethanat e tjera faktike dhe kërkesat e legjislacionit, për domosdoshmërinë ose jo të masës ‘arrest në burg’.

xiii. Në mjaft raste rezulton se kërkesa për masat e sigurimit bazohet kryesisht në provat e mbledhura nga policia gjyqësore dhe se prokuroria nuk ka kryer hetim apo përpunim të akteve të policisë. Pasiviteti i prokurorit përgjatë hetimeve paraprake, sidomos në marrjen e provave apo hartimin e këtyre akteve procedurale, e zbeh rolin e tij gjatë hetimeve paraprake dhe ul garancitë procedurale për të pandehurin apo personin nën hetim. Në shumë nga vendimet e studiuara vërehet se edhe gjykata nuk ka një rol pro-aktiv në vlerësimin e akteve të sjella nga prokuroria, por vleftësën ndalimin/arrestimin dhe cakton masat e sigurimit, në mungesë të provave që krijojnë dyshimin e arsyeshëm, siç ka ndodhur rëndom në rastet e veprës penale të vjedhjes apo dhunës në familje.

xiv. Gjithashtu, tërheq vëmendjen se shpesh, mbrojtësi (si privat dhe i caktuar kryesisht) nuk ka një rol proaktiv dhe nuk paraqet prova në këto seanca por kufizohet duke i kërkuar gjykatës masë më të lehtë siguri nga ajo e parashtruar nga prokurori. Deri në një farë mase kjo praktikë e ndjekur mund të ketë ndikuar në cenimin e parimit të barazisë së armëve juridike.

xv. Monitorimi i seancave dhe vendimet e studiuara evidentojnë raste kur gjykata nuk ka patur një rol proaktiv në konstatimin e shkeljes së të drejtave procedurale dhe lirive të të ndaluarit/ arrestuarit nga policia apo prokuroria. Janë vërejtur parregullsi në veprime procedurale si “kontrolli i banesës” apo “kontrolli personal”. Jo vetëm prokurori duhet të jetë më rigoroz në mbikëqyrjen dhe respektimin e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, por edhe gjykata duhet të jetë më kërkuese ndaj fakteve, të analizojë dhe verifikojë në seancë ligjshmërinë e provave të sjella, pa anashkaluar këtu edhe rolin e mbrojtjes në favor të të ndaluarit/arrestuarit.

xvi. Në disa vendime të gjykatës mungon arsyetimi formalo-ligjor si dhe nuk janë analizuar qoftë në mënyrë të përmblendhur provat mbi të cilat mbështeten faktet e referuara. Gjithashtu janë vërejtur vendime gjyqësore me fraza copy paste (kopjim mekanik i vendimeve të kaluara), ndërkohë që të dhënat lidhur me personin, veprën penale, kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit janë të ndryshme. Ka vendime ku gjykata mjaftohet me citimin e provave të prokurorisë, por pa bërë referime të fakteve mbi të cilat hedhin dritë këto prova. Shumica e vendimet të studiuara janë tepër të shkurtra dhe nuk kanë një arsyetim të mjaftueshëm për të gjithë kushtet dhe kriteret ligjore që ekzistojnë për të caktuar këtë ose atë masë siguri. Linja argumentuese në këto vendime përkon më së shumti me kërkimet/argumentat e prokurorisë.

xvii. Sipas K.Pr.Penale, çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Monitorimi i KShH-së evidentoi se, në 99.4% të rasteve ky informacion me shkrim nuk është i pranishëm në dosje.

xviii. Nga shqyrtimi i vendimeve është konstatuar se në shumicën e rasteve, rrethanat lehtësuese nuk i kanë shërbyer gjykatës për të vendosur masa sigurimi më të favorshme për personat e arrestuar. Ndërsa nga ana tjetër, rrethanat rënduese duket sikur janë vendimtare dhe përcaktuese të masës, madje të tilla që zhvleftësojnë vetë edhe kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 228 dhe 229 të KPrP. Elementë të tillë si: vazhdimësia apo përsëritja, apo edhe rrethanat lehtësuese, nuk mundet në asnjë rast të mbizotërojnë apo zëvendësojnë kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit.

xix. Është shumë i përhapur qëndrimi i gjykatave sipas të cilave, nëse personi ka qenë i dënuar më parë (edhe pse për një vepër tjetër penale), konsiderohet automatikisht person i rrezikshëm, dhe si i tillë i “denjë” për masën arrest në burg. Kështu rezulton se në 76,3% (1387) të rasteve personat kanë qenë të padënuar më parë, në 14,4% (263) të rasteve kanë qenë të dënuar më parë.

xx. Nga 348 përgjigjet e monitoruesve, në lidhje me respektimin e procedurës së marrjes në pyetje të personit të arrestuar, jo më vonë se tre ditë nga zbatimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” ose “Arrest në shtëpi”, rezulton se, në 90.8% (316) të rasteve personi për të cilin është vendosur “Arresti në burg ose “Arrest në shtëpi” është marrë në pyetje nga gjykata jo më vonë se tre ditë nga zbatimi i masës, ndërsa në 9.2% (31) raste rezulton që kjo procedurë nuk është zbatuar.

xxi. Në lidhje me subjektin kërkues të revokimit apo zëvendësimit të masës së sigurimit, analiza e 211 përgjigjeve të monitoruesve evidenton se, në 80.6% (170) të rasteve ky revokim/zëvendësim ka si subjekt kërkues të pandehurin, ndërkohë që në 17% (36) të rasteve revokimi apo zëvendësimi i masës së sigurimit është kërkuar nga prokurori. Në një numër tepër të ulët, vetëm 2,4%, paraqiten rastet kur gjykata ka vendosur kryesisht për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit, çka reflekton një qëndrim pasiv të kësaj të fundit në raport me zbatimin e detyrimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

3. Metodologjia

Në përbërje të këtij raporti studimor janë tre shtylla kryesore, të cilat kanë të bëjmë me analizën dhe studimin e:

- a) Përputhshmërisë së legjislacionit mbi procedurat vendimmarrëse për arrestin në burg dhe të praktikës gjyqësore në Shqipëri me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, standardet e legjislacionit të Bashkimit Evropian, të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe me praktikat e tjera më të mira ndërkombëtare;
- b) Të dhënave cilësore dhe sasiore që kanë rezultuar nga monitorimi i rreth 400 seancave gjyqësore për vleftësimin e ligjshmërisë së ndalimit/arrestimit dhe caktimin e masave të sigurimit, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, në periudhën 20 Shkurt – 30 Prill 2017;
- c) Të dhënave cilësore dhe sasiore që kanë rezultuar nga studimi i 1827 vendimeve gjyqësore për vleftësimin e ligjshmërisë së ndalimit/arresti dhe caktimin e masave të sigurimit, të dhëna nga dy gjykatat e sipërpërmendura në vitin 2015.

Për realizimin e studimit të vendimeve nga pikëpamja cilësore KShH angazhoi 5 ekspertë me përvojë (senior) ndërkohë që për të dhënat sasiore të këtyre vendimeve dhe dosjeve të tyre u angazhuan 5 juristë të rinj (junior). Për monitorimin e seancave gjyqësore u angazhuan në total rreth 10 juristë të rinj (studentë të Fakultetit të Drejtësisë në proces masteri ose të sapodiplomuar).

Grupi i ekspertëve u trajnua paraprakisht nga stafi i KShH-së dhe një ekspert i së drejtës procedurale penale, të cilët u pajisën me metodologjinë e monitorimit. Pjesë e metodologjisë së monitorimit ishin tre kategori pyetësorësh, mbi bazën e të cilëve u bë e mundur analiza në mënyrë të standartizuar e të dhënave sasiore dhe cilësore për monitorimin e seancave dhe studimin e vendimeve gjyqësore. Metodologjia dhe pyetësorët u hartuan bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (nenet 27 dhe 28), dispozitat e KPrP (nenet 227 e vijues) dhe standartet e një procesi të rregullt gjyqësor, si dhe në jurisprudencën dhe standartet ndërkombëtare (të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kombeve të Bashkuara, etj).

Ky monitorim nuk do të kishte qenë i mundur, pa bashkëpunimin konstruktiv me dy gjykatat e monitoruara. KShH ka komunikuar me Kryetaret e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës, përkatësisht me Znj. Enkelejdi Hajro dhe Znj. Joana Qeleshi, për t'i informuar rreth nismës për monitorimin e seancave dhe vendimeve gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit dhe qëllimit të saj. Bashkëpunimi me të dyja gjykatat ka qenë shumë i mirë dhe janë krijuar lehtësitë dhe akseset e nevojshëm për monitorimin dhe studimin e dokumentacionit.

Në monitorimin e seancave dhe studimin e vendimeve gjyqësore, ekspertët e KShH u fokusuan, ndër të tjerash, tek aspektet e lidhura me procesin e rregullt ligjor e konkretisht atë gjyqësor si dhe në aspekte tematike të lidhura me fokusin e këtij studimi si psh:

- a) respektimi i afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale (KPrP) për zhvillimin e seancave gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit;
- b) cilësia e mbrojtjes me avokat (cilësia e mbrojtjes në varësi të mënyrës si janë caktuar mbrojtësit: nga vetë i pandehuri apo kryesisht);
- c) gjeneralitetet e personave ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit (grupmoshat, gjinia), statusi social, ekonomik apo familjar, përkatësia në një grup vulnerabël, të qenit përsëritës;
- d) arsyetimi i kërkesës për masë siguri nga prokurori (nëse mbështetet vetëm në prova të marra nga policia apo vërehet të jetë zhvilluar hetim dhe përpunim i akteve të policisë);
- e) barazia e armëve juridike (respektimi i parimit; avantazhimi nga gjykata i njërës apo tjetrës palë; raste kompromisi);
- f) arsyetimi i bërë nga gjykata në vendimin për caktimin ose jo të masës së sigurimit (argumentat, nëse janë po ato që referohen në kërkesën e prokurorisë, si vlerësohet përshtatshmëria e masës në raport me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, rrezikshmërinë e të pandehurit, rrezikshmërinë e veprës penale, mbipopullimin në sistemin e burgjeve, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parashikuara në Kodin Penal, etj).

Në mbledhjen e të dhënave cilësore, metodologjia u ndërtua në mënyrë të tillë që të identifikonte problematikat në lidhje me zbatimin e ligjit dhe linjën e jurisprudencës për masat e sigurimit personal, vleftësimin e arrestit në flagrancë, respektimin e të drejtave themelore dhe procedurale të personave të përfshirë në këto procedura. Duke pasur parasysh natyrën ekstremisht të ndjeshme të kufizimit të lirisë dhe veçanërisht të rasteve kjo liri kufizohet përmes aplikimit të masës “arrest në burg”, jemi ndalur në këtë studim, duke patur në fokus të veçantë pikërisht këtë masë të sigurimit personal në lidhje me mënyrën si janë zbatuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në KPrP, Kushtetutë dhe KEDNJ.

Analiza cilësore e vendimeve është bërë në mënyrë të veçantë në këndvështrimin kritik dhe ka patur si qëllim evidentimin e mangësive në zbatimin e legjislacionit procedural penal dhe në zbatimin e praktikës gjyqësore unifikuese, kushtetuese dhe atë të GjEDNJ. Për këtë qëllim, në këtë studim janë referuar praktikat gjyqësore (të analizuar më hollësisht në pjesët në vijim), të cilat janë të lidhura me zbatimin e saktë të kriterëve dhe kushteve ligjore për caktimin e masave të sigurimit personal, veçanërisht atij me “arrest në burg”.

Për shkak të natyrës specifike të seancave, konkretisht afatet e ngushta brenda të cilave duhet të zhvillohet seanca e vleftësimit dhe caktimit të masës së sigurimit (brenda 48 orëve nga ndalimi/arrestimi) në pjesën dërmuese të rasteve nuk ka qenë i mundur përditësimi i kalendarëve të seancave gjyqësore, me përjashtime shumë të rralla. Për këtë shkak u desh që monitoruesit të ishin të pranishëm thuajse çdo ditë në ambientet e gjykatave, në pritje të zhvillimit të seancave gjyqësore që do të shqyrtonin kërkesat e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit. Pra, vëzhguesit kanë vëzhguar në mënyrë intensive pothuajse të gjitha seancat gjyqësore të zhvilluara në periudhën 20 Shkurt – 30 Prill.

Parimet të cilat udhëhoqën vëzhguesit në këtë monitorim ishin respektimi i rregullave të etikës, rregullat e sigurisë dhe kontrollit në gjykatat përkatëse si dhe oraret e seancave,

mospërdorimi i telefonit celular apo pajisjeve të tjera të ndaluara në sallën e gjykimit, parimet e profesionalizmit, paanshmërisë dhe objektivitetit.

Gjithashtu, në këtë raport analizohen në një kre të veçantë të dhënat lidhur me zbatueshmërinë e masave të sigurimit, duke ju referuar burimeve zyrtare të informacionit si raporteve vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm, informacioneve të marra nga komunikimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe vjetarëve statistikorë të Ministrisë së Drejtësisë. Po kështu, analizohen të dhëna apo gjetje dhe konstatime lidhur me paraburgimin, kushtet dhe të drejtat procedurale të shtetasve të paraburgosur (përfshirë edhe shtetasit e ndaluar/arrestuar në flagrancë), nga organizata ndërkombëtare apo institucione të specializuara si Komisioni Evropian, Departamenti Amerikan i Shtetit, Avokati i Popullit, Komiteti për Parandalimin e Torturës. Materialet e referuara dhe të analizuar në këtë kre, i përkasin kryesisht viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

4. Legjislacioni ndërkombëtar dhe vendas

(Përputhshmëria e legjislacionit mbi procedurat vendimmarrëse për arrestin në burg dhe të praktikës gjyqësore në Shqipëri me KEDNj, standardet e BE, të Kombeve të Bashkuara (KB), dhe me praktikat e tjera më të mira ndërkombëtare)

4.1 Hyrje

Përdorimi i zgjeruar i paraburgimit është një problem i madh në shumë vende në botë, e në Europë, ku përfshihet edhe Shqipëria. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë me forcë mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimit, deri në dhënien e vendimit, dhe mbajtjen e qëndrimit se heqja e lirisë duhet të zbatohet vetëm kur masat jokufizuese të lirisë janë të domosdoshme. Përdorimi i zgjeruar i ndalimit shpesh është një simptomë e mosfunksionimit të sistemit të drejtësisë penale, që mund të rezultojë në mungesë të mbrojtjes së të drejtave të të paraburgosurve dhe të kapacitetit institucional për të imponuar, zbatuar, dhe mbikëqyrur masat jo shtrënguese dhe sanksionet. Mbipërdorimi i paraburgimit dhe burgimit me vendim përfundimtar kanë të njëjtën problematikë dhe të dyja duhet të adresohen për të krijuar një sistem drejtësie penale efektiv dhe të qëndrueshëm.

Minimizimi i përdorimit të tepruar të paraburgimit është njohur si një element thelbësor për një qeverisje të mirë. Objektivi i 16-të i Kombeve të Bashkuara (KB) për Zhvillim të Qëndrueshëm synon të promovojë një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim të aksesit të drejtësisë për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe përfshirëse për të gjitha nivelet. Kjo përfshin vlerësimin e të ndaluarve pa një vendim përfundimtar, në përqindjen e të gjithë popullatës në burgje, si një tregues të progresit ose jo për rritjen e aksesit të drejtësisë.² Shteteve anëtare të KB u kërkohet të raportojnë periodikisht për treguesit, ç'ka do të thotë se ata janë të detyruar të mbledhin të dhëna lidhur me përdorimin e paraburgimit.

Në raportin e tij vjetor për vitin 2015, Nënkomiteti i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Mizer, Çnjerëzor dhe Degradues u fokusua te paraburgimi si një shkak për mbipopullimin që, në mungesë të kushteve ekzistuese, mund të shkelë të drejtën e të burgosurve për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Në këtë raport, Nënkomiteti identifikoi abuzimin e të drejtave procedurale si faktorin kryesor kontribues për përdorimin të tepruar të paraburgimit, duke përfshirë manaxhimin e dobët të çështjes gjyqësore, numrin e kufizuar të avokatëve të disponueshëm dhe mungesën e parashikimeve ligjore për përdorimin e masave alternative ndaj ndalimit. Ai nxiti gjithashtu shtetet anëtare të zvogëlojnë numrin e personave në paraburgim, duke repsektuar prezumimin kundër paraburgimit dhe përdorimin e alternativave ndaj ndalimit.

² Indikator i sygjëruar (16.3.2), i disponueshëm te “Goal 16: the Indicators We Want ”Virtual network sourcebook on measuring peace, justice and effective institutions, UNDP, f. 46, i disponueshëm te: <http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-government/the-indicators-ëe-ëant.html>

Një tjetër institucion ndërkombëtar, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës (KE), në tetor të vitit 2015, publikoi raportin “Shpërdorimi i paraburgimit në shtetet anëtare të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”³, në të cilin vërehen një numër faktorësh që kontribuojnë në abuzimin e përdorimit të paraburgimit. Komiteti për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, ndër të tjera, ka vërejtur:

- a. Ligjet e shumicës së vendeve anëtare janë përgjithësisht në linjë me standardet e Konventës, **por zbatimi i tyre nga prokuroria dhe gjykatat shpeshherë nuk është sipas standardeve**, një fenomen ky që kërcënon efektivitetin e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar.⁴
- b. Numri i lartë i të ndaluarve në paraburgim në Europë tregon se motivet që lejohen për të vendosur paraburgimin, veçanërisht për të parandaluar largimin/fshehjen e të dyshuarit ose intimidimin e dëshmitarëve ose prishjen e provave, përgjithësisht interpretohen në mënyrë mjaft të zgjeruar ose invokohen *pro forma*, me qëllim justifikimin e paraburgimit për qëllime të tjera abuzimi.⁵ Raporti i kërkon shteteve anëtare të sigurojnë barazi më të madhe të armëve, duke garantuar që avokatët mbrojtës të kenë akses pa pengesa të të ndaluarit, akses të dokumentet e çështjes përpara marrjes së vendimit për paraburgim ose zgjatjen e tij, duke siguruar fondet e nevojshme për ndihmë ligjore.⁶

KShH duke patur parasysh shqetësimin e shprehur për përdorimin eksziv të paraburgimit në kontekstin europian, ku përfshihet dhe Shqipëria, ka këtë raport studimor ku analizohet edhe përputhja e legjislacionit shqiptar mbi procedurat vendimmarrëse për arrestin në burg dhe të praktikës policore e gjyqësore me standardet e KE, BE, KB, dhe me praktikat e tjera më të mira ndërkombëtare.

4.2 Vendimmarrja për arrestin në burg dhe garancitë procedurale

A. Standardet ndërkombëtare

a) Standarde relevante në Europë (KE dhe BE)

(i) Këshilli i Evropës:

Në Europë, seancat dëgjimore për paraburgim duhet të kenë karakter gjyqësor dhe duhet të ofrojnë garancitë e përshtashme për natyrën e privimit të lirisë në fjalë, megjithëse nuk është gjithmonë e nevojshme që i akuzuari të gëzojë të njëjtat të drejta që parashikohen nga neni 6 i KEDNj për mosmarrëveshjet penale dhe civile.⁷ Procedimet e zhvilluara sipas nenit 5/4 të Konventës duhet të përmbushin, në masën më të madhe të mundshme, **kërkesat**

³ Rezoluta 2077 (2015): <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?filed=22206&lang=en>

⁴ Po aty, f. 4.

⁵ Po aty, f. 6.

⁶ Po aty, f. 12.

⁷ Shih, për shembull, Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, 28 tetor, 1998, paragrafi 162; Raportet 1998-VIII; Ëloch kundër Polonisë, nr.27785/95, paragrafi 125; Megyeri kundër Gjermanisë, 12 maj 1992, paragrafi 22, seria A nr. 237-A.

bazë për një proces të rregullt, i cili duhet të jetë kontradiktor dhe të sigurojë barazinë e armëve ndërmjet palëve.⁸

GjEDNJ është shprehur se një person i ndaluar me motivin se është i dyshuar për kryerjen e një veprë penale duhet të dërgohet menjëherë⁹ ose me shpejtësi¹⁰ përpara një autoriteti gjyqësor, dhe hapësira dhe fleksibiliteti për interpretimin dhe zbatimin e termit “menjëherë” është shumë i kufizuar.¹¹

Sipas GjEDNJ, gjykata që vendos për paraburgimin duhet të ketë autoritetin për të liruar të dyshuarin¹² dhe të jetë e pavarur nga ekzekutivi dhe nga dy palët pjesëmarrëse në procedim.¹³ Seanca dëgjimore për ndalimin duhet të jetë verbale dhe të respektojë parimin e kontradiktoritetit, në të cilën palës mbrojtëse duhet t’i jepet mundësia për të marrë pjesë efektivisht.¹⁴

Të ndaluarit duhet t’i jepet koha e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e çështjes, të ketë akses te dokumentacioni relevant dhe të ketë kohën e mjaftueshme për të kontrolluar këto dokumente.¹⁵ Të ndaluarit ose përfaqësuesit të tij ligjor duhet t’i jepet mundësia e duhur për të paraqitur argumentet dhe provat si dhe për të kundërshtuar ose për t’i përgjigjur argumenteve të kundërta ose provave. Kjo e drejtë përfshin mundësinë për të thirrur dëshmitarë relevantë në procedimet përpara gjykatës, për të ballafaquar dhe pyetur dëshmitarët e thirrur nga akuza, duke përfshirë si procedurat e paraburgimit dhe të gjyqësorit.¹⁶ Në këto procese duhet të respektohet barazia e armëve.¹⁷

(ii) Bashkimi Evropian:

Zhvillimet e kohëve të fundit në të drejtën e BE-së lidhur me të drejtat procedurale kanë patur një ndikim mbi procedurat vendimmarrëse për paraburgimin. Kjo referuar edhe programit të vendosur nga *Roadmap* e Këshillit, për forcimin e të drejtave procedurale për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedimet penale (*Roadmap*)¹⁸. BE ka adoptuar katër direktiva mbi të drejtat procedurale penale:

⁸ Shih, për shembull, Nikolova kundër Bullgarisë, nr.31195/96, paragrafi 58; Schiesser kundër Zvicrës, 4 dhjetor 1979, paragrafi 30-31, seria A nr.34; Ramishvili & Kokbreidze kundër Gjeorgjisë, 27 janar 2009.

⁹ *Rehbock kundër Sllovenisë*, apl. 29462/95, 28 nëntor 2000, paragrafi 84.

¹⁰ Koha e pranueshme për ndalimin nuk është përcaktuar nga GjEDNJ, megjithatë në *Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 29 nëntor 1988, ajo ka mbajtur qëndrim se një periudhë e ndalimit paraprak që varion nga katër deri gjashtë ditë shkel nenin 5/3 të KEDNJ.

¹¹ Po aty, paragrafi 62.

¹² *Singh kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shurt 1996, f. 65.

¹³ *Neumeister kundër Austrisë*, 27 qershor 1968, f. 24.

¹⁴ *Goç kundër Turqisë*, apl. 36590/97, 11 korrik 2002, f. 62.

¹⁵ Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e masës së dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 26.

¹⁶ Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 28.

¹⁷ GjEDNJ, *Dombo Deheer B.V. kundër Hollandës*, 27 tetor, 1993, seria A, nr.274-A, paragrafi 33.

¹⁸ Rezolutë e Këshillit të BE për forcimin e të drejtave procedurale për të dyshuarit ose të akuzuarit në procedimet penale, 30 nëntor 2009 (2009/c 295/01).

- ✚ Direktiva 2010/64/BE mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedimet penale (Direktiva për interpretimin dhe përkthimin)¹⁹;
- ✚ Direktiva 2012/13/BE për të drejtën e informimit në procedimet penale (Direktiva për të drejtën e informimit)²⁰;
- ✚ Direktiva 2013/48/BE për të drejtën e aksesit të një avokat në procedimet penale (Direktiva për aksesin të një avokat)²¹; dhe
- ✚ Direktiva mbi prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim (Direktiva për prezumimin e pafajësisë)²².

Për shkak se çdonjëra nga këto direktiva fokusohet, të paktën pjesërisht, në mbrojtjen procedurale gjatë periudhës së paraburgimit, ato kanë potencialin për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave në administrimin e paraburgimit, dhe, për pasojë, kufizimin e përdorimit të tij në mënyrë ekseseve. Për shembull, direktiva për përkthimin ofron jo vetëm përkthimin gjatë procesit dëgjimor në gjykatë, por gjithashtu edhe përkthimin e intervistave private ndërmjet mbrojtësit dhe të pandehurit,²³ si edhe përkthimin e dokumenteve kryesore/thelbësore, ku përfshihet “çdo vendim që kufizon personin nga liria, ndaj çdo përgjegjësie ose akuze”.²⁴

Lidhur me aksesin të një avokat, direktiva përkatëse parashikon se të pandehurit që dërgohen për seancat dëgjimore të paraburgimit, duhet të kenë akses tek një avokat brenda “një kohë të tillë dhe në një mënyrë që u jep atyre mundësinë për të ushtruar praktikisht dhe efektivisht të drejtat e tyre të mbrojtjes”²⁵. Sipas direktivës, kjo do të thotë se aksesit duhet të ndodhë (*inter alia*) përpara se ata të pyeten nga një autoritet gjyqësor;²⁶ dhe në “kohën e duhur” përpara çfarëdo seance dëgjimi përpara gjykatës. Gjatë këtyre fazave të hershme të procedimit penal, aksesit të një avokat ka një rëndësi të veçantë në kontekstin e seancave dëgjimore të paraburgimit, të cilat shpesh ndodhin në një moment kyç të procedimit dhe gjatë të cilave i dyshuari dhe i pandehuri kanë kontakte minimale me avokatin. Direktiva për aksesin të një avokat parashikon gjithashtu se avokati mbrojtës duhet të jetë “i aftë”, “të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë efektivisht”²⁷. Po ashtu, shtetet anëtare duhet “të bëjnë rregullimet e nevojshme për të siguruar se të pandehurit janë në një pozicion që gëzojnë efektivisht të drejtën e tyre për akses të një avokat”.²⁸ **Këto parashikime të direktivës synojnë të sigurojnë se e drejta për një avokat gjatë seancave dëgjimore të paraburgimit është kuptimplotë dhe reale.**

¹⁹ Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedimet penale, 20 tetor 2010.

²⁰ Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit për të drejtën e informimit në procedimet penale, 22 maj 2012.

²¹ Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit për të drejtën e aksesit të një avokat në procedimet penale, 22 tetor 2013.

²² Direktiva, 20 tetor 2015, mbi prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim.

²³ Direktiva për përkthimin, neni 3.1.

²⁴ Po aty, neni 3.2.

²⁵ Direktiva për aksesin të një avokat, neni 3.1.

²⁶ Po aty, neni 3.2(a).

²⁷ Po aty, neni 3.3 (b).

²⁸ Po aty, neni 4.

Sipas direktivës për të drejtën për informim, në nenin 7.1 parashikohet e drejta e të ndaluarit ose të arrestuarit për të patur akses në materialet e çështjes “që janë në zotërim të autoriteteve kompetente, të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar efektivisht, në përputhje me ligjin e shtetit, ligjshmërinë e arrestit ose ndalimit”. Kjo dispozitë nuk parashikon derogim dhe, për rrjedhojë, ajo duhet të sigurojë që të pandehurit ose avokatët e tyre të gëzojnë barazi të armëve përsa i takon informacionit të nevojshëm për të kundërshtuar kërkesat e prokurorit për paraburgim.

Direktiva për prezumimin e pafajësisë, teksa thekson “lidhjen e qartë” ndërmjet prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për liri para-dënimit nga gjykata,²⁹ i shmanget trajtimit drejtpërsëdrejti të paraburgimit sepse kjo çështje është trajtuar nga iniciativa të tjera,³⁰ duke iu referuar në këtë mënyrë *Green Paper* të Komisionit dhe rezultateve të votimit të Parlamentit në favor të një mjeti legjislativ për të adresuar problemin e gjerë të mbipërdorimit të paraburgimit në BE.

b) Standardet e Kombeve të Bashkuara dhe praktikat e tjera të mira ndërkombëtare

(i) *Njoftimi në momentin e ndalimit/arrestit dhe njoftimi mbi natyrën e akuzës*

Sipas Grupit të Parimeve të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të gjithë personave të ndodhur nën çdo lloj forme ndalimi apo arrestimi (Grupi i Parimeve), çdo person i ndaluar/arrestuar duhet të informohet menjëherë për arsyen e ndalimit dhe akuzave kundër tij.³¹ Grupi i Parimeve të KB kërkojnë që të regjistrohet në mënyrën e duhur informacioni që vijon: (a) arsyet për arrestin; (b) koha e arrestit dhe koha e çuarjes së personit të arrestuar në vendin e izolimit, si edhe paraqitja e tij e parë përpara një autoriteti gjyqësor ose një autoriteti tjetër; (c) identiteti i oficerit ligjzbatues konkret; dhe (ç) të dhëna të sakta për vendin e ndalimit (qelinë). Këto regjistrime duhet t’i komunikohen personit të ndaluar, ose avokatit të tij, në formën e parashikuar nga ligji, në gjuhën që ai kupton.³²

Po ashtu, të njëjtat garanci burojnë edhe nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP). Sipas nenit 9/4 të PNDKP “Kushdo që është i privuar nga liria me arrestim ose ndalim, ka të drejtë të dalë para gjykatës, me qëllim që kjo gjykatë të vendosë pa vonesë për ligjshmërinë e paraburgimit dhe të urdhërojë lirin e tij nëse paraburgimi nuk është i ligjshëm”.

(ii) *Komunikimi i të drejtës për avokat*

Grupi i Parimet të KB kërkojnë që i akuzuari të ketë asitencën e një avokati mbrojtës. Ai duhet të informohet për të drejtën e tij nga një autoritet kompetent menjëherë pas arrestit dhe duhet t’i ofrohet ndihma/kushtet e arsyeshme për ta ushtruar këtë të drejtë. Nëse një

²⁹ Direktiva për prezumimin e pafajësisë, f 1.14.

³⁰ Po aty, f. 1.16.

³¹ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën Cdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi (Grupi i Parimeve), Parimi 10, <http://www.un.org/documents/ga/res/43/a43r173.htm>

³² Po aty, parimi 12.

person nuk ka një avokat të zgjedhur prej tij, atij duhet t'i caktohet një avokat i caktuar nga një autoritet gjyqësor ose një autoritet tjetër, në të gjitha rastet kur interesi i drejtësisë e kërkon, dhe pa pagesë kur personi nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar.³³ Të njëjta garanci burojnë edhe nga neni 14/3(d) të PNDKP.

(iii) *Komunikimi i të drejtës për t'u vizituar nga një doktor*

Komisioni Afrikan është shprehur se “çdo person që është i arrestuar ose i ndaluar duhet të informohet menjëherë pas arrestit, në një gjuhë që ai kupton, për të drejtën... të kontrollohet nga një doktor, sipas zgjedhjes që ai bën, dhe për lehtësirat e disponueshme për ta ushtruar këtë të drejtë”.³⁴

(iv) *Informimi lidhur me të drejtën e komunikimit me anëtarë të familjes/përfaqësuesin ligjor/të tjerë*

Menjëherë pas arrestit dhe pas çdo transferimi nga një vendndalim ose burgim te një tjetër, të paraburgosurit duhet t'i jepet mundësia për të njoftuar ose për të kërkuar nga autoriteti kompetent për të njoftuar anëtarë të familjes së tij (ose një person tjetër i përshtashtshëm sipas zgjedhjes që ai bën) lidhur me arrestin e tij, ndalimin, burgimin ose transferimin, si edhe për vendin e ndalimit ku ai mbahet në qeli. Çdo njoftim që i referohet këtij parimi duhet të bëhet menjëherë pa vonesë.³⁵ Autoriteti kompetent mundet ta vonojë njoftimin për një periudhë të arsyeshme, nëse nevojat specifike të hetimit mund ta kërkojnë këtë.³⁶

Nëse një person i paraburgosur është i huaj, ai duhet të informohet menjëherë për të drejtën për të komunikuar me një konsullatë ose me misionin diplomatik të shtetit të tij (ose i cili është kompetent për të marrë një komunikim të tillë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ose me përfaqësues të organizatës ndërkombëtare, nëse ai është një refugjat ose është nën mbrojtjen e organizatës ndërqeveritare).³⁷

Nëse një person i ndaluar është i mitur ose i paafte për të kuptuar të drejtat e tij, autoriteti kompetent, me iniciativën e tij, duhet të ndërmarrë njoftimin sipas këtij parimi. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet njoftimit të prindërve ose kujdestarit.³⁸

(v) *Kontrolli i shpejtë nga një autoritet gjyqësor*

³³ Po aty, parimi 17.

³⁴ Komisioni Afrikan për të drejtat e njeriut dhe të popujve, parimet dhe udhëzimet mbi të drejtat për një proces të rregullt dhe asistencën ligjore në Afrikë, seksioni M (f).

³⁵ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën Cdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi (Grupi i Parimeve), Parimi 16.

³⁶ Po aty.

³⁷ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën Cdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi (Grupi i Parimeve), Parimi 16; Konventa e Vienës për Marrëdhëniet Konsullore, 1963, neni 36.

³⁸ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën çdo lloj forme Ndalimi apo Arrestimi (Grupi i Parimeve), Parimi 16.

Mekanizmi kryesor për të mbikëqyrur paraburgimin është e drejta e kujdo që është i arrestuar ose i ndaluar për t'u dërguar menjëherë përpara një autoriteti gjyqësor. Kontrolli gjyqësor përbën një garanci themelore kundër abuzimeve të pushtetit dhe arrestit arbitrar, duke lejuar gjykatën të përcaktojë nëse ndalimi fillestar ka qenë i justifikuar, dhe nëse i akuzuari duhet ose jo të qëndrojë në paraburgim deri në gjykim. Po ashtu, ai parandalon shkeljet e pazbuluara të të drejtave të të ndaluarit dhe lejon të ndaluarin të lirohet nëse arresti ose ndalimi shkel të drejtat e tij. Kjo garanci është e parashikuar në secilën nga instrumentet ndërmkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut. Komiteti i të Drejtave të Njeriut (KDNj) ka theksuar se, sipas nenit 9 të PNDKP: “në çështjet penale, çdo person i arrestuar ose i ndaluar duhet të dërgohet menjëherë përpara një gjyqtari ose zyrtari të autorizuar nga ligji për të ushtruar funksionin gjyqësor”.³⁹ Karta Afrikane e të Drejtave të Njeriut (M/3/a) dhe Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (parimi V) përmbajnë garanci të njëjta. Detyrimi për të dërguar të ndaluarin përpara gjykatës menjëherë zbatohet automatikisht pavarësisht nëse i ndaluari e kërkon apo jo.⁴⁰

Përkufizimi i temit “menjëherë” nuk është i qartësuar në asnjë prej instrumenteve të të drejtave të njeriut, megjithëse janë parashikuar disa udhëzime. KDNj ka treguar se ndalimi përpara kontrollit gjyqësor “nuk duhet të kalojë disa ditë”⁴¹, dhe është e preferueshme të bëhet e mundur brenda 48 orëve.⁴²

Për t'u siguruar se të drejtat e të ndaluarit mbrohen në mënyrën e duhur, autoriteti gjyqësor që kontrollon ndalimin duhet të ketë disa karakteristika. Ai duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi, duhet ta dëgjojë personalisht të ndaluarin dhe duhet të ketë kompetencën për të vendosur për paraburgimin ose lirimin e personit të arrestuar.

Kontrolli gjyqësor mbi paraburgimin duhet të plotësohet me garanci të tjera. **Konkretisht,** duhet të mbahet një procesverbal i plotë për të gjithë procesin e paraburgimit. Agjencia ligjzbatuese përgjegjëse për ndalimin dhe arrestin duhet të regjistrojë: arsyet e arrestimit; kohën e arrestit dhe dërgimin e personit të arrestuar në izolim; detajet e seancës së parë të dëgjimit para një autoriteti gjyqësor, duke përfshirë kohën kur zhvillohet dhe emrin e oficerit gjyqësor; identitetin e oficerëve të agjencisë ligjzbatuese dhe informacionin e saktë për vendin e izolimit.⁴³ Në çdo vend izolimi për ndalimet duhet të mbahet një regjistër për të gjithë të ndaluarit, duke përfshirë emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, informacione specifike për sa më lart, si edhe informacion lidhur me vendet e izolimit dhe transferimit nga një vendndalim te një tjetër.⁴⁴ Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm për të

³⁹ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, komente të përgjithshme 8, paragrafi 2.

⁴⁰ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, observime përfundimtare; Republika e Koresë, CCPR/C/79/Add.122 (2000) paragrafi 13.

⁴¹ Koment i Përgjithshëm 8, paragrafi 2; në një sërë çështjesh, Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka mbajtur qëndrimin se një periudhë nga 7-9 ditë nuk është e pranueshme sipas nenit 9/2; shih Grant kundër Xhamajkës, Komunikimi nr. 597/1994, paragrafi 8.1; shih gjithashtu, Morrison kundër Xhamajkës, Komunikimi nr.663/1995; Kurbanov kundër Takhikistanit, Komunikimi nr.1096/2002, paragrafi 7.2.

⁴² Komiteti për të Drejtat e Njeriut, observimet përfundimtare: Zimbave, CCPR/C/79/Add.89 (1998) paragrafi 17; Observimet përfundimtare: Republika Çeke, CCPR/CO/72/CZE (2001) paragrafi 17.

⁴³ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën Cdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi (Grupi i Parimeve), Parimi 12/1.

⁴⁴ Komisioni Ndër-amerikan për të Drejtat e Njeriut, parimet dhe praktikat më të mira, Parimi IX.

ndaluarin, për përfaqësuesin e tij ligjor dhe për çdo autoritet gjyqësor ose autoritet tjetër të pavarur dhe kompetent me funksion për të vëzhguar procedurat dhe procesin që kalon personi i ndaluar.⁴⁵

(vi) *E drejta për të marrë pjesë efektivisht*

Është një element thelbësor i procesit të rregullt që një person i ndaluar dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor të kenë efektivisht mundësinë për të marrë pjesë në seancat dëgjimore, duke filluar nga paraburgimi. Sic neni 14/3(d) i PNDKP parashikon: “Secili do të ketë të drejtë të këtyre barazive minimale, e në barazi të plotë: Të gjykohet në praninë e tij dhe të mbrojtësit të tij ligjor...”.

B. Legjislacioni shqiptar

Kushtetuta, në nenet 27 dhe 28, përcakton rastet e kufizimit të lirisë dhe garancitë procedurale për personin e ndaluar ose të arrestuar. Parimet dhe standardet e përcaktuara në këto nene reflektojnë, me formulime përafërsisht të njëjta, ato të nenit 5 të KEDNJ.

(i) *Njoftimi për të drejtat që gëzon i ndaluari/i arrestuari*

Sipas Kushtetutës, çdo person i ndaluar **“ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton,:**

-  për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet ...
-  se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë
-  se ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin,
-  si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.⁴⁶

Ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale (KPP)⁴⁷, në frymën e Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare, vendosin disa garanci më specifike lidhur me këto të drejta. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim informojnë menjëherë personin në fjalë për arsyet e arrestimit ose të ndalimit dhe për të drejtat e tij, sipas nenit 34/b të KPP, përveçse kur kjo është absolutisht e pamundur për shkak të rrethanave.⁴⁸ Neni 34/b përcakton, në mënyrë specifike, të drejtat e personit të arrestuar ose të ndaluar, i cili, përveç të drejtave që gëzon me cilësinë e personit në hetim ose si i pandehur, ka të drejtë :

-  të takojë vetëm për vetëm mbrojtësin e tij përpara marrjes në pyetje për herë të parë;
-  të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij;

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Kushtetuta, neni 28/1

⁴⁷ Ligji nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, date 21.3.1995 ‘Kodi i Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar, I cili ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2017.

⁴⁸ KPP, neni 255/2.

- ✚ të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij;
- ✚ të marrë menjëherë përkujdesjen e nevojshme mjekësore.
- ✚ Në rast se i ndaluarit ose i arrestuari është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij dhe në rast se është person pa shtetësi ose refugjat, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet një organizatë ndërkombëtare.

Një garanci shtesë për njohjen e të ndaluarit/të arrestuarit me të drejtat e tij është parashikimi i “Letrës së të drejtave” në formë të shkruar, e cila duhet t’i jepet personit të ndaluar kundrejt nënshkrimit.⁴⁹ Nëse i ndaluarit/i arrestuari nuk mund të lexojë, letra e të drejtave i lexohet nga njëri prej të pranishmëve dhe ky fakt pasqyrohet në procesverbal kundrejt nënshkrimit.⁵⁰ Në funksion të kësaj garancie është dhe parashikimi se prokurori, kur e merr në pyetje të ndaluarin/të arrestuarin për here të parë, e pyet fillimisht nëse e ka marrë letrën e të drejtave dhe sigurohet që ai i ka kuptuar të drejtat e tij, dhe, nëse nuk e ka marrë letrën, prokurori ia jep atë përpara marrjes në pyetje dhe i sqaron të drejtat e tij.⁵¹ **Për më tepër, deklaratimet e bëra nga i ndaluarit/i arrestuari përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin, nuk mund të përdoren.**⁵² Mbetet për t’u vëzhguar se si do të zbatohet në praktikë kjo garanci e rëndësishme, duke qenë se kërkesa për këtë standard ka vetëm disa muaj që ka hyrë në fuqi.

(ii) Dërgimi përpara autoritetit gjyqësor

Personi, të cilit i është hequr liria për dyshime të arsyeshme se ka kryer ose do të kryejë një vepër penale, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.⁵³ Këto afate të vendosura nga Kushtetuta janë në përputhje me kuptimin e konceptit “menjëherë” të kërkuara nga standardet ndërkombëtare. Gjyqtari, siç përcaktohet qartë në Kushtetutë, është i pavarur dhe ka autoritetin për të vendosur paraburgimin ose lirimin e të ndaluarit/arrestuarit. Kompetencën për lirimin e menjëhershëm të të ndaluarit/të arrestuarit e ka dhe prokurori ose, sipas rastit, oficeri i policisë gjyqësore, kur është ngatërruar personi ose nuk janë respektuar kërkesat e ligjit ose kur masa e ndalimit/arrestit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit për vleftësimin e masës.⁵⁴

(iii) Kontrolli gjyqësor

Seanca për vleftësimin e masës së arrestit ose ndalimit zhvillohet në mënyrë të detyrueshme, automatike, pa qenë nevoja të vihet në lëvizje nga i ndaluarit/i arrestuari.⁵⁵ Nëse vendimi i gjykatës për vleftësimin e ndalimit/arrestit nuk shpallet brenda dyzet e tetë

⁴⁹ Po aty, neni 34/b, pika 2.

⁵⁰ Po aty, neni 255/3.

⁵¹ Po aty, neni 256/2.

⁵² Po aty, neni 256/3.

⁵³ Kushtetuta, neni 28/2; KPP, neni 258/1.

⁵⁴ KPP, neni 257/1.

⁵⁵ Po aty, neni 258.

orëve nga çasti në të cilën kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë, arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë.⁵⁶

Parimi i kontradiktoritetit dhe barazia e armëve duhet të respektohen gjatë zhvillimit të seancës së vlefshimit. Për këtë qëllim është e domosdoshme pjesëmarrja e prokurorit dhe e mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër.⁵⁷ I ndaluari/i arrestuari ka të drejtë të marrë pjesë në seancë dhe të mbrohet vetë.

I ndaluari/i arrestuari ka të drejtë:

- ✚ të njihet me aktet, provat e nevojshme
- ✚ të njihet me arsyet e ndalimit/arrestimit të tij
- ✚ të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen.⁵⁸

Provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim, por, me kërkesën e palëve, ato mund t'i nënshtrohen debatit gjyqësor gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.⁵⁹ Vendimi i gjykatës merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar.⁶⁰ Pra, sipas ligjit, zhvillohet seancë publike dhe kërkohet marrja e një vendimi për të zhvilluar seancë me dyer të mbyllura.⁶¹⁶²

Ç. Konkluzione

⁵⁶ Po aty, neni 259/5.

⁵⁷ Po aty, neni 259/1.

⁵⁸ Po aty, neni 34/b, pika 1/b dhe neni 34/a, pika 1/e.

⁵⁹ Po aty, neni 259/2.

⁶⁰ Po aty, neni 244/1.

⁶¹ Gjykata Kushtetuese (GJK), në vendimin 28/2011, me kërkesues Kujtim Kryekurti, i referohet rastit të GJEDNJ *Reinprecht kundër Austrisë*, vendim i datës 15 Nëntor 2005, lidhur me elementet e procesit të rregullt që duhen të respektohen gjatë shqyrtimit gjyqësor të masës së arrestit me burg: *GJEDNJ-ja ka theksuar se “...Megjithëse nuk është e nevojshme gjithmonë që procedura sipas nenit 5/4 të KEDNJ-së të realizohet me të njëjtat garanci si ato të kërkuara sipas nenit 6 për çështje penale ose civile, duhet që kjo procedurë të ketë karakter gjyqësor dhe të sigurojë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë. ... Për më shumë duhet të kemi në vëmendje, se neni 5/4 dhe neni 6, pavarësisht lidhjes së tyre, kanë qëllime të ndryshme. Neni 5/4 ka si qëllim mbrojtjen kundër burgimit arbitrar, duke garantuar procedura të shpejta. Në rastet e paraburgimeve, sipas nenit 5/1 (c), shqyrtimi konsiston në faktin nëse ka apo jo një dyshim të arsyeshëm mbi të arrestuarin. Neni 6 merret me “përcaktimin e një veprë penale” dhe ka si qëllim të garantojë që faktet e çështjes, që përcaktojnë fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, të shqyrtohen në një proces të drejtë dhe publik.*

⁶² Po në këtë vendim të GJK, lidhur me natyrën e shqyrtimit në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë shprehet: “*Dhoma e Këshillimit është e legjitimuar të veprojë pa pjesëmarrjen e palëve dhe të selektojë kërkesa për çështje themeli që kanë lidhje me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, para se t'i kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata vlerëson se kjo Dhomë aq më shumë duhet të jetë kompetente për shqyrtimin e ankimeve mbi ligjshmërinë e masave të sigurimit si veprime procedurale që nuk janë dënime penale dhe që nuk paragjykojnë pafajësinë dhe fajësinë e të pandehurit. Procedura e zhvilluar në Dhomë Këshillimi nuk ia heq karakterin gjyqësor shqyrtimit të çështjes.*”

Ndryshimet e fundit në KPrP, në frymën e Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare, përcaktojnë disa garanci më specifike për respektimin e të drejtave procedurale që gëzon i ndaluari ose i arrestuari. Duhet evidentuar, veçanërisht, prashikimi në nenin 34/b për njohjen e të ndaluarit me të drejtat e tij nëpërmjet “Letrës së të drejtave” në formë të shkruar, e cila duhet t’i jepet personit të ndaluar kundrejt nënshkrimit. Mbetet për t’u vëzhguar se si do të zbatohet në praktikë kjo garanci e rëndësishme, duke qenë se kërkesa për këtë standard ka vetëm disa muaj që ka hyrë në fuqi.

Sipas standardeve ndërkombëtare të trajtuara më lart, i ndaluari duhet të njihet me materialet e çështjes/dosjes, në një kohë sa më të hershme, në funksion të mbrotjes efektive dhe barazisë së armëve. Ashtu si ne rastin e të drejtave të të pandehurit që garantohen ne nenin 34/a, ku parashikohet se i pandehuri ka të drejtë: “(ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi”; duhet që edhe ne nenin 34/b (që lidhet me të arrestuarit apo ndaluarit) t’u jepet e njëjta e drejtë për njohjen me materialet e çështjes. Ne fakt formulimi ne Nenin 34/b është disi më specifik, duke parashikuar që i arrestuari apo i ndaluari ka të drejtë: “(b) të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij”. Gjithashtu, edhe neni 248, pika 1, parashikon se “mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre”. Këto dy parashikime, duke mos qenë në harmoni, mund të krijojnë hapësirë për keqinterpretim në praktikë, që mund të rezultojë në cenimin e të drejtës së të ndaluarit.

Standardet ndërkombëtare nuk imponojnë detyrimin që seancat gjyqësore vendimmarrëse për vleftësimin e arrestimit/ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit, të zhvillohen të mbyllura. Si rregull, seanca duhet të bëhet publike, përveç rastit kur, për arsye të parashikuara nga ligji, gjykata vendos që seance të zhvillohet e mbyllur.

4.3 Arsyetimi i vendimeve për masën e arrestit në burg

A. Standardet ndërkombëtare

a) Standardet relevante në Europë (KE dhe BE)

❖ *Këshilli i Europës:*

Këshilli i Europës ka rekomanduar se “çdo vendim nga një autoritet gjyqësor për ta dërguar dikë në izolim, për të vazhduar ndalimin ose për të zbatuar masa alternative duhet të arsyetohet dhe se vendimi duhet t’i jepet personit të ndaluar”.⁶³ Nisur nga neni 5/1 i KEDNj, Këshilli i Europës, rekomandon se një person mund të mbahet në ndalim, vetëm kur: “ka arsye thelbësore për të besuar se, nëse ai do të lihet i lirë, ai:

- ❖ do të fshihet;
- ❖ do të kryejë krime të rënda;
- ❖ do të cenojë procesin e dhënies së drejtësisë; ose

⁶³ Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e masës së dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 21.

❖ përbën një rrezik serioz për sigurinë publike.”⁶⁴

GjEDNj ka theksuar në mënyrë të përsëritur prezumimin në favor të lirimit,⁶⁵ dhe ka sqaruar se barra e provës i bie shtetit që të tregojë se një masë më pak shtrënguese ndaj ndalimit nuk do t'i shërbente qëllimit përkatës.⁶⁶ Vendimi për ndalimin duhet të jetë mjaftueshëm i arsyetuar **dhe nuk duhet të përdorë forma steriotipe të formulimit.**⁶⁷ **Argumentet pro dhe kundër paraburgimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”.**⁶⁸ Gjykata duhet të argumentojë arsyet për paraburgimin dhe arsyet për rrëzimin e kërkesës për lirim.⁶⁹

GjEDNj ka nënvizuar gjithashtu motivet ligjore të urdhërimit të paraburgimit:

- ❖ rreziku se i dyshuari do t'i shmanget paraqitjes në gjykatë;⁷⁰
- ❖ rreziku se i dyshuari do të dëmtojë provat ose intimidojë dëshmitarët;⁷¹
- ❖ rreziku se i dyshuari do të kryejë vepra të tjera penale;⁷²
- ❖ rreziku se lirimi i të dyshuarit mund të shkaktojë cenim të rendit publik;⁷³
- ❖ nevoja për të mbrojtur sigurinë e një personi që është nën hetim në rrethana specifike.⁷⁴

Lidhur me rrezikun e largimit/fshehjes, GjEDNj ka sqaruar se as mungesa e një vendbanimi/rezidence të përcaktuar⁷⁵ ose e një rreziku të përballjes me një burgim afatgjatë⁷⁶ nëse dënohet, mund të justifikojnë, të vetme, vendosjen e personit në paraburgim. Rreziku i kryerjes së një veprë tjetër penale mund të justifikojë paraburgimin vetëm nëse ka prova reale për këtë rrezik⁷⁷. Vetëm fakti i mungesës së një pune apo të lidhjeve me familjen do të ishin të pamjaftueshme për të justifikuar paraburgimin.⁷⁸

GjEDNj ka deklaruar gjithashtu se një person mund të ndalohet vetëm me qëllim dërgimin e tij përpara një autoriteti kompetent ligjor, bazuar në dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së një veprë penale.⁷⁹ Kërkesa faktike e qëndrueshme, për një dyshim të arsyeshëm se personi i arrestuar ka kryer një vepër penale është parakusht për ligjshmërinë e vazhdimin të ndalimit të tij. Gjithashtu, teksa dyshimi i arsyeshëm duhet të ekzistojë në kohën e arrestit

⁶⁴ Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin masës së dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 6.

⁶⁵ Michalko kundër Sllovakisë, apl. 35377/05, 21 dhjetor 2010, f.145.

⁶⁶ Ilijkov kundër Bullgarisë, apl. 33977/96, 26 korrik 2001, f. 85.

⁶⁷ Yagci dhe Sargin kundër Turqisë, apl. 16419/90, 8 qershor 1995, f.52.

⁶⁸ Smirnova kundër Rusisë, apl.46133/99, 24 korrik 2003, f.63.

⁶⁹ Buzadj kundër. Moldavisë, apl 23755/07, 16 dhjetor 2014, f. 3.

⁷⁰ Smirnova kundër Rusisë, apl.46133/99, 24 korrik 2003, f.59.

⁷¹ Po aty.

⁷² Muller kundër Francës, apl.21802/93, 17 mars 1997, f.44.

⁷³ I.A. kundër Francës, apl. 28123/95, 23 shtator 1988, f.104.

⁷⁴ Po aty, f.108.

⁷⁵ Sulaoja kundër Estonisë, apl. 55939/00, 15 shkurt 2005, f.64.

⁷⁶ Tomasi kundër Francës, apl.12850/87, 27 gusht 1992, f.87.

⁷⁷ Matznetter kundër Austrisë, apl.2178/64, 10 nëntor 1969, mendim paralel i gjyqtarit Ballardore Pallieri, f.1.

⁷⁸ Sulaoja kundër Estonisë, apl. 55939/00, 15 shkurt 2005, f.64.

⁷⁹ Rasul Jafarov kundër Azerbajxhanit, apl. 69981/14, 17 mars 2016, f. 114.

dhe ndalimit fillestar, në rastet e zgjatjes së ndalimit duhet të tregohet se dyshimi është i qëndrueshëm dhe mbetet i arsyeshëm gjatë gjithë kohës së ndalimit.⁸⁰

b) Standardet e Kombeve të Bashkuara dhe praktikat e tjera të mira ndërkombëtare

Sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), çdo ndalim duhet të jetë i arsyeshëm dhe i nevojshëm.⁸¹ Ndalimi “i arsyeshëm dhe i nevojshëm” ndryshon në varësi të fazës së procedimit dhe ky Pakt nuk specifikon rrethanat në të cilat ndalimi është i arsyeshëm.

(i) Arbitrariteti

Sipas nenit 9/1 të PNDKP, një vendim për ndalimin e një individi nuk duhet të jetë arbitrar. Sipas *travaux preparatoire* të PNDKP, detyrimi kundër ndalimit “arbitrar” është i gjerë. Termi “arbitrar” përfshin elementë të papapërshtatshëm, të padrejtë dhe mungesë të parashikueshmërisë.⁸²

Standardet e njohura ndërkombëtare të nivelit global dhe rajonal të të drejtave të njeriut kërkojnë që rrethanat dhe procedurat, sipas të cilave një person mund të ndalohet ligjërisht, duhet të jenë të përcaktuara qartësisht në ligjin e shtetit.⁸³ Shtetet duhet të miratojnë ligje që përcaktojnë cilët zyrtarë janë të autorizuar për të imponuar ndalimin dhe për të vendosur kushtet mbi të cilat këto veprime mund të merren. Ligje të tilla duhet përgjithësisht të nxirren nga pushteti ligjvënës; thjesht aktet administrative të organeve ekzekutive nuk do të jenë të mjaftueshme.⁸⁴ Gjithashtu, këto ligje duhet të jenë mjaftueshëmrisht të aksesueshme dhe të përpikta për të lejuar një qytetar të rregullojë sjelljen e tij në përputhje me to, si dhe të njohë pasojat që do të ketë për veprimet e tij. Për pasojë, ligjvënësit nuk duhet të nxjerrin ligje që lejojnë ndalimin e individëve për arsye të paqarta.

Rregullat minimum të Kombeve të Bashkuara për masat jondaluese përcaktojnë se “përzgjedhja e masave jondaluese duhet të bëhet bazuar në vlerësimin e kriterëve të vendosura”.⁸⁵

Është e nënkuptuar nga kërkesat e mësipërme se çdo ndalim që të konsiderohet “i nevojshëm” duhet që oficeri, i cili autorizon arrestin, të shqyrtojë paraprakisht nëse ekzistojnë alternativa të arsyeshme ndaj arrestit dhe paraburgimit.⁸⁶

⁸⁰ Po aty, f.119.

⁸¹ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Komunikata nr. 458/1991, A.W.Mukong kundër Kamerunit (miratuar në 21 korrik, 1994), në dokumentin e Kombeve të Bashkuara, GVOR, A/49/40, (vol.II), paragrafi 9.8, f. 181.

⁸² Van Alphen kundër Hollandës, Komunikimi nr. 305/1988, paragrafi 5.8.

⁸³ Neni 9 i PNDKP; neni 5 i KEDNJ; neni 6 i Kartës Afrikane; neni 7 i Konventës Amerikane.

⁸⁴ Bossuyt, Mark, udhëzues për “Punime përgatitore” të paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, Pub. Martinus Nijhoff, 1987, A/C.3/SR.863. f. 36.

⁸⁵ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, komunikimi nr.90/1981, L.Magana ish-Philibert kundër Zaires (miratuar në 21 korrik 1983), në dok. e KB GAOR, A/38/40, f.200, paragrafi 7.2 dhe 8.

⁸⁶ Standardi përcakton se: “Për të përcaktuar nëse një vepër penale është e lehtë, duhet të vlerësohet nëse vepra e pretenduar ka si element përdorimin e forcës ose dhunës, mbajtjen e armës, ose shkeljen e një urdhëri të gjykatës që mbron sigurinë e personit ose të pronës”, Standardi 10-1.3; Standardi 10-2.1-2; 10-3.1.2.

Për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt, gjykatat duhet të japin qartësisht arsyet për vendimet e tyre, në mënyrën dhe kohën e duhur.⁸⁷ Vendimet që imponojnë paraburgim për një individ ose që refuzojnë kërkesën për lirim, jo vetëm që nuk bëjnë përjashtim, por kundërshtojnë nivelin e arsytimit në to duhet të jetë edhe më i thelluar.⁸⁸ Arsyetimi duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme motivet mbi bazën e të cilave është bazuar vendimi, me qëllim krijimin e mundësisë së kontrollit në një instancë më të lartë (në apel). Për seancat dëgjimore të paraburgimit dhe apelit, kërkohet një shpjegim i veçantë përse arresti me burg është i nevojshëm, në raport me masat alternative të disponueshme, si dhe përse masat e tjera alternative janë të papërshtatshme.⁸⁹

B. Legjislacioni shqiptar

Dispozitat që rregullojnë kufizimin e lirisë duhet të përmbushin standardin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike.⁹⁰ Në bazë të Kushtetutës, një individ mund të ndalohej/arrestohet:

- ❖ kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose,
- ❖ për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose,
- ❖ largimin e tij pas kryerjes së saj”.⁹¹

Doktrina dhe praktika gjyqësore kanë pranuar se dyshimi i arsyeshëm nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra e të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet. Kjo bindje duhet të jetë e tillë që të pranohet përgjithësisht si e bazuar dhe e arsyeshme nga kushdo që njihet me rrethanat e faktit dhe provat që e vërtetojnë atë.⁹²

Në bazë të KPP, masa e sigurimit personal, ku përfshihet edhe arresti me burg, vendosen:

- ❖ kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- ❖ kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

⁸⁷ Neni 6/1, Reid, f 126.

⁸⁸ Komisioni ndër-amerikan, parimet dhe praktikat e mira, parimi IV.

⁸⁹ ABA Standardet e drejtësisë penale, Standardi 10-5.10.

⁹⁰ GjEDNj, në çështjen *Grori kundër Shqipërisë* (vendim i 7 korrikut 2009), në pg. 128 thekson: “Gjykata përsëriti se “kur bëhet fjalë për mohim të lirisë, është në veçanti e rëndësishme të plotësohet parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore. Pra, si rezultat, është shumë e rëndësishme që të përcaktohen qartë kushtet e mohimit të lirisë në të drejtën e brendshme dhe që ligji vetë të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të plotësojë standardin e “ligjshmërisë” së parashikuar nga Konventa, një standard që kërkon që i gjithë legjislacioni të jetë mjaftueshëm i saktë që t’i lejojë personit, - nëse nevojitet, me këshillim përkatës – të parashikojë, deri në një nivel që është i arsyeshëm për rrethanat, pasojat që mund të japë një veprim i caktuar” (shih Baranoëski k. Polonisë, nr. 28358/95, § 52, ECHR 2000-III).

⁹¹ Kushtetuta, neni 27/1/c.

⁹² Raport mbi Përfaqshjen e Legjislacionit Shqiptar me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Europës, Halim Islami, f.164, 2001.

- ❖ kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.⁹³

Vendimi i gjykatës për vleftësimin e masës së sigurimit arrest me burg duhet të jetë i arsyetuar dhe, ndër të tjera, të përmbajë “parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit...”.⁹⁴

Ç. Konkluzione

Sipas standardeve ndërkombëtare, vendimi për ndalimin duhet:

- ❖ të jetë mjaftueshëm i arsyetuar dhe nuk duhet të përdorë forma steriotipe të formulimit;
- ❖ argumentet pro dhe kundër paraburgimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”;
- ❖ gjykata duhet të argumentojë arsyet për paraburgimin dhe arsyet për rrëzimin e kërkesës për lirim.

Në përputhje me këto standarde, nenin 245/2 të KPrP, i ndryshuar, kërkon që vendimi i gjykatës për vleftësimin e masës së sigurimit arrest me burg duhet të jetë i arsyetuar dhe, ndër të tjera, të përmbajë “parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit...”.

4.4 Masat alternative

A. Standardet ndërkombëtare

a) Standardet relevante në Europë

GjEDNj ka theksuar se paraburgimi duhet të zbatohet vetëm si një masë përjashtimore. Në çështjen *Ambruszkiewicz kundër Polonisë*,⁹⁵ Gjykata deklaroi se “**ndalimi i një individi është një masë serioze e tillë që justifikohet vetëm kur masat e tjera më pak shtrënguese janë shqyrtuar dhe janë konsideruar si të pamjaftueshme për të ruajtur interesat e individit ose të publikut, të cilat mund të kërkojnë ndalimin e personit në fjalë. Kjo do të thotë se nuk mjafton që privimi i lirisë të jetë në përputhje me ligjin kombëtar, por ai duhet të jetë i nevojshëm sipas rrethanave**”.

Për më tepër, GjEDNj ka theksuar **përdorimin e proporcionalitetit në vendimmarrje**, sipas të cilit autoritetet duhet të shqyrtojnë masa alternative më pak shtrënguese përpara se të

⁹³ KPrP, neni 228/3.

⁹⁴ Po aty, neni 245/1 shkronja “ç”.

⁹⁵ *Ambruszkiewicz kundër Polonisë*, apl. 38797/03, 4 maj 2006, f 31.

kalojnë të ndalimi,⁹⁶ dhe ato duhet të shqyrtojnë nëse “**vazhdimi i ndalimit të akuzuarit është i domosdoshëm**”.⁹⁷

Cilido qoftë justifikimi për paraburgimin, ai është i nevojshëm vetëm kur alternativat e diskutuara më lart nuk adresojnë në mënyrë efektive rreziqet që mund të vijnë nga i akuzuari. Për rrjedhojë, gjykatat duhet të japin masën e arrestit në burg ndaj një individi, vetëm nëse pasi kanë shqyrtuar numrin më të madh të mundshëm të llojeve të masave alternative, ato konkludojnë se paraburgimi mbetet i nevojshëm për të adresuar rreziqet e përmendura më lart. Duke marrë këtë vendim, gjykatat duhet të shqyrtojnë nëse lirimi i të akuzuarit përbën rrezik për viktimën e krimit për të cilën ai është i akuzuar. Barra për të treguar çfarëdo rreziku që bart i akuzuari duhet t’i takojë autoritetit procedues ose gjyqtarit hetues.⁹⁸

Një nga këto alternativa është lirimi i të dyshuarit brenda shtetit ku është rezident nën mbikëqyrje, duke vendosur masa sigurimi që e pengojnë atë të dalë nga shteti apo përtej një territori të përcaktuar. Shtetet nuk duhet ta justifikojnë ndalimin duke iu referuar statusit të të dyshuarit si shtetas/i huaj, por ato duhet të shqyrtojnë nëse masat mbikëqyrëse do të mjaftonin për të garantuar paraqitjen e të dyshuarit në gjykim. Nëse rreziku i fshehjes/largimit mund të evitohet nëpërmjet garancisë finaciare ose ndonjë lloj garancie tjetër, i akuzuari duhet të lirohet”.⁹⁹

Përdorimi i qëndrueshmëmi i masave alternative ndaj arrestit në burg ballafaqohet me një numër sfidash që është i lidhur me cilësinë e dobët të arsyetimit dhe dështimit për të siguruar se paraburgimi është masa e fundit. Në përgjithësi, masat alternative janë të disponueshme dhe arresti në burg, sipas ligjit, është i kufizuar ndaj situatave në të cilat asnjë alternativë nuk mund të përdoret. Megjithatë, përdorimi i masave alternative ndaj arrestimit mbetet ende i ulët (Irlanda, Anglia dhe Wellsi janë vende që kanë praktika të mira të aplikimit të masave alternative).¹⁰⁰

(i) Alternativat e disponueshme

Një sërë alternativash ndaj ndalimit që janë të disponueshme dhe të përdorshme në BE zakonisht përfshijnë një përzgjedhje të masave kufizuese/shtrënguese, si për shembull: ndalim i lëvizjeve/udhëtimeve dhe kufizime të tjera gjeografike dhe rezidenciale, mbikëqyrje nga gjykata ose policia, dhe në disa vende, mbikëqyrje elektronike dhe arrest në shtëpi. Sidoqoftë, duhet mbajtur parasysh se një skemë alternative kërkon kurdoherë përmbushjen e kushteve nga i akuzuari, si dhe kushtin që duhet të merret fillimisht pëlqimi i të akuzuarit.¹⁰¹

⁹⁶ Ladent kundër Polonisë, apl. 11036/03, 18 mars 2008, f. 55.

⁹⁷ Po aty, f. 79.

⁹⁸ Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e masës së dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 8/2.

⁹⁹ Mangouras kundër Spanjës, apl. 12050/04, 28 shtator 2010, f.79.

¹⁰⁰ Raporti i Fair Trial, 2016.

¹⁰¹ Këshilli i Europës, Rekomandimi (87)18, lidhur me thjeshtësimin e sistemit penal, paragrafi 1/a/7.

Këshilli i Europës ka mbajtur qëndrimin se “alternativat ndaj paraburgimit duhet të përdoren sa më gjerë që të jetë e mundur”.¹⁰² Alternativat e disponueshme duhet të përfshijnë, të paktën, një larmishmëri të gjerë dhe të mjaftueshme opsionesh të përshtatshme për të trajtuar rreziqet dhe nevojat specifike të të akuzuarit.¹⁰³

b) Standardet e Kombeve të Bashkuara dhe praktikat e tjera më të mira ndërkombëtare

Paraburgimi duhet të urdhërohet vetëm nëse ka baza të arsyeshme për të besuar se i akuzuari është përfshirë në kryerjen e një veprë të pretenduar dhe se ekziston rreziku që ai të largohet, se ai mund të kryejë vepra të tjera të rënda ose se procesi i drejtësisë do të cenohej seriozisht nëse ai do të ishte i lirë.¹⁰⁴

Të gjitha standardet e diskutuara në këtë seksion bazohen në parimin se arresti me burg gjatë procesit të gjykimit duhet të minimizohet sa të jetë e mundur. Nga natyra e tij, paraburgimi përfshin ndalimin e individëve, të cilët nuk janë shpallur ende fajtorë për veprën penale. Ashtu siç ka theksuar Komiteti për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara (KDNj), paraburgimi mund të ndikojë negativisht në prezumimin e pafajësisë,¹⁰⁵ dhe, për pasojë ai duhet të përdoret vetëm si “mjete i fundit”.¹⁰⁶

Ka një numër masash që shtetet duhet të marrin për të minimizuar paraburgimin. **Së pari**, agjencitë ligjzbatuese dhe prokurorët duhet të mos iniciojnë ose të mos vazhdojnë procedimin kur akuzat janë të pabazuara ose të panevojshme (bazuar në mbrojtjen e shoqërisë, parandalimin e krimeve ose promovimin e respektit për ligjin dhe të drejtave të viktimës).¹⁰⁷ Për këtë qëllim, duhet të vendosen një sërë kriteresh për të udhëzuar policinë dhe prokurorët teksa vendosin nëse duhet të iniciojnë ose jo procedimin.¹⁰⁸

Së dyti, kur akuzat janë të bazuara, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të jenë të autorizuar për të disponuar për çështjet përmes mjeteve jogjyqësore dhe të bëjnë çdo përpjekje për ta arritur këtë gjë. Kur është e përshtatshme, shtetet duhet të krijojnë dhe të përdorin programe të ndryshme që i lejojnë të akuzuarit për t’iu shmangur një gjykimi penal të parashikuar, nëse ai përmbush një sërë detyrimesh, të tilla si rikthimi i sendeve të viktimës ose kryerja e orëve në shërbim të komunitetit.¹⁰⁹ Skema të ndryshme, krahas uljes së paraburgimit,

¹⁰² Këshilli i Europës, Rekomandimi (99)22 lidhur me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin në popullatën e burgjeve, paragrafi III(12).

¹⁰³ Kjo është një listë e nxjerrë nga Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e masës së dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 2/1; Standardet e drejtësisë penale për lirinë gjatë paraburgimit, ABA, standardi 10-1.2.

¹⁰⁴ Kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e të Pandehurve, Havana, 27 gusht- 7 shtator, 1990, kapitulli 1, paragrafi 2/b.

¹⁰⁵ Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Observimet përfundimtare: Argjentina, CCPR/CO/8/ARG (2000), paragrafi 10.

¹⁰⁶ Tërësia e Rregullave Minimum të Kombeve të Bashkuara për masat jo-ndaluese (Rregullat e Tokios), parimi 6.1

¹⁰⁷ Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për rolin e prokurorëve, paragrafi 14 dhe 18; Tërësia e Rregullave Minimum të Kombeve të Bashkuara për masat jo-ndaluese, parimi 5.1

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për rolin e prokurorëve, paragrafi 18; Këshilli i Europës, Rekomandimi (87)18, lidhur me thjeshtësimin e sistemit penal, seksioni 1.

minimizojnë stigmatizimin që rrethon akuzën dhe gjykimin dhe nxisin efektet e kundërta që vijnë nga burgimi.¹¹⁰

Me qëllim plotësimin e skemave alternative, shtetet duhet, kurdoherë që është e përshtatshme, të përdorin praktikën e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, në mënyrë që të rrisin efektivitetin në sistemin e drejtësisë penale dhe të minimizojnë paraburgimin.¹¹¹ Rrethanat, strukturat, organizatat dhe procedurat për mekanizmat alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të materializohen në ligj.

Edhe nëse një person do të gjykohej brenda një sistemi formal të drejtësisë penale, alternativat ligjore ndaj ndalimit duhet të jenë të disponueshme gjatë procesit gjyqësor. Rregullat Minimum të Kombeve të Bashkuara për masat jo-ndaluese (paragrafi 6.1) deklarojnë se **“alternativat ndaj paraburgimit duhet të përdoren në një fazë sa më të hershme që të jetë e mundur”**.

Alternativa të tilla duhet të jenë realiste dhe jo të mbishtënguara. Shtetet duhet të sigurojnë se një sistem funksional i plotë dhe i mjaftueshëm ekziston për të menaxhuar dhe zbatuar alternativat ndaj paraburgimit. Kjo kërkon një sistem efektiv për mbikëqyrjen dhe monitorimin e individëve të liruar, i cili është një kusht i zakonshëm për lirinë. Mekanizmat duhet të ekzistojnë për të verifikuar nëse individët janë duke përmbushur kushtet e lirim të tyre dhe të raportojnë shkeljet e këtyre kushteve dhe arrestimin lidhur me vepra të tjera penale.

Për t'u siguruar se alternativës ndaj paraburgimit i është kushtuar shqyrtimi i duhur nga autoritetet gjyqësore, shteteve mund t'u duhet të krijojnë një agjenci qeveritare përgjegjëse për të mbledhur informacion lidhur me individët ndaj të cilëve është shmangur paraburgimi. Ky informacion, i cili duhet të përfshijë një vlerësim për riskun si dhe rekomandime për alternativa të mundshme ndaj ndalimit, duhet të përdoret për të informuar vendimmarrjen lidhur me paraburgimin e marrë nga autoriteti gjyqësor.¹¹²

B. Legjislacioni shqiptar

Sipas KPrP, arresti me burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.¹¹³ Gjithashtu, vendimi i gjykatës për vleftësimin e masës së sigurimit arrest me burg, siç u përmend më sipër, duhet të përmbajë edhe arsyetimin për papërshtatshmërinë e masave të tjera të sigurimit.¹¹⁴

Në bazë të KPrP, masat alternative ndaj arrestit me burg janë:

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Lilongwe, Deklarata për aksesin në ndihmën ligjore në sistemin penal në Afrikë, paragrafi 5.1; Kampula, Deklarata për kushtet e burgjeve në Afrikë, paragrafi 1,2 dhe 3.

¹¹² Po aty.

¹¹³ KPrP, neni 230/1.

¹¹⁴ Po aty, neni 245/1 shkronja “ç”.

- a) ndalimi i daljes jashtë shtetit;
- b) detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore;
- c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar;
- ç) garancia pasurore;
- d) arresti në shtëpi.¹¹⁵

Kushtetuta parashikon të drejtën e personit që është ndaluar/arrestuar për procedimin e tij në gjendje të lirë kundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.¹¹⁶ Kjo e drejtë zbërthehet dhe konkretizohet në nenin 236 të KPrP, duke e kthyer këtë masë si më të natyrshmen, nëse i arrestuari ofron këtë garanci pasurore. Sipas kësaj dispozite, gjykata, edhe kur duhet të caktohet masa e sigurimit arrest me burg ose kur është caktuar kjo masë, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, mund të vendosë respektivisht qëndrimin e lirë të personit ose zëvendësimin e masës së arrestit me burg, duke urdhëruar lirimin e personit, nëse është ofruar garanci pasurore nga ai vetë ose një person tjetër për moslargimin e tij deri në përfundimin e gjykimit.¹¹⁷

Ç. Konkluzione

Legjislacioni duhet të jetë i hartuar në një mënyrë të tillë që inkurajojë përdorimin fleksibël të masave alternative ndaj ndalimit. Megjithëse në ligjin tonë të brendshëm këto masa janë të parashikuara, praktika gjyqësore nuk tregon efektivisht se ligji procedural penal inkurajon dhe lehtëson zbatimin e tyre.

4.5 Rishikimi

A. Standardet ndërkombëtare

- a) Standarde relevante në Europë (KE)

Sipas nenit 5/3 të KEDNj, gjykimi duhet të zhvillohet brenda një kohe të arsyeshme dhe procedimi me paraburgim i të akuzuarit duhet të drejtohet me vëmendje dhe shpejtësi të veçantë.¹¹⁸ Nëse këto kërkesa janë respektuar, ato duhet të vlerësohen nëpërmjet shqyrtimit të fakteve individuale të rastit.¹¹⁹ GjEDNj ka konkluduar se zgjatja e afatit të paraburgimit ndërmjet 2.5 dhe 5 vjetëve është ekseseve.¹²⁰

Kurdorherë kur është marrë një vendim për të vendosur në paraburgim një individ gjatë procesit të gjykimit nga një autoritet gjyqësor në shkallë të parë, i paraburgosuri duhet të ketë të drejtën, të parashikuar nga ligji, për të apeluar vendimin në një shkallë më lartë

¹¹⁵ KPrP, neni 232/1.

¹¹⁶ Kushtetuta, neni 28/3.

¹¹⁷ KPrP, neni 236, pikat 1-2.

¹¹⁸ Stogmuller kundër Austrisë, apl. 1602/62, 10 nëntor 1969, f. 5.

¹¹⁹ Buzadj kundër Moldavisë, apl. 23755/07, 16 dhjetor 2014, f.3.

¹²⁰ PB kundër Francës, apl. 38781/97, 1 gusht 2000, f.34.

gjyqësore ose tek një autoritet tjetër kompetent.¹²¹ E drejta për të apeluar zbatohet gjithashtu edhe kur lirimi i kushtëzuar është revokuar ose kur është zgjatur periudha e mëparshme e ndalimit.¹²²

Procedurat e apelimit duhet të përmbushin të njëjtat kërkesa për proces të rregullt si ato për vendimmarrjen në shkallë të parë.¹²³ Megjithatë, duke patur parasysh se procesi i apelimit ka formate të ndryshme në sisteme të ndryshme ligjore, mënyra në të cilën interesat e palëve mbrohen do të varet nga struktura dhe funksionimi i trupës së apelit.¹²⁴

Paraburgimi duhet të jetë objekt i kontrollit gjyqësor të vazhdueshëm,¹²⁵ në të cilin të gjitha palët (i pandehuri, trupi gjyqësor dhe prokurori) duhet të jenë të aftë për ta iniciuar atë.¹²⁶ Seanca dëgjimore e rishikimit duhet të realizohet në formën e dëgjimit verbal dhe sipas parimit të kontradiktoritetit, ku të sigurohet barazia e armëve ndërmjet palëve.¹²⁷ Kjo gjë kërkon akses te dokumentet e dosjes/çështjes,¹²⁸ gjë e cila konfirmohet tashmë edhe nga direktiva për të drejtën e informimit, neni 7/1. Vendimi për vazhdimin e ndalimit duhet të merret me shpjëtesë dhe të jepen arsye për nevojën e vazhdimin të ndalimit.¹²⁹ Vendimet e mëparshme nuk duhet thjesht vetëm të riprodhohen.¹³⁰

Kur rishikohet vendimi i paraburgimit, GjEDNj kërkon që gjykatat e shteteve të jenë të hapura në mbështetje të ekzistencës së prezumimit ligjor në favor të liritë.¹³¹ Vazhdimi i ndalimit “mund të justifikohet në rastin konkret vetëm nëse ka tregues specifikë të interesave reale të interesit publik, pa cenuar prezumimin e pafajësisë, që prevalojnë rregullin për respektimin e lirisë të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ”.¹³² Autoritet janë të detyruara të shqyrtojnë nëse mund të përdoren masat alternative.¹³³

Sipas standardeve të GjEDNj, rishikimi i paraburgimit duhet të ndodhë në mënyrë automatike, pa qenë nevoja që i pandehuri të aplikojë për këtë veprim,¹³⁴ dhe në intervale të arsyeshme me qëllim që i ndaluari të mos rrezikojë të qëndrojë në ndalim, më gjatë se sa koha në të cilën privimi i lirisë nuk mund të justifikohet.¹³⁵ Këshilli i Europës deklaroi se “intervali ndërmjet rishikimeve nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj, përveç

¹²¹ Rregullat minimum të Kombeve të Bashkuara për masat jo-ndaluese, paragrafi 6.3.

¹²² Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e masës së dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, paragrafi 18.

¹²³ GjEDNj, Delcourt kundër Belgjikës, 17 janar, 1970, Seria A, nr.11, paragrafi 25-26; Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Koment i përgjithshëm 13, paragrafi 17, megjithëse kjo lidhet me apelimet për fajësinë dhe dënimin.

¹²⁴ Reid, ..., f. 72.

¹²⁵ De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës, apl. 2832,2835,2899/66, 18 qershor 1971, f.76

¹²⁶ Rakevich kundër Rusisë, apl. 58973/00, 28 tetor 2003, f.43.

¹²⁷ Singh kundër Mbretërisë së Bashkuar/MB, apl. 23389/94, 21 shkurt 1996, f.65.

¹²⁸ Wloch kundër Polonisë, apl. 27785/95, 19 tetor 2000, f. 127.

¹²⁹ Illijkov kundër Bullgarisë, apl. 33977/96, 26 korrik 2001, f. 84.

¹³⁰ Michalko kundër Sllovakisë, apl. 35377/05, 21 dhjetor 2010, f 145.

¹³¹ Po aty.

¹³² McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar, apl 543/03, 3 tetor 2006, f. 42.

¹³³ Darvas kundër Hungarisë, apl. 19574/07, 11 janar 2011, f. 27.

¹³⁴ McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar, apl 543/03, 3 tetor 2006, f. 34.

¹³⁵ Abdulkhakov kundër Rusisë, apl.14743/11, 2 tetor 2012, f. 209.

rasteve kur personi konkret ka të drejtën dhe është shqyrtuar, në çdo kohë, një kërkesë për lirim”.¹³⁶

b) Standardet e Kombeve të Bashkuara dhe praktikat më të mira ndërkombëtare

Një individ i privuar nga liria përpara gjykimit duhet të ketë të paktën tri rrugë të disponueshme për të kundërshtuar ndalimin e tij:

- ❖ apelimi i zakonshëm për imponimin e ndalimit;
- ❖ mjete të jashtëzakonshme dëmshtëpërlimi për ligjshmërinë e ndalimit; dhe
- ❖ garanci për kontroll periodik të ndalimit.

Ka disa shembuj të standardeve të pëlqyeshme të kontrollit në procesin e apelimt. Komiteti për të Drejtat e Njeriut (KDNj) i Kombeve të Bashkuara (KB) është shprehur, teksa diskutonte nenin 14/5 të PNDCP lidhur me të drejtën për të apeluar vendimin e fajësisë, se një proces apelimi që kontrollon vetëm pretendime për shkelje të ligjit dhe nuk mban seancë dëgjimi, “nuk përmbush kërkesat... për një vlerësim të plotë të provave dhe të procesit të gjykimit.”¹³⁷

Neni 9/4 i PNDCP i njeh të drejtën çdo personi të arrestuar ose të ndaluar për të vlerësuar ligjshmërinë e ndalimit në gjykatë, një dispozitë që e ka burimin nga e drejta anglo-amerikane *habeas corpus*. Nëse gjykata nuk e gjen të ligjshëm ndalimin, ajo duhet të urdhërojë lirin e menjëhershëm të të ndaluarit. KDNj në çështjen *A. kundër Australisë* (nr.560/1993, paragrafi 9.5), ligjshmërinë e ndalimit e përcaktoi të lidhur jo vetëm me respektimin e ligjit të vendit, por dhe të përputhjes me PNDCP. KDNj ka përkufizuar gjithashtu termin “gjykatë” si një trupë me natyrë gjyqësore që ka kompetencën për të urdhëruar lirin e të ndaluarit, duke përcaktuar se vendimet e një trupe administrative për ndalimin duhet të kontrollohen nga një trupë gjyqësore me qëllim që ato të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 9/4. Kjo do të zbatohet njëllëj edhe për sistemin ushtarak ligjor.¹³⁸ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara ritheksojnë se një person nuk duhet të mbahet i ndaluar pa patur një mundësi efektive për t’u dëgjuar menjëherë përpara një autoriteti gjyqësor ose një autoriteti tjetër. Autoriteti gjyqësor apo një autoritet tjetër duhet të jenë kompetentë për të rishikuar vazhdimin e ndalimit ose jo, dhe i ndaluari duhet të ketë të drejtën, sipas ligjit të shtetit përkatës, për të kundërshtuar në çdo kohë ligjshmërinë e ndalimit të tij përpara organit gjyqësor ose një organi tjetër.¹³⁹

KDNj nuk e ka sqaruar kuptimin e frazës “pa vonesë” të nenit 9/4 të PNDCP, megjithëse e ka gjetur si shkelje vonesën prej 5 javësh apo 3 muajsh. Sipas Grupit të Parimeve të KB, të ndaluarit mund të kundërshtojnë ligjshmërinë e ndalimit të tyre në çdo

¹³⁶ Këshilli i Europës, Rekomandimi (2006) 13 për përdorimin e dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit, neni 17/2.

¹³⁷ Domukovsky dhe al. kundër Gjeorgjisë, Komunikimi nr. 623/1995, 624/1995, 626/1995, dhe 627/1995 (29 maj 1998), paragrafi 18.11, CCPR/C/62/D/623/1995.

¹³⁸ Vuolanne kundër Finlandës, Komunikimi nr.265/1987, paragrafi 9.6.

¹³⁹ Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të ndodhur nën Cdo Lloj Forme Ndalimi apo Arrestimi (Grupi i Parimeve), Parimi 11, 32, <http://www.un.org/documents/ga/res/43/a43r173.htm>

kohë.¹⁴⁰ Po ashtu, Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara kërkojnë që personi i ndaluar të ketë të drejtën për mbrojtje dhe konsulencë ligjore edhe gjatë fazës të gjyqimit në apel.

Kurdoherë kur një autoritet gjyqësor vendos të ndalojë një individ gjatë procesit të gjyqimit, Grupi i Parimeve të Kombeve të Bashkuara kërkojnë që autoriteti të bëjë një kontroll të vazhdueshëm të ndalimit të individit.¹⁴¹ Ky rishikim duhet të jetë automatik dhe nuk kërkon një veprim nga ana e të ndaluarit. I ndaluari duhet të lirohet nëse ndalimi nuk është më i nevojshëm, sipas një prej kërkesave të përmendura më lart, ose kur koha e gjatë e ndalimit është e tillë që ka sjellë cenimin e të drejtës së të ndaluarit për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

B. Legjislacioni shqiptar

Në bazë të Kushtetutës, i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjykatës dhe të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm.¹⁴² KPrP ka rregulluar në mënyrë më të detajuar procedurat për apelimin e vendimit të arrestit me burg dhe afatet e paraburgimit. Sipas KPrP, brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës, në bazë të të cilit është caktuar masa e sigurimit arrest me burg, personi i arrestuar ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë.¹⁴³

Gjykata që ka vendosur arrestin me burg, jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, ka detyrimin të marrë në pyetje personin e arrestuar, për të verifikuar kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së arrestit dhe nevojat e sigurimit. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, ajo vendos revokimin ose zëvendësimin e masës, në të kundërt vendos vazhdimin e zbatimit të saj.¹⁴⁴ Pra, në këtë rast nuk kërkohet që gjykata të vihet në lëvizje nga i arrestuari. Në seancën e pyetjes të të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre.¹⁴⁵ Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshimtarë.¹⁴⁶ Gjykata duhet të depozitojë vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve.¹⁴⁷ Kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit arrest me burg, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve.¹⁴⁸ ¹⁴⁹ Siç vërehet, ndryshimet e fundit në KPrP kanë sjell përmirësime lidhur me standardet për rishikimin e masës së sigurimit brenda një afati të arsyeshëm, garantimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, në frymën e standardeve ndërkombëtare.

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Po aty, parimi 39.

¹⁴² Kushtetuta, neni 28/3.

¹⁴³ KPP, neni 249/1. Afati i mëparshëm, përpara ndryshimeve që solli ligji 35/2017, ishte 10 ditë.

¹⁴⁴ Po aty, neni 248, pikat 1-2.

¹⁴⁵ Po aty.

¹⁴⁶ Po aty, neni 248, pika 4.

¹⁴⁷ Po aty.

¹⁴⁸ Po aty, neni 249/1.

¹⁴⁹ Lidhur me fillimin e afatit të ankimit nga njoftimi shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr. 40/2012, me kërkesë Shkëlqim Meçe; vendimin e Gjykatës së Lartë, nr.28, date 29.02.2005.

Ankimi i përmendur më sipër paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila detyrohet që brenda 3 ditëve nga realizimi i njoftimeve të dorëzojë aktet në gjykatën e apelit që do të shqyrtojë vendimin.¹⁵⁰ Ankimi duhet të shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Gjykata e apelit, ka kompetencën për të vendosur, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit dhe duhet ta depozittojë vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve.¹⁵¹ Nëse gjykata nuk e depoziton vendimin e arsyetuar brenda afatit, akti mbi bazën e të cilit është marrë masa sigurimit e humbet fuqinë.¹⁵² Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet rekurs për shkelje të ligjit në Gjykatën e Lartë.^{153 154 155}

Si rregull, masa e sigurimit arrest me burg revokohet menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të saj. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin ose zëvendësimin e masës së arrestit shqyrtohet brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj.¹⁵⁶ Sipas KPrP, çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori duhet të informojë me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni duhet të përmbajë të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk e informon në afatin e përcaktuar, gjykata duhet të verifikojë nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Shqyrtimi ndjek rregullat e procesit të rregullt që ndiqen nga gjykata për kontrollin fillestar dhe rishikimin e arrestit, të përmendura më sipër.¹⁵⁷

Në KPrP janë përcaktuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit për çdo fazë të procedimit.¹⁵⁸ Për fazën e hetimeve paraprake, paraburgimi e humbet fuqinë me kalimin e tre muajve kur procedohet për kundërvajtje penale, gjashtë muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim dhe dymbëdhjetë muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjetë burgim ose me

¹⁵⁰ Po aty, neni 249/3

¹⁵¹ Gjykata Kushtetuese, në vendimin 28/2011, me kërkesë Kujtim Kryekurti, i referohet rastit të GJEDNJ Sarban kundër Moldavisë, vendim i datës 4 tetor 2005, lidhur me standardin e arsyetimit: “GJEDNJ –ja është shprehur se “...Në arsyetimin e vendimit të gjykatës për masat e sigurimit, duhet të analizohen në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimi ose jo të kërkesës/ankesës për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit dhe jo të bëhet një përshkrim ritual e formal i shkaqeve e kriterëve, të parashikuara nga ligji”.

¹⁵² Po aty, neni 249, pikat 6-7.

¹⁵³ Po aty, neni 249/8.

¹⁵⁴ GJK, në vendimin 28/2011, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se “...mosrespektimi i afatit 15 ditor, të përcaktuar nga neni 249/10 i KPP-së për marrjen e vendimit nga Gjykata e Lartë në rast rekursi kundër masave të sigurimit, nuk passjell humbjen e fuqisë së masës së sigurimit, në dallim nga mosrespektimi i afatit 10 - ditor për marrjen e vendimit në rast apeli të masës së sigurimit në Gjykatën e Apelit, sipas nenit 249/5 të KPP, dhe kjo për arsye se neni 249/7 i KPP-së ka përcaktuar në mënyrë të shprehur vetëm efektet e mosrespektimit të afatit 10 -ditor në rast mosshqyrtimi të apelit.” Me ndryshimet e fundit në KPP, afati 15 ditor për marrjen e vendimit imponon gjykatën e apelit.

¹⁵⁵ Lidhur me procedurat që duhet të ndiqen nga Gjykata e Lartë, kur ka juridiksion fillestar, për vleftësimin e masës së arrestit, shih vendimin e GJK nr.75/2015, me kërkesë Tom Doshi.

¹⁵⁶ Po aty, neni 260.

¹⁵⁷ Po aty, neni 246/6.

¹⁵⁸ Neni 263.

burgim të përbërshëm. Kohëzgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrë parasysh zgjatjet e parashikuara sipas ligjit, nuk mund të kalojë dhjetë muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, dy vjet kur procedohet për krime që dënohen në minimum deri në dhjetë vjet, dhe tre vjet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet ose me burgim të përbërshëm.¹⁵⁹

Me kalimin e gjashtë muajve nga zbatimi i vendimit të arrestit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit për kohëzgjatjen e paraburgimit, e cila duhet të vendosë brenda 15 ditëve.¹⁶⁰ Nga formulimi i dispozitës nuk del e qartë nëse i pandehuri mund të pretendojë revokimin e masës me argumentin se arsyet mbi të cilat është caktuar arresti, nuk e justifikojnë vazhdimin e masës për shkak të ndryshimit të rrethanave. Por, duke marrë parasysh rregullin e përgjithshëm, gjykata, krahas vlerësimit të pretendimit për kohëzgjatjen e paraburgimit, duhet të shqyrtojë edhe pretendimet për revokimin ose ndryshimin e masës.

I dënuari që ka qenë i paraburgosur, siç kërkohet nga neni 5/5 i KEDNj, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është marrë masa është nxjerrë pa qenë kushtet e kërkuara nga ligji, ka të drejtën e kompesimit për paraburgimin e vuajtur.¹⁶¹

Ç. Konkluzione

Siç u përmend më sipër, GJEDNj, në çështjen *Delijorgji k. Shqipërisë* (vendimi i 28 Prillit 2015), ndër të tjera ka konkluduar se “Duke patur parasysh interpretimin kontradiktor të gjykatave vendase në lidhje me pikënisjen e afatit kohor të ndalimit “gjatë procesit gjyqësor”, Gjykata argumenton se privimi i lirisë së ankuesit nuk është trajtuar me masat mbrojtëse të duhura kundër arbitrarizmit. ... Me qëllim përlllogaritjen e kohëzgjatjes së ndalimit “gjatë procesit gjyqësor”, legjislacioni shqiptar, më konkretisht neni 263 § 2 i KPrP nuk ishte i qartë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe dështoi në standardin e “cilësisë së ligjit” të kërkuar në përputhje me Konventën...” Ky konkluzion i GJEDNj imponon ligjëvënësin për të rishikuar dispozitën përkatëse me qëllimin për të shmangur paqartësitë dhe keqinterpretimet në praktikë.

Rekomandimi i Këshilli i Europës, (2006) 13, “Për përdorimin e dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit”, në nenin 17/2,

¹⁵⁹ GJEDNJ, në çështjen *Delijorgji k. Shqipërisë* (vendimi i 28 prillit, 2015), ndër të tjera ka konkluduar se “74. Duke patur parasysh interpretimin kontradiktor të gjykatave vendase në lidhje me pikënisjen e afatit kohor të ndalimit “gjatë procesit gjyqësor”, Gjykata argumenton se privimi i lirisë së ankuesit nuk është trajtuar me masat mbrojtëse të duhura kundër arbitrarizmit (shiko *Shaposhnikov kundër Rusisë*, nr. 8998/05, § 47, 29 Korrik 2010; *Ismoilov dhe të Tjerët kundër Rusisë*, nr. 2947/06, §§ 138-39, 24 Prill 2008; dhe *Nasrullojev kundër Rusisë*, nr. 656/06, § 77, 11 Tetor 2007). Me qëllim përlllogaritjen e kohëzgjatjes së ndalimit “gjatë procesit gjyqësor”, legjislacioni shqiptar, më konkretisht Neni 263 § 2 i KPP nuk ishte i qartë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe dështoi në standardin e “cilësisë së ligjit” të kërkuar në përputhje me Konventën (shiko paragrafin 70 më sipër si edhe *Ječius* cituar më sipër, § 59; *Mooren kundër Gjermanisë* [GC], nr. 11364/03, § 76, 9 Korrik 2009; dhe *Steel dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 23 Shtator 1998, § 54, *Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve* 1998-VII).

¹⁶⁰ Po aty, neni 249 pikat 9-10.

¹⁶¹ Po aty, neni 268.

kërkon që “intervali ndërmjet rishikimeve nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj, përveç rasteve kur personi konkret ka të drejtën dhe është shqyrtuar, në çdo kohë, një kërkesë për lirim”. Sipas neni 246/6 të KPrP gjykata rishikon masën e sigurimit çdo dy muaj. Pra, ky parashikim nuk është në harmoni me Rekomandimin e KE-së më sipër.

4.6 Përfundime dhe Rekomandime

a) Për legjislacionin

Legjislacioni nuk duhet vetëm të mishërojë/përsërisë standardet e KEDNJ, por, sidoqoftë, ai duhet të synojë gjithashtu ofrimin e udhëzimeve mbi procedurat nëpërmjet të cilave këto standarte mund të bëhen operacionale/të zbatueshme.

Konkretisht, legjislacioni mund t’u ofrojë autoriteteve procedura të njëpasnjëshme/hap pas hapi, nëpërmjet të cilave të sigurohet se standardet thelbësore të KEDNJ-së zbatohen në mënyrë reale dhe praktike. Kështu, për shembull, letra e të drejtës që kërkohet nga neni 4 i Direktivës së BE për të drejtën e informimit bën operacionale standardet e GJEDNJ-së. Kjo qasje do të sjellë hap pas hapi përfitim për vendimmarrësit, jo vetëm nëpërmjet identifikimit të faktorëve që duhet të shqyrtohen dhe adresohen, por gjithashtu edhe për radhën sipas së cilës ato duhet të merren në shqyrtim, për të siguruar (për shembull) se testi për dyshimin dhe aksesin të provat është i sigurt, dhe se argumentet nga të gjitha palët dhe alternativat e paraburgimit janë shqyrtuar në mënyrë të plotë para se të vendoset ndalimi.

GJEDNJ, në çështjen *Delijorgji k. Shqipërisë* (vendimi i 28 prillit, 2015) rithekson se ajo “duhet të sigurohet nëse vetë ligji vendas është konform Konventës, duke përfshirë parimet e përgjithshme të shprehura ose të nënkuptuara në të. Në këtë pikë të fundit, Gjykata thekson se, nëse bëhet fjalë për privimin e lirisë, është e rëndësishme që të përmbushet parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore. Për këtë arsye është thelbësore që kushtet për privimin e lirisë sipas ligjit vendas të përcaktohen qartë dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë të tillë që të përmbushë standardin e “ligjshmërisë” të parashikuar nga Konventa, një standard i cili kërkon që i gjithë ligji të jetë mjaftueshëm preciz në mënyrë të tillë që të lejojë personin - nëse është e nevojshme me këshillimin e duhur – të parashikojë, deri në shkallën që është e arsyeshme për rrethanat, pasojat të cilat mund t’i shkaktojë një akt i caktuar.” (pg. 70 i vendimit)

Ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale, në frymën e Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare, përcaktojnë disa garanci më specifike për respektimin e të drejtave procedurale që gëzon i ndaluari ose i arrestuari. Duhet evidentuar, veçanërisht, parashikimi në nenin 34/b për njohjen e të ndaluarit me të drejtat e tij nëpërmjet “letrës së të drejtave” në formë të shkruar, e cila duhet t’i jepet personit të ndaluar kundrejt nënshkrimit. Ky parashikim është në harmoni me kërkesën e nenit 4 të Direktivës së BE për të drejtën e informimit. Mbetet për t’u vëzhguar se si do të zbatohet në praktikë kjo garanci e rëndësishme.

Sipas standardeve ndërkombëtare të trajtuara më lart i ndaluari duhet të njihet me materialet e çështjes/dosjes, në një kohë sa më të hershme, në funksion të mbrotjes efektive dhe

barazisë së armëve. Parashikimi në nenin 34/a shkronja “ë” për të drejtën për t’u njohur me materialet e çështjes, nuk përfshihet në pikën 1 të nenit 34/b, ndërkohë që shkronja “b” e pikës 1 të nenit 34/b ia njeh këtë të drejtë. Gjithashtu, edhe neni 248, pika 1, parashikon se “mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre”. Këto dy parshikime, duke mos qenë në harmoni, mund të krijojnë hapësirë për keqinterpretim në praktikë, që mund të rezultojë në cenimin e të drejtës së të ndaluarit.

Standardet ndërkombëtare nuk imponojnë detyrimin që seancat gjyqësore vendimmarrëse për arrestin në burg të zhvillohen të mbyllura. Si rregull, seanca duhet të bëhet publike, përveç rastit kur, për arsye të parashikuara nga ligji, gjykata vendos që seance të zhvillohet e mbyllur.

Sipas standardeve ndërkombëtare vendimi për ndalimin duhet të jetë mjaftueshëm i arsyetuar dhe nuk duhet të përdorë forma stereotipe të formulimit; argumentet pro dhe kundër paraburgimit nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”; gjykata duhet të argumentojë arsyet për paraburgimin dhe arsyet për rrëzimin e kërkesës për lirim. Në përputhje me këto standarde, nenin 245/2 të KPP, i ndryshuar, kërkon që vendimi i gjykatës për vleftësimin e masës së sigurimit arrest me burg duhet të jetë i arsyetuar dhe, ndër të tjera, të përmbajë “parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit...”.

Legjislacioni duhet të jetë i hartuar në një mënyrë të tillë që inkurajojë përdorimin fleksibël të masave alternative ndaj ndalimit. Megjithëse në ligj, këto masa janë të parashikuara praktika gjyqësore nuk tregojnë se ligji procedural penal inkurajon dhe lehtëson zbatimin e tyre.

Siç u përmend më sipër, në çështjen *Delijorgji k. Shqipërisë*, ndër të tjera GJEDNJ ka konkluduar se “Duke patur parasysh interpretimin kontradiktor të gjykatave vendase në lidhje me pikënisjen e afatit kohor të ndalimit “gjatë procesit gjyqësor”, privimi i lirisë së ankuesit nuk është trajtuar me masat mbrojtëse të duhura kundër arbitraritetit. ... Me qëllim përlllogaritjen e kohëzgjatjes së ndalimit “gjatë procesit gjyqësor”, legjislacioni shqiptar, më konkretisht neni 263 § 2 i KPP nuk ishte i qartë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe dështoi në standardin e “cilësisë së ligjit” të kërkuar në përputhje me Konventën...” Në kuadër të ndryshimeve që ka pësuar gjatë reformës në drejtësi, Kodi ynë i Procedurës Penale, pas dhënies së këtij vendimi, nuk rezulton që kjo dispozitë të jetë ndryshuar dhe qartësuar. Ky konkluzion i GJEDNJ imponon ligjvënësin për të rishikuar dispozitën përkatëse me qëllimin për të shmangur paqartësitë dhe keqinterpretimet në praktikë.

Rekomandimi i Këshilli i Europës, (2006) 13, “Për përdorimin e dërgimit në ndalim, kushtet në të cilat ai zbatohet dhe dispozitat e garancisë kundër abuzimit”, në nenin 17/2, kërkon që “intervali ndërmjet rishikimeve nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj, përveç rasteve kur personi konkret ka të drejtën dhe është shqyrtuar, në çdo kohë, një kërkesë për lirim”. Sipas neni 246/6 të KPP gjykata rishikon masën e sigurimit çdo dy muaj. Pra, ky parashikim nuk është në harmoni me Rekomandimin e KE më sipër.

5. Statistika zyrtare dhe vështrim mbi zbatimin e arrestit në burg dhe alternativat e tij, në nivel kombëtar

(bazuar në burimet zyrtare të autoriteteve vendase dhe organizatat ndërkombëtare)

Aplikimi në nivele të larta i paraburgimit, cenimi i të drejtave procedurale të shtetasve të paraburgosur në Shqipëri dhe aspektet e lidhura me mungesën e një trajtimi human ndaj tyre janë analizuar dhe përcjellë në mënyrë të vazhdueshme, në disa raste me nota shqetësuese, në një sërë raportesh të organizatave ndërkombëtare si psh të Komisionit Evropian, Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Ç’njerëzor apo Degradues (KPT) përfshi edhe vlerësimin periodik nga Departamentit Amerikan i Shtetit.

Në raportin më të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019¹⁶² vërehet një përmirësim në zbatimin e alternativave të paraburgimit, të cilat janë rritur në krahasim me periudhën e mëparshme të raportimit nga Komisioni. Konkretisht janë zbatuar 6171 alternativa të arrestit në burg gjatë vitit 2018, krahasuar me 4904 të tilla në vitin 2017. Në këtë raport vërehet se është pezulluar mbikqyrja elektronike prej vitit 2017, për shkak të një mosmarrëveshjeje ligjore. Në raport rekomandohet rritja e zbatimit të alternativave të ndalimit (paraburgimit) për kategoritë në nevojë të të huajve si fëmijët, gratë e rrezikuara dhe shtetasit me probleme shqetësuese shëndetësore, sikurse parashikohet në ligjin për të huajt. Me hapjen e burgut të ri në Shkodër, i financuar nga BE, është vërejtur disi progres në adresimin e mbipopullimit në burgje. Në total, numri i të akomoduarve në sistemin e burgjeve është ulur me 8%.

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për të drejtat e njeriut në Shqipëri për vitin 2019¹⁶³, i bërë publik në fillim të vitit 2020, evidentohen një sërë problematikash që vijnë si rezultat i aplikimit në nivele të larta të tij, por edhe si rezultat i mangësive të vërejtura në funksionimin e hallkave të drejtësisë. Sipas të dhënave të sigurara nga DASH, nga Gushti i vitit 2019, rezulton se 42% e popullatës në sistemin penitenciar janë persona të paraburgosur (me arrest në burg). Ligji shqiptar kërkon përfundimin e hetimeve paraprake brenda tre muajve, por prokurori mund të kërkojë zgjatjen e tij. Ndërkohë që paraburgimi në total nuk duhet të kalojë tre vjet. Paraburgimi tej afatave sipas DASH, ndodh për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve të mbrojtjes ose dështimit të qëllimshëm të avokatit mbrojtës. Ligji u mundëson gjyqtarëve të mbajnë avokatët “shkelës” që nuk e përfillin apo i binden gjykatës. Si arsye që ndikojnë në zgjatjen e paraburgimit të lidhura me mosrespektimin e afatit të gjykimeve, DASH vlerëson burimet e kufizuara materiale, mungesën e hapësirës, menaxhimin e dobët të kalendarit gjyqësor, stafin e pamjaftueshëm dhe mosparaqitjen e avokatëve dhe dëshmitarëve. DASH evidenton mbipopullim të lartë në disa prej institucioneve penitenciare, duke cituar të dhënat e siguruar nga KShH, e cila ka konstatuar një mbipopullim shqetësues në IEVP Zahari në Qershor të 2019-ës, me 114 persona tej kapacitetit zyrtar. Gjithashtu, në raportin e DASH reflektohen edhe konstatimet e Avokatit të Popullit, që evidenton se në ambientet e shoqërimit/ndalimit nën mbikqyrjen

¹⁶² <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

¹⁶³ <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/ALBANIA-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

e Ministrisë së Brendshme është vërejtur mbipopullim, i cili vjen kryesisht për shkak të mungesës së koordinimit me apo vonesave nga Ministria e Drejtësisë.

Në raportin, i cili i është komunikuar Qeverisë Shqiptare, në vijim të vizitës së realizuar në vendin tonë nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Ç’njerëzor dhe Degradues (KPT)¹⁶⁴, i bërë publik në dt.17 Shtator 2019, shprehet shqetësimi mbi elementët e torturës dhe trajtimit ç’njerëzor si dhe shkeljes së të drejtave procedurale të personave të ndaluar/arrestuar. Në mënyrë të ngjashme me situatën e vërejtur gjatë vizitës së mëparshme, KPT evidenton se një numër i personave të ndaluar ankohen se, pavarësisht se kanë kërkuar një avokat kryesisht menjëherë pas kapjes së tyre, policia ka “injuruar” kërkesën e tyre (ose kjo kërkesë është përmbushur pas një vonese të konsiderueshme. Kjo ka bërë që këta persona të pyeten informalisht lidhur me veprën penale të dyshuar, pa prezencën e një avokati (pra para se të merren në mënyrë zyrtare deklaratat e personit të dyshuar). Gjithashtu, pavarësisht kërkesave ligjore, personat e ndaluar/arrestuar nuk i nënshtrohen në mënyrë sistematike kontrollit mjekësor që në momentin fillestar të vendosjes së tyre në ambientet e policisë. Kontrolli i tyre mjekësor kufizohet në disa pyetje të përgjithshme nga stafi i kujdesit shëndetësor në prani të një oficeri policie dhe shtetasi nuk ekzaminohej fizikisht. Në këtë raport, KPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimi nga policia. Në mënyrë të veçantë, oficerëve të policisë duhet tu përsëritet në mënyrë të rregullt se çdo formë e keqtrajtimin (përfshirë edhe format e abuzimit verbal) ndaj personave të ndaluar është e paligjshme dhe do të dënohet në përputhje me rrethanat.

Në Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit për 2018¹⁶⁵ evidentohet se objekti i ankesave të qytetarëve ka qënë i larmishëm si psh keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë, për trajtim jo human në mjediset e organeve të policisë ku mbahen të shoqëruarit, të arrestuarit/ndaluarit, etj. Ky institucion ka administruar disa ankesa të qytetarëve për sjellje jo korrekte të punonjësve të policisë në rastet e kapjes së persona në kërkim si autorë të dyshuar të veprave penale, kur kanë shkelur rregullat e Kodit Rrugor, apo gjatë kontrolleve rutinë të policisë. Në disa raste, vërehet se me qëllim justifikimin dhe mbulimin e veprimeve të kundërligjshme, punonjësit e policisë bëjnë kallzime dhe i arrestojnë ata për veprat penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit” dhe atë të “Goditjes së punonjësit të policisë”. Pas arrestimit, gjykata i vlerëson të ligjshëm arrestimet në flagrancë dhe ndërkohë ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg”. Gjithashtu, raporti i Avokatit të Popullit evidenton shkeljet procedurale të vërejtura në ndalimin e 23 personave që kanë qënë pjesë e tubimit të datës 31.03.2018 në “Rrugën e Kombit” për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë. Organi i akuzës çënoi të drejtat e të ndaluarve duke llogaritur si kohë ndalimi orën e vendosjes së tyre në dhomat e sigurisë dhe jo kur qytetarëve u janë vënë prangat në banesë. Nga studimi i urdhërave të ndalimit, tek pjesa arsyetuese organi procedues, jo vetëm që nuk paraqiti asnjë arsye ligjore të ndalimit të personave, por gjithashtu nuk vërtetoi asnjë kusht për ekzistencën e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes për secilin prej tyre.

¹⁶⁴ <https://rm.coe.int/168097986b>

¹⁶⁵ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raport%20Vjetor%202018.pdf>

Interes për mënyrën se si janë zbatuar masat e sigurimit personal dhe në mënyrë të veçantë ajo e arrestit në burg, paraqesin të dhënat dhe statistikat zyrtare të siguruara nga komunikimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve apo të bëra publike në raportet vjetore të institucioneve shqiptare, sikurse është raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm dhe vjetarët statistikorë të Ministrisë së Drejtësisë.

KShH ka komunikuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të marrë informacion statistikor lidhur me numrin e personave të paraburgosur, në institucionet penitenciare që janë në juridiksionin territorial të gjykatave ku është kryer monitorimi ynë, përgjatë periudhës që mbulon ky monitorim. Këto të dhëna janë të analizuara në aneksin nr.II që i bashkëlidhet këtij raporti. Gjithashtu, KShH ka marrë informacion lidhur me numrin e personave të paraburgosur në institucionet penitenciare, në rang kombëtar përgjatë vitit 2019 si dhe kostot financiare që i shkaktohen buxhetit të shtetit nga akomodimi i tyre në këtë sistem. Kostoja ditore e shpenzimeve për mbajtjen e një të paraburgosuri në sistemin penitenciar gjatë vitit 2019 është 2,910 Lek. Kostoja totale financiare në buxhetin e shtetit, për akomodimin e personave të paraburgosur në vendin tonë për vitin 2019, paraqitet në nivele të larta, përkatësisht rreth 2.29 miliard Lek (të reja) ose saktësisht 2,289,125,697 Lek. Për një vend me ekonomi të brishtë si vendi ynë, por duke patur parasysh edhe kushtet sociale-ekonomike, veçanërisht të grupeve në nevojë, kjo kosto mund të ishte reduktuar nëse organet e sistemit të drejtësisë penale do të ndiqnin një politikë penale më lehtësuese në drejtim të caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”.


Kostoja faktike ditore për një të dënuar sipas kategorive për vitin 2019

	Kategoria	Shp. Lekë/ viti 2019	numri	365 ditë/vit	Shpenzime lekë/ditë/ 1 person	Kursi këmbimit	Shpenzime Euro/ditë / 1 person
12.0	Të gjithë	5,699,664,072	5,152	365	3,031	125.00	24.25
12.1	Të p/burgosur	2,289,125,697	2,155	365	2,910	125.00	23.28
12.2	Të dënuar	2,752,634,465	2,896	365	2,604	125.00	20.83
12.3	Të sëmurë	309,509,073	74	365	11,459	125.00	91.67
12.4	Të mitur	77,296,970	27	365	7,843	125.00	62.75

Kjo e parë në aspektin total të kostos, pra duke përfshirë çdo shpenzim të kryer në shërbim të të dënuarve dhe të shpërndarë sipas një koeficienti specifik.

Në dt.1 Janar të vitit 2019, në sistemin e burgjeve figurojnë të jenë në total 5580 shtetas. Raporti midis shtetasve të dënuar dhe atyre të paraburgosur që janë akomoduar në këtë sistem, po në këtë datë, paraqitet mjaft i ngushtë. Konkretisht, 2268 persona ose 40.6% janë shtetas ose individë të paraburgosur dhe 3033 ose 54.3% janë shtetas apo individë të dënuar.

Raporti të dënuar/të paraburgosur në sistemin e burgjeve në dt.1 Janar 2019




Përgjatë 12 muajve të vitit 2019, në sistemin e burgjeve ka patur 3864 pranime të reja të shtetasve apo të individëve të paraburgosur dhe atyre të dënuar. Sikurse do të vërehet nga tabela në vijim, shumicën dërrmuese të pranimeve të reja e përbëjnë shtetasit ose individët e paraburgosur, përkatësisht 3258 ose 84.3% e numrit total. Është e kuptueshme nga të dhënat e tabelës që statusi i tyre procedural mund të ketë ndryshuar përgjatë vitit, pra nga të paraburgosur mund të kenë kaluar me një masë më të butë sigurie, mund të jenë dënuar ose mund të jenë shpallur të pafajshëm apo çështja penale ndaj tyre mund të ketë pushuar. Referuar po kësaj tablele, rezulton se 606 pranime apo 15.6% e numrit total përbëhet nga shtetasit apo individët e dënuar.

Dinamika e pranimeve dhe lirimeve në IEVP viti 2019 Total

Nr.	Muajt	Pranime gjithsej	Komisariat e Paraburgim	Komisariate Burg	Lirim gjithsej	Lirim Denuar	Lirime Paraburgosur
1	Janar	273	225	48	264	101	163
2	Shkurt	305	263	42	274	104	170
3	Mars	272	244	28	301	116	185
4	Prill	308	259	49	313	125	188
5	Maj	351	286	65	371	157	214
6	Qershor	334	298	36	335	135	200
7	Korrik	335	293	42	489	204	285
8	Gusht	364	309	55	212	84	128
9	Shtator	319	281	38	314	150	164

10	Tetor	388	297	91	296	120	176
11	Nëntor	327	263	64	314	117	197
12	Dhjetor	288	240	48	401	117	284
TOTALI		3864	3258	606	3884	1530	2354

Në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit gjithashtu jepen informacione apo të dhëna statistikore për zbatimin e masave të sigurimit ndaj qytetarëve. Konkretisht, **në raportin e këtij institucioni për vitin 2019**¹⁶⁶, evidentohet se bazuar në disponimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në vitin 2019 janë regjistruar 397 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin dhe janë regjistruar 388 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Ndaj tyre janë vendosur 41 masa sigurimi, ose për rreth 10,6 % të të miturve, ku masa me arrest është për 6 % të të pandehurve të mitur. **Në raportin e këtij institucioni për vitin 2018**¹⁶⁷, rezulton se janë regjistruar 481 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale. Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, rezulton se janë dërguar për gjykim 235 çështje dhe janë pushuar 128 çështje. Për vitin 2018, zbatimi i masave të sigurimit në total ndaj të miturve të pandehur është 21.8%, pra paraqet nivele më të larta (gati dy fish) në krahasim me vitin 2019. Por ndërkohë, zbatimi i masës së arrestit në burg ndaj të miturve për vitin 2018, paraqitet në masën 5.18%, pra është më i ulët në krahasim me vitin 2019 (6%).



Ajo çka bie në sy në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2019 është se në disa pjesë të tij, evidentohet se janë zbatuar rekomandimet e Kuvendit i cili merr në shqyrtim raportin, për ashpërsimin e politikës penale në drejtim të masave të sigurimit. Kështu, në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit lidhur me:

¹⁶⁶ http://www.pp.gov.al/web/kuvendit_raporti_vjetor_2019_28_3_2020_pp_perf_1864.pdf

¹⁶⁷ http://www.pp.gov.al/web/raporti_vjetor_2018_1571.pdf

- a) veprat penale në fushën e korrupsionit, prokuroria pranë gjykatës për krime të rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2019 kanë kërkuar caktimin e caktimin e masës sigurimit “arrest në burg” në 92,5% të rasteve për personat e dyshuar dhe/ose të akuzuar janë për këto vepra penale.
- b) veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, prokuroria, në 85,6 % të rasteve ka kërkuar masën e sigurimit “arrest” dhe për 14,4 % të personave të dyshuar dhe/ose të akuzuar për këtë kategori veprash penale është kërkuar caktimi i detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore.

KShH vlerëson se rekomandimet e Kuvendit drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për të ashpërsuar politikën penale në drejtim të masave të sigurimit, nuk merr në konsideratë standartet ndërkombëtare që inkurajojnë se masa e sigurimit “arrest në burg” duhet të aplikohet si një masë e fundit dhe në raste përjashtimore. Gjithashtu, ky rekomandim, nuk respekton pavarësinë e prokurorëve për të vlerësuar rrezikshmërinë e veprës penale në fjalë, në raport me kërkesat dhe kriteret e tjera ligjore që parashikon Kodi i Procedurës Penale për masën e sigurimit “arrest në burg”. Gjithashtu, do të ishte me interes që në raportet vjetore të ardhshme të Prokurorit të Përgjithshëm të evidentohen statistika në nivel kombëtar, dhe të kategorizuara sipas llojit të veprave penale, për numrin e ndalimeve/arrestimeve në flagrancë të personave të dyshuar dhe cilat janë masat e sigurimit që prokuroria ka kërkuar në gjykatë për këta shtetas (të kategorizuara sipas llojit të masës së sigurimit personal).

Nëse do të analizojmë të dhënat statistikore për zbatueshmërinë e masave të sigurimit personal, të publikuara në raportet vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, vërehet se në krahasim me vitin 2016, zbatimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, për procedimet e reja penale/të rifilluara ka pësuar një ulje të lehtë në krahasim me vitin 2017, në raport me numrin total të masave të dhëna dhe numrin e të pandehurve/akuzuarve. Mgjth, është e paqartë nëse kërkesat e tjera penale kanë ose jo lidhje me masat e sigurimit, pasi në fakt statistikat për masat e sigurimit mund të kategorizoheshin veçmas nga kërkesat e tjera penale. Gjithashtu, lind nevoja që këto të dhëna të pasqyrohen në mënyrë më të qartë, duke pasqyruar këtu edhe dinamikën e ndryshimit të masës për të njëjtin të pandehur.


Konkretisht, **në vitin 2016, vjetari statistikor**¹⁶⁸ evidenton se nga **16,561** kërkesa penale gjithsej, **4,534** janë masë sigurimi arrest me burg, **972** janë masë sigurimi arrest shtëpie, **3,504** janë masë sigurimi detyrim paraqitjeje, **169** janë masë sigurimi arrest në mungesë, **818** janë rivlerësim i masës së sigurimit, **45** janë masa për vendosjen e garancisë pasurore, **27** janë njohje të vendimeve penale të huaja dhe **7,030** janë kërkesa të tjera penale.

Në vitin 2017, vjetari statistikor¹⁶⁹ evidenton se nga 19,513 kërkesa penale gjithsej, 3,807 janë masë sigurimi arrest me burg, 965 janë masë sigurimi arrest shtëpie, 3,037 janë masë sigurimi detyrim paraqitjeje, 164 janë masë sigurimi arrest në mungesë, 664 janë rivlerësim i masës së sigurimit, 47 janë masa për vendosjen e garancisë pasurore, 41 janë njohje të vendimeve penale të huaja dhe 10,788 janë kërkesa të tjera penale.

¹⁶⁸ http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Vjetari_2016.pdf

¹⁶⁹ <http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Vjetari-Statistikor-2017.pdf>


Në vitin 2018, vjetari statistikor¹⁷⁰ evidenton se nga 22,398 kërkesa penale gjithsej, 2,863 janë masë sigurimi arrest me burg, 542 janë masë sigurimi arrest shtëpie, 2,461 janë masë sigurimi detyrim paraqitjeje, 108 janë masë sigurimi arrest në mungesë, 761 janë rivlerësim i masës së sigurimit, 73 janë masa për vendosjen e garancisë pasurore, 11 janë njohje të vendimeve penale të huaja dhe 15,579 janë kërkesa të tjera penale.



Në aspektin numerik vërehet një ulje e masës së sigurimit “arrest në burg”, për procedimet e reja penale/të rifilluara për vitet 2018 dhe 2017, krahasuar me vitin 2016, ndërkohë që po ti referohemi shifrave të shprehura në përqindje (sipas tabelës së mësipërme krahasimore), masa e sigurimit arrest në burg ka pësuar një rënie të lehtë vetëm me 2% në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016. Ndërkohë që përqindja e aplikimit të kësaj mase për vitet 2017 dhe 2018 është pothuajse e njëjtë. Ndërkaq, masat e tjera të sigurimit vijojnë të aplikohen nga gjykatat pothuajse në përqindje të njëjta, me pak luhetje nga viti në vit (me diferenca 1-2%). Garancia pasurore shënon një rritje gati me dyfish në vitin 2018, në krahasim me vitin 2017 dhe 2016. Mgjth, në raport me masat e tjera, aplikimi i kësaj mase duket i papërfillshëm.

Gjithashtu, po ti referohemi vjetarëve statistikorë dhe më konkretisht numrit total të pandehurve ndaj të cilëve është dhënë masë sigurimi “arrest në burg”, duke përllogaritur këtu jo vetëm të pandehurit që kanë patur procedime të reja në secilin vit respektiv, por gjithashtu edhe të pandehurit për procedimet penale të mbartura nga vitet e mëparshme, procedimet e rifilluara apo ato të ardhura me transferim, rezultojnë të dhënat në përqindje të reflektuara në tabelën grafike në vijim.

¹⁷⁰ <http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/Vjetari-Statistikor-2018-PDF.pdf>



E shprehur në mënyrë më të kuptueshme, tabela e mësipërme evidenton se:

- a) gjatë vitit 2016 (po në këtë vit apo të mbartura nga vitet e tjera), 39% e të pandehurve kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”;
- b) gjatë vitit 2017 (po në këtë vit apo të mbartura nga vitet e tjera), 37% e të pandehurve kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg” dhe,
- c) gjatë vitit 2018 (po në këtë vit apo të mbartura nga vitet e tjera) kemi një rënie më të ndjeshme të të pandehurve me këtë masë, në nivelin 28.9%.


Pra numri total i të pandehurve që kanë qëndruar me masën e sigurimit “arrest në burg” paraqet një rënie të ndjeshme në vitin 2018, në krahasim me vitet 2017 dhe 2016. Ndërkohë që në vitin 2017, rënia e të pandehurve me masën arrest në burg është e lehtë, gati 2% në krahasim me vitin 2016. Mgjth, vërehet se tabloja e statistikave e ofruar ndër vite nga vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë nuk është e qartë, pasi mungojnë të dhënat për të pandehurit, të cilët mund të kenë përfituar një masë të ndryshme sigurimi për shkak të kërkesës së tyre apo të prokurorit për revokim/ndryshim mase apo si rezultat i ri-vlerësimit nga vetë gjykata.

6. Gjetjet e rezultuara nga monitorimi i seancave gjyqësore për masat e sigurimit personal (në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës)

6.1. Objekti i monitorimit

Objekti i monitorimit ishin seancat gjyqësore për vleftësimin e arrestimit/ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit personal, me fokus të veçantë caktimin e masës “Arrest me burg”, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Durrës.

Monitorimi u krye përgjatë periudhës **20 Shkurt – 30 Prill 2017**, kohë gjatë së cilës u monitoruan rreth **400 seanca gjyqësore**, konkretisht **319** në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe **79** në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Një numër tejet i lartë i seancave gjyqësore të caktimit të masave të sigurimit vërehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, krahasuar me atë të Durrësit, mesatarisht 5 seanca të zhvilluara në ditë. Seancat janë zhvilluar njëra pas tjetrës në 1 ose 2 salla gjykimi të përcaktuara paraprakisht për lehtësi menaxhimi, nga një gjyqtar i përcaktuar për shqyrtimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit.



Monitorimi u realizua nga vëzhguesit e KShH-së, jurist në përbërjen e stafit të organizatës tonë si dhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë (Universiteti i Tiranës). 10 vëzhguesit e përzgjedhur, u trajnuan paraprakisht mbi metodologjinë e monitorimit të seancave gjyqësore.


Gjatë kryerjes së këtyre monitorimeve, vëzhguesit e KShH-së janë fokusuar tek aspektet e lidhura me procesin e rregullt gjyqësor siç janë: publiciteti i seancave gjyqësore, respektimi i afateve të përcaktuara në KPrP për zhvillimin e seancave gjyqësore për caktimin e masave të sigurimit, parimi i solemnitetit, paanshmëria e gjyqtarit, prania e palëve në proces, barazia e armëve juridike, dhe njëkohësisht aspekte tematike si cilësia e mbrojtjes me avokat, gjeneralitetet e personave ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit (grupmoshat, gjinia), statusi social, ekonomik apo familjar, përkatësia në një grup vulnerabël, të qenit përsëritës, arsyetimi i kërkesës për masë siguri nga prokurori, dhe argumentimi i vendimit për caktimin e saj.

Për shkak të natyrës specifike të seancave, konkretisht afatet e ngushta brenda të cilave duhet të zhvillohet seanca e vleftësimit dhe caktimit të masës së sigurimit (brenda 48 orëve nga ndalimi/arrestimi) në pjesën dërrmuese të rasteve nuk është i mundur përditësimi i kalendarëve të seancave gjyqësore, me përjashtime shumë të rralla. Për këtë shkak u desh që monitoruesit të ishin të pranishëm thuajse çdo ditë në ambientet e gjykatave, në pritje të zhvillimit të seancave gjyqësore për masat e sigurimit personal.

6.2. Objekti i kërkesës së Prokurorisë

Në kërkesat e prokurorisë drejtuar gjykatës për caktimin e masave të sigurimit personal, mbizotëron në mënyrë të dukshme kërkesa për caktimin e masës “arrest në burg”. Konkretisht, në **64% (254 kërkesa)** të seancave të monitoruara, rezulton se objekti i kërkesës së prokurorit ka qenë “Vleftësimi i ligjshëm i arrestit/ndalimit dhe caktimi i masës së sigurisë arrest me burg”.

Në **29% (115 kërkesa)** të seancave të monitoruara, objekti i kërkesës së prokurorit ka qenë “Vleftësimi i ligjshëm i arrestit/ndalimit dhe caktimi i masës së sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Gjatë monitorimit është evidentuar **një rast** ku prokurori ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, si dhe një rast i kërkesës për masën e sigurimit “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”. Siç vërehet kërkesa për caktimin e masave të tjera të sigurimit personal janë shumë pak ose aspak të pranishme.



6.2.1. Kategorizimi i kërkesave të prokurorisë të lidhura me masat e sigurimit personal, sipas veprave penale

Vëzhguesit e KShH-së kanë mbledhur të dhëna lidhur me veprat penale për të cilat janë ndaluar si të dyshuar apo arrestuar në flagrancë shtetasit për të cilët prokuroria ka vendosur në lëvizje gjykatën. **Veprat penale, jo të gjitha paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore, çka nuk justifikon në disa raste, kërkimin e prokurorisë për arrest në burg, ndaj shtetasve.**

Në 20% të rasteve, pra në 1/5 e çështjeve të monitoruara, të ndaluarit/arrestuarit në flagrancë janë për veprën penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal”. Në 15% të rasteve, veprat penale janë në fushën e prodhimit, shitjes apo trafikimit të lëndëve narkotike (neni 283, neni 283/a i Kodit Penal). Një përqindje të konsiderueshme zë vepra penale e dhunës në familje, përkatësisht në 11% të rasteve (neni 130/a i K.Penal). Gjithashtu, veprat penale kundër pasurisë zënë përqindje të konsiderueshme, përkatësisht 13% (nenet 134, 135, 136, 137 të Kodit Penal). **Të dy kategoritë e fundit të veprave penale kundër familjes dhe pasurisë janë tregues i faktorë socio-ekonomike që ndikojnë në gjendjen e kriminalitetit në vend.**

Por, në një masë më të vogël vihet re edhe prania e veprave të tjera si: (a) armëmbajtje pa leje (neni 278, 279 i Kodit Penal) - 15 raste; (b) Korrupsion aktiv ndaj personave që ushtrojnë funksione publike (neni 244 i Kodit Penal) dhe korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259 i Kodit Penal) – 9 raste; (c) plagosje e lehtë me dashje (neni 89 i K.P) - 3 raste si dhe falsifikimi i dokumenteve (neni 189 i K.P); shkatërrimi i pronës private (neni 151 K.P); (ç) kundërshtimi i punonjësit të policisë (neni 235 K.P), vrasje me dashje (neni 76 i K.P) – 1 rast, etj.

6.3 Aspektet e procesit të rregullt gjyqësor dhe mbarëvajtja e proceseve gjyqësore për masat e sigurimit personal

a. Orari i fillimit të seancave gjyqësore

Sikurse është evidentuar më herët, në rastin e monitorimit të seancave gjyqësore të lidhura me masat e sigurimit personal mungojnë kalendaret me përcaktime të orareve të zhvillimit të tyre, për shkak të pamundësisë së përditësimit të orareve në sistem për një kohë të shkurtër. Seancat janë zhvilluar kryesisht në pjesën e parë të ditës, pa orare të përcaktuara për secilën seancë.

b. Vendi i zhvillimit të seancave gjyqësore


Zhvillimi i seancave gjyqësore në ambiente të përshtatshme për subjektet pjesëmarrëse në gjykim (në sallat e gjykimit) ndikon në solemnitetin dhe publicitetin e seancës gjyqësore. Në pjesën më të madhe të rasteve seancat janë zhvilluar në sallën e gjykimit, 98% të rasteve, dhe vetëm në 2% të rasteve seancat janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve. Në rreth 400 seanca të monitoruara, në 8 raste seancat janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve (përkatësisht 4 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe 3 në atë të Rrethit Durrës).

c. Publiciteti i seancave gjyqësore

Publiciteti i seancës gjyqësore është një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të rregullt gjyqësor. Ai parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe nenin 339 të Kodit të Proedurës Penale, ku thuhet se: “Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme”.

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore, në shumicën e rasteve monitoruesve të KShH-së nuk u janë shfaqur pengesa për monitorimin e seancave. Në rreth **95%** të rasteve vëzhguesit nuk janë penguar në ndjekjen e seancave, përkundrajt **5%** (konkretisht 19 raste) të rasteve kur janë shfaqur pengesa, të cilat nuk gjejnë justifikim në kuadrin tonë ligjor, me përjashtim të rasteve sporadike, kur seanca është zhvilluar me dyer të mbullura. Konkretisht këto pengesa janë vendosur për këto arsye:

- Kërkohej listë emrash e monitoruesve dhe përcaktimi i datave të caktuara kur do të jenë të pranishëm në gjykatë, edhe pse seancat gjyqësore janë të hapura deri në një vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e tyre me dyer të mbyllura;
- Në disa raste kërkohej pëlqimi paraprak i gjyqtarit për lejimin e ndjekjes së seancës nga monitoruesi;
- Relativ për zhvillim të seancave me dyer të mbyllura (pengesë e legjitimuar);
- Pamundësia për ndjekjen e seancës për shkak të hapsirës së kufizuar, në rastet kur seanca është zhvilluar në zyrë.



d. Respektimi i solemnitetit dhe etikës në proceset gjyqësore

Solemniteti në gjykim konsiston në zhvillimin e procesit gjyqësor në respektim të disa standardeve si: vendi i posaçëm, kushtet e zhvillimit të gjykimit, sjellja e përshtatshme të subjekteve të pranishëm etj. Ndërsa etika nënkupton pjesëmarrjen e gjyqtarëve në përcaktimin, respektimin dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes si dhe mbajtja e një pozicioni që mundëson pavarësinë, paanësinë dhe drejtësinë e tyre si gjyqtarë.

Në seancat gjyqësore të monitoruara, KShH ka konstatuar se në 99% të rasteve është respektuar solemniteti dhe është ruajtur etika gjyqësore nga gjyqtari dhe palët. Në 4 raste


të konstatuara të mosrespektimit të etikës së komunikimit nga palët, kjo nuk ka reflekuar në njëanshmëri të gjyqtarëve gjatë seancës gjyqësore.

e. Mbrojtja me avokat

Mbrojtja me avokat është një nga të drejtat themelore procedurale, parashikuar nga neni 48 dhe 49 i Kodit të Procedurës Penale dhe një nga garancitë thelbësore të zhvillimit të një procesi të drejtë gjyqësor. Ajo merr rëndësi edhe më të madhe, në rastet e seancave gjyqësore që kanë objekt masat e sigurimit personal, të diktuar nga natyra specifike e objektit të këtyre seancave (e tillë p.sh. është koha e kufizuar e njohjes me aktet etj.).

Në 98.5% të rasteve të shqyrtimit të kërkesës për vleftësimin e ndalimit/arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit, rezulton se ka qenë i pranishëm avokati. Në 5 nga seancat e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, personi i ndaluar/arrestuar ka deklaruar se do ta kryejë vetë mbrojtjen e tij. Në një seancë gjyqësore të zhvilluar po në këtë gjykatë, personi ndaj të cilit po caktohej masa e sigurimit personal është shprehur se nuk e dinte nëse kishte avokat apo jo, pasi nuk kishte komunikuar me familjen.

KShH vëren një raport të ngushtë midis personave që janë përfaqësuar me avokat privat dhe atyre që janë përfaqësuar me avokat të caktuar kryesisht (sheti). Konkretnisht, 56.5% e personave në seancat e monitoruara janë mbrojtur me avokat privat dhe 40.2% e tyre janë mbrojtur me avokat të caktuar kryesisht. Gjatë monitorimit është konstatuar se në 5.3% të rasteve mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur. Praktika e ndjekur përgjithësisht në këto raste është caktimi i një mbrojtësi tjetër nga gjykata prej listës së avokatëve kryesisht që qëndrojnë të gatshëm.



Në pjesën më të madhe të seancave të monitoruara, cilësia e mbrojtjes rezulton në nivele më të larta, kur ai/ajo është avokat privat, krahasuar me cilësinë e mbrojtjes së avokatëve kryesisht. Në 43.5% të seancave, avokati shprehet gjatë seancës lidhur me njohjen ose jo të materialeve të prokurorisë. Në 15% të seancave të monitoruara, avokati shprehet se nuk është njohur me materialet dhe në 16% të tyre ka kërkuar të njihet me to. Lidhur me këtë

kërkesë gjykata ka vendosur pranimin e saj në 85% të rasteve. Mospranimi për pjesën tjetër përbën cenim të mbrojtjes efektive.

Në 26.5% të seancave të monitoruara, mbrojtësi ka paraqitur prova lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale të cilat në pjesën më të madhe (94.6%) janë pranuar nga gjykata. Rastet e mospranimit të këtyre provave janë hasur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin se çështja nuk ka kaluar në gjykim. Pavarësisht nga fakti se kjo është një seancë që ka për objekt masën e sigurimit personal dhe jo gjykimin në themel të veprës penale, pranimi i provave lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale është e rëndësishme sepse mund të arrihet në vlerësime të drejta nëse duhet pranuar, ndryshuar apo refuzuar kërkesa e prokurorit për caktimin e masë së sigurimit.

Në tërësi të ndaluarit/arrestuarit dhe mbrojtësit u jepet e drejta të paraqesin pretendimet e tyre në seancat e monitoruara. Megjithatë për shkak të mungesës së kohës për të siguruar një mbrojtje efektive dhe për të konsultuar aktet e prokurorisë, apo për siguruar prova të tjera, dukej se mbrojtja ishte formale.


f. Paanshmëria dhe barazia e armëve juridike

Vëzhguesit e KShH-së kanë vërejtur se, parimi i barazisë së armëve juridike është zbatuar në tërësi. Nuk janë vërejtur raste, kur trupi gjykues të ketë favorizuar me sjelljen e tij, njërën ose tjetrën palë në proces apo raste evidente të një kompromisi të dukshëm midis të tre palëve në proces (gjykatës, prokurorisë dhe avokatit, të ndaluarit/arrestuarit). Megjithatë, parimi i barazisë së armëve kërkon në mënyrë të shprehur, mundësinë që palët në gjykim të jenë të mirë informuar dhe të komentojnë të gjitha provat e paraqitura. Në seancat e monitoruara ndodh rëndom që për shkak të pranisë së mbrojtjes aty për aty, pa patur mundësi reale për tu njohur paraprakisht me aktet dhe provat e prokurorisë, ky parim të cenohet.

Me ndryshimet e fundit në KPrP është shtuar shkronja ç) e nenit 245, pika 1, ku parashikohet se: *“Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban, me pasojë pavlefshmërie: ... Parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të këtij Kodi”*. Duke vlerësuar se në shumë raste avokatët pjesëmarrës në këto seanca janë të caktuar kryesisht dhe/ose një pjesë të tyre nuk u jepet kohë të njihen me aktet e prokurorisë, ky shtim në dispozitë përbën një garanci pozitive, lidhur me barazinë e armëve juridike dhe po ashtu cilësinë e mbrojtjes me avokat.

Përsa i përket provave dhe cilësisë së tyre rezulton se, në 76.3% të rasteve prokurori mbështetet vetëm në provat e marra nga policia dhe në 21% të rasteve, edhe në provat e marra si rezultat i hetimit dhe përpunimit të akteve të policisë. Në këtë mënyrë, rrezikohet cënimi i barazisë së armëve në seancë gjyqësore. Pasojë e kësaj janë edhe vendimet e gjykatës, të cilat orientohen kryesisht nga provat e paraqitura nga prokurori dhe kërkesa e tij për caktimin e masës së sigurimit.

Provat mbi të cilat bazohet vendimi i gjykatës për masat e sigurimit



Si karakteristikë tipike e zhvillimit të këtyre seancave është fakti se, në shumë raste, të njëjtët avokatë marrin pjesë me të njëjtët prokurorë apo gjyqtarë në vleftësimin e ndalim/arrestimit dhe caktimin e masave të sigurimit. Zakonisht në gjykatat e monitorara u vu re se caktohet një ose dy gjyqtarë, të cilët vendosin për të gjitha kërkesat e masave të sigurimit të ditës. Ndërkohë, shpesh është konstatuar që i njëjti prokuror të ndjekë 3 apo më shumë seanca gjyqësore me të njëjtin gjyqtar, në mënyrë të njëpasnjëshme. Po e njëjta gjë është vënë re edhe me avokatin e caktuar kryesisht, ku ka patur edhe raste në të cilat avokati ka qenë përfaqësues në të gjitha seancat gjyqësore për masat e sigurimit të ditës. Kjo situatë, ngre problematikën e në procesi të rregullt gjyqësor në tërësi e në veçanti të cenimit të parimit të paanshmërisë. Monitorimi i disa seancave të njëpasnjëshme me të njëjtin prokuror dhe të njëjtin gjyqtar i jep, së paku, karakter tejet mekanik shqyrtimit të kërkesës për masë sigurimi. Raste të tilla mund të rezultojnë në dëm të personit ndaj të cilit po shqyrtohet kërkesa për masë sigurimi.

g. Zhvillimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm (afati i parashikuar në K.Pr.P)

Në 98.4% të rasteve vleftësimi i ndalimit/arrestimit dhe caktimi i masës së sigurimit personal është vendosur në të njëjtën seancë. Në rastet kur është vendosur shtyrja e seancave, kjo ka ardhur për shkak të mungesës së prokurorit, dhënies kohë avokatit për tu njohur me materialet si dhe pas kërkesës për shtyrje për marrjen e një prove të rëndësishme. Pothuajse në të gjitha rastet, seanca e radhës është caktuar brenda të njëjtës ditë.

6.4 Kategorizimi i të dhënave të personave ndaj të cilëve janë kërkuar dhe/ose caktuar masa të sigurimit personal

Në 85.5% të rasteve personat ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit ishin të arrestuar në flagrancë dhe 13% të ndaluar.

Nga monitorimet e seancave gjyqësore ka rezultuar se 97% e personave ndaj të cilëve është kërkuar masa e sigurimit janë meshkuj dhe vetëm 3% janë femra.

Në 76% të rasteve ata janë persona të padënuar më parë, në 18.3% të rasteve janë persona të dënuar më parë, ndërsa në 3.5% të rasteve janë të padënuar më parë, por të hetuar ose gjykuar për një vepër tjetër penale.


Sa i përket gjendjes familjare, 30.4% (113) rezultojnë persona të martuar dhe me fëmijë, 46 % (171) janë beqarë pa persona në ngarkim, 5.1% janë beqarë por me persona në ngarkim në familje dhe 3% janë persona të martuar pa fëmijë.

Për 241 personat e arrestuar/ndaluar, për të cilët u mor informacion rreth punësimit të tyre, u vërejt se 134 prej tyre (56%) nuk janë në marrdhënie pune. Përsa i përket personave të punësuar, shumica janë të vetëpunësuar në biznese familjare ose ushtrojnë zanate të ndryshme si taksist, hidraulik, mekanik, murator, etj.

Nga monitorimi i seancave rezultoi se një pjesë e personave ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit i përkasin **grupeve të ndryshme vulnerabël**. Konkretisht, në 15 raste, personat ndaj të cilëve është vlerësuar kërkesa për masë sigurimi janë pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian. Këta persona janë të akuzuar kryesisht për veprat penale të dhunës në familje, si dhe prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. Kërkesa për masë sigurimi i janë paraqitur gjykatës edhe **për 5 shtetas të huaj, të cilët janë të shtetësive kosovare, greke dhe angleze**.


Masat e sigurimit të dhëna ndaj të miturve nën moshën 18 vjeç kanë qenë 19, në 10 prej të cilave gjykata ka vendosur masën e sigurimit arrest me burg, ndërsa veprat penale për të cilat është dhënë kjo masë janë kryesisht: vjedhje me dhunë ose në bashkëpunim, prodhim dhe shitje lëndësh narkotike, armëmbajtje pa leje. Ndërsa, numri i masave të dhëna për të rinjtë në moshën 18-21 vjeç ka rezultuar 29.

Po ashtu janë konstatuar 5 raste të personave me probleme të shëndetit mendor. Për të gjitha këto raste, është kërkuar masa e sigurisë “arrest në burg” nga prokurori dhe veprat penale për të cilat caktohet kjo masë janë kryesisht vjedhje, dhunë në familje, prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. Kërkesa e prokurorit është pranuar në të gjitha rastet. Në një nga këto raste, edhe pse i ndaluar shprehte vazhdimisht shenja të problemeve me shëndetin mendor (apo së paku gjendje e axhituar apo depresive), prokurori nuk kishte asnjë informacion në lidhje me gjendjen mendore të tij dhe gjyqtari nuk i mori parasysh pretendimet e të ndaluarit në lidhje me shqetësime të natyrës së shëndetit mendor duke caktuar kështu, masën e sigurimit “arrest në burg”.




6.5 Vendimmarrja e gjykatës

Në 79% të seancave të monitoruara ka rezultuar se gjykata ka vendosur vleftësimin e ndalimit/arrestimit dhe caktimit të masës së sigurimit të kërkuar nga prokurori, në 17 % të seancave gjykata ka vendosur dhënien e një mase më të lehtë se ajo e kërkuar nga prokurori, dhe në 4% të rasteve ka vendosur lirimin e menjëhershëm të të ndaluarit/arrestuarit. Pra, qartazi vërehet që vendimmarrja e gjykatës bazohet në shumicën dërrmuese të seancave të monitoruara tek kërkesa e prokurorit të çështjes.



Nga monitorimi i seancave gjyqësore u vu re se masa e sigurimit “Arrest me burg” vijon të jetë më e zbatueshmja ndër të gjitha masat sigurimit personal, konkretisht në **46.1% (176)** të rasteve. Zbatimi i “arrestit në burg” përbën efektivisht alternativën e parë dhe jo atë përjashtimore për organet tona të sistemit të drejtësisë penale. Nivelet e larta të zbatimit të kësaj mase janë tregues i mosrespektimit të standarteve ndërkombëtare dhe legjislacionit tonë vendas. E renditur pas saj, është masa “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, e cila është zbatuar në masën **44% (168)** të rasteve të monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së. Ndërkohë që në nivel tepër të ulët paraqitet zbatimi i alternativave të tjera të masave të sigurimit, përkatësisht të “Arrestit në shtëpi” i zbatuar në 5.8% të rasteve, “Garancisë pasurore” i zbatuar në 3.1 % të rasteve, dhe masat “Ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar” dhe “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, zbatuar respektivisht në 0.5% të rasteve të monitoruara. Veç këtyre masave, në 3 raste gjykata ka vendosur edhe masën ndaluese pezullim nga detyra (për punonjës të policisë bashkiake).



Përsa i përket shpalljes së vendimit, vendimi i gjykatës është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë.

7. Gjetjet e rezultuara nga studimi sasior dhe cilësor i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës

7.1 Objekti i studimit

Në këtë seksion, analizohen të dhëna sasiore dhe cilësore që kanë rezultuar nga studimi i vendimeve të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2015, për masat e sigurimit personal. Në total janë studiuar 1821 vendime të këtyre dy gjykatave, me objekt: “Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë ose të ndalimit; Caktimin e masës së sigurimit personal; Zëvendësim apo revokim të masave të sigurimit personal; si dhe Caktimin e masës së sigurimit me afat”.

Studimi i këtij kampioni relativisht të gjerë dhe gjithëpërfshirës vendimesh është bërë nga ekspertë me njohuri të avancuara të legjislacionit penal dhe proceduralo-penal, me profesion avokat, pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë (Universiteti i Tiranës), juristë me angazhime të spikatura për të drejtat dhe liritë e njeriut. Këta ekspertë janë ndihmuar në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore nga vëzhgues apo ekspertë junior (studentë të Fakultetit të Drejtësisë apo juristë të rinj në profesion).

Fokus i këtij studimi është identifikimi i problematikave në caktimin e masave të sigurimit personal. Duke pasur parasysh natyrën ekstremisht sensitive të kufizimit të lirisë dhe veçanërisht të rasteve kjo liri kufizohet përmes aplikimit të masës “arrest në burg”, jemi ndalur në këtë studim, duke patur në fokus të veçantë pikërisht këtë masë të sigurimit personal në lidhje me mënyrën se si janë zbatuar kushtet dhe kriteret Ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Analiza cilësore e vendimeve është bërë në mënyrë të veçantë në këndvështrimin kritik dhe ka patur si qëllim evidentimin e mangësive në zbatimin e legjislacionit procedural penal dhe në zbatimin e praktikës gjyqësore unifikuese, kushtetuese dhe atë të GjEDNj.

Për realizimin e këtij studimi është mbajtur në konsideratë struktura/çështjet/pyetjet specifike të adresuara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, të lidhura me aspekte të tilla si:

- Mbrojtja me avokat (cilësia e mbrojtjes; cilësia e mbrojtjes në vartësi të mënyrës si janë caktuar mbrojtësit)
- Barazia e armëve juridike (avantazhimi nga gjykata i njërës apo tjetrës palë; raste kompromisi).
- Kërkesa e prokurorit mbështetet vetëm në prova të marra nga policia apo vërehet të jetë zhvilluar hetim dhe përpunim i akteve të policisë?
- Si do të vlerësohej arsyetimi i bërë nga gjykata në vendimin për caktimin ose jo të masës së sigurimit? A është i ngjashëm arsyetimi i gjykatës me argumentat në kërkesën e prokurorit?
- Në caktimin e masës së sigurimit, a ka mbajtur gjykata parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret?
- A i referohet gjykata, në vendimin e saj, gjendjes së mbipopulluar në institucionet e paraburgimit?

- A është caktuar masa e sigurimit në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete?
- Si paraqitet vlerësimi nga gjykata i vazhdimësisë, përsëritjes, rrethanave lehtësuese e rënduese të parashikuara në Kodin Penal?
- Kur masa e arrestit në burg ka qenë me afat dhe ky afat është zgjatur nga gjykata, a janë marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 264/2 të KPrP?
- Evidentimi i ekzistencës së informacionit me shkrim nga ana e prokurorit për të arrestuarin, çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit (Neni 246/6 KPrP).
- Revokimi apo ndryshimi i masave në një fazë të mëvonshme, etj.


Gjithashtu, ekspertët e angazhuar nga KShH kanë analizuar nga pikëpamja sasiore, gjeneralitetet e personave ndaj të cilëve kërkohet/caktohet masa e sigurimit si psh grupmoshat, gjinia, statusi social, ekonomik, familjar, përkatësia në një grup vulnerabël, të qenit përsëritës, etj.

Vlen të evidentohet se, të dhënat e grumbulluara dhe të analizuara në këtë seksion, nuk rezultojnë gjithmonë të pasqyruara në mënyrë të plotë nga secili ekspert, për arsye të plotësisë së vendimit të studiuar por edhe të qasjes individuale të secilit ekspert në marrjen dhe përpunimin e të dhënave që janë siguruar nga vendimet objekt studimi.

7.2 Mbrojtja me avokat

a) Të dhëna sasiore

Studimi i vendimeve gjyqësore evidenton se i ndaluari/arrestuari në 96,8% (1724) të rasteve përfaqësohet me avokat, nga të cilat 57,8% (1007) raste përfaqësohen me avokat të zgjedhur, ndërsa 39,1% (681) përfaqësohen me avokatë të caktuar kryesisht. Këto të dhëna, evidentojnë një numër të lartë të personave që kanë kërkuar nga gjykata caktimin e një avokati kryesisht, pra avokati të financuar nga shteti për ti përfaqësuar në këto seanca. Gjithashtu nga të dhënat e monitorimit rezulton se në 1,6% (28) të rasteve, i ndaluari/arrestuari nuk përfaqësohet nga avokat dhe në 1,6% (28) të rasteve të tjera kjo e dhënë nuk mund të evidentohet.



Referuar të dhënave të pasqyruara në vendimin gjyqësor sa i takon respektimit të parimit për të dëgjuar të arrestuarin/të ndaluarin ose mbrojtësin e tij rezulton se, në 96.3% (1660) raste ky parim respektohet, në 3.3% (57) të rasteve kjo e dhënë nuk del, ndërkohë që në vetëm 0,4% (7) të rasteve, i arrestuari/ndaluari dhe mbrojtësi i tij nuk dëgjohej.

Në 51,8% (898) të vendimeve të studiuar, avokati mbrojtës është shprehur gjatë seancës në lidhje me njohjen ose jo të materialeve të prokurorisë. Në 24% (415) të vendimeve, avokati nuk është shprehur nëse është njohur ose jo me materialet e prokurorisë. Ndërsa në 24,2% (419) të rasteve kjo e dhënë nuk mund të evidentohet.

Në vendimet e studiuar është evidentuar se, në 72,4% (1258) të rasteve, avokati mbrojtës nuk ka paraqitur prova lidhur me ekzistencën ose të veprës penale. Ndërkohë që në 22,9% (398) të rasteve kjo e dhënë nuk mund të evidentohet. Ndërsa në 4,7% (82) të rasteve rezulton se avokati mbrojtës ka paraqitur në seancë gjyqësore prova lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale.

b) Të dhëna cilësore

Për shkak të rëndësisë së veçantë, e drejta e mbrojtjes efektive me avokat, gjen rregullim të posaçëm në Kushtetutë, KPrP, Ligjin Nr.9109, datë 17.07.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, e po ashtu edhe në Kodin e Etikës për Avokatinë. Gjithashtu, edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut përcaktojnë mbrojtjen me avokat si themelin për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe përcaktojnë standarte të detyrueshme për tu marrë në konsideratë nga gjykatat.

Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore, që në

funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale.

Është veçanërisht me shumë rëndësi të kujtojmë se personi nën hetim apo i arrestuar apo personi ndaj të cilit zhvillohen hetime¹⁷¹, barazohet nga pozita procedurale me të pandehurin¹⁷² dhe ky barazim fillon që nga e drejta për pasur avokat. Mbrojtësi në proces nuk duhet të jetë thjesht prezencë fizike apo formale, por ai duhet të luajë rol aktiv në mbrojtjen e personit të arrestuar dhe përgatitja e tij profesionale duhet të jetë e tillë që të realizojë efektivisht detyrën e tij.

Cilësia e mbrojtjes në vetvete, nuk është vetëm një detyrim etik i avokatit, por përbën gjithashtu një garantim të të drejtave themelore të njeriut. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Kushtetuese,¹⁷³ e cila është shprehur se: *“Sipas parimeve të rëndësishme kushtetuese e procedurale dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në një proces gjyqësor avokati mbrojtës duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standartet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij. Kur avokati vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij, në mbrojtje të të drejtave të klientit, ai shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t'u mbrojtur me avokat. ...”*

Bazuar edhe në të dhënat sasiore të pasqyruara më sipër, por gjithashtu edhe nga analiza cilësore, rezulton se në rastet objekt studimi, në përgjithësi, mbrojtja me avokat në seancë gjyqësore është kryesisht “jo-efektive”, duke u minimizuar në një akt thjesht formal dhe aspak thelbësor. Kryesisht, gjykata mjaftohet vetëm me prezencën formale të avokatit, dhe e konsideron të përmbushur këtë detyrim. Të dhënat tregojnë se në këto seanca avokati, veçanërisht ai i caktuar kryesisht, pothuaj nuk paraqet prova dhe paraqitet tërësisht formalisht, gati në kushtet e një dëgjuesi ndaj procesit që po zhvillohet. Në shumicën dërrmuese të rasteve, gjykimi është kryer mbi provat e prokurorit, dhe pala nën hetim nuk ka pasur pothuajse fare zërin e saj në proces. Gjithashtu, mbrojtja pothuaj nuk argumenton mbi vlefshmërinë e provave të sjella nga organi i akuzës, madje kjo vërehet edhe në rastet kur u verifikua se ka pasur çdo mundësi ligjore për ta bërë këtë dhe për të kërkuar, si për shembull: mungesën e gjendjes së flagrancës, ose pavlefshmëri të kontrollit të banesës/ambientit tregtar, etj. Por edhe në ato pak raste kur avokatët paraqesin prova, në shumicën e rasteve ato nuk janë pranuar nga gjykata.

Në vlerësimin e ekspertëve të angazhuar në këtë studim, rezulton se ka të paktën dy arsye themelore lidhur me karakterin formal të mbrojtjes në këto procese gjyqësore. Së pari, avokatëve nuk i jepet mundësi efektivisht të njohin çështjen dhe të studiojnë dosjen, madje siç rezultoi nga monitorimi i seancave, ka pasur raste ku edhe kur avokati ka dashur të paraqesë prova, gjykata nuk ia ka pranuar me arsyetimin se çështja nuk ka kaluar në gjykim themeli po është “thjesht” duke u gjykuar masa e sigurimi. Shkaku i dytë, është përgatitja e pamjaftueshme profesionale të avokatëve, e cila shfaqet jo vetëm me mosparaqitjen e provave por edhe me rolin pasiv që ata shfaqin në proces. Nga konstatimi i këtyre dy

¹⁷¹ Sipas Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.3/2002.

¹⁷² Sipas nenit 36 i KPrP.

¹⁷³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.222, datë 04.11.2002.

arsyeve themelore nuk bëjnë përjashtim as avokatët kryesisht e as ata të zgjedhur me prokurë/deklarim në datën e seancës gjyqësore.

Në shumicën dërrmuese të rasteve të studiuara, avokatët evidentojnë një qëndrim në kundërshtim të plotë me parimet e një mbrojtje efektive. Shprehjet tipike të avokatit janë që “e lë në çmim të gjykatës”, që është “dakort me vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë”, apo duke u kufizuar vetëm në kërkime mëshiruese për llojin e masës së sigurisë. Por edhe në këto rastet e fundit, avokatët pothuaj nuk japin asnjë argumentim ligjor, se përse një masë më e butë sigurimi e kërkuar prej tij, do të ishte më e përshatshme. Me frazën tipike të avokatit “kërkojmë caktimin e një mase më të butë”, rezulton qartë që avokati edhe në kërkimin e tij është i përgjithshëm, jo konkret dhe rrjedhimisht nuk arrin të argumentojë bazën e kërimit të tij.

Akoma më keq, rezulton se ka pasur mjaft raste ku avokati jo vetëm që ka kërkuar të njëjtën masë sigurimi me prokurorin, por ka kërkuar edhe vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë, detyrë e cila i përket ekskluzivisht prokurorit.¹⁷⁴ Kjo situatë e një mbrojtjeje jo-efektive, bëhet edhe më e rëndë, po të mbajmë në konsideratë faktin që gjendja e flagrancës dhe provat e mbledhura përgjatë saj, janë momente kyçe edhe për gjykimin në themel të çështjes.

Nga monitorimi i kryer në këtë gjykatë dhe vendimeve të studiuara, mundet të thuhet se në rastet kur mbrojtësi është i zgjedhur, atëherë mbrojtja duket disi më cilësore dhe më efektive. Nga të dhënat rezulton se në 61% të këtyre rasteve, gjykata ka vendosur një masë më të lehtë nga ajo e kërkuar nga prokurori. Megjithatë, edhe këtu duhet theksuar se, edhe në rastet e përfaqësuar me avokat të zgjedhur, ka vend për mbrojtje më të mirë dhe për angazhim më profesional nga ana e mbrojtësve.

Në të dyja gjykatat e monitoruara rezulton se, avokatët, si ata të zgjedhur, e aq më pak ata të caktuar kryesisht, pothuaj kanë pasur shumë pak, për të mos thënë aspak akses në aktet e dosjes që janë paraqitur në gjykatë. Pra avokatët, nuk studiojnë dosjen paraprakisht dhe as organizojnë takime me personin nën hetim. Për avokatët e caktuar kryesisht, kjo rezulton e qartë nga vëzhgimi i momentit të caktimit të tyre në seancë dhe oraret e seancave me distancë 15 minuta nga njëra tek tjetra,¹⁷⁵ ndërsa për avokatëve të zgjedhur, duket që akti akti i përfaqësimit të tyre mban në shumicën e rasteve të njëjtën datë me atë të seances, ose janë caktuar në seancë gjyqësore me deklarim. Edhe ky është element që tregon cilësinë jo në nivelet e duhura të përgatitjes paraprake dhe përfaqësimit të mbrojtjes edhe nga avokatët e zgjedhur nga vetë pala.

Në rastet kur objekt i gjyimit ka qenë zëvendësimi i masës së sigurimit personal, vendimet kanë qënë disi më të favorshme, duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” dhënë me një vendim të mëparshëm, me masa sigurie më të butë, si psh “detyrim për

¹⁷⁴ Shih Vendimet Nr 751, 752, 753, 754, 755, 757, 758, 759, 760, 761 datë 12.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁷⁵ Kjo rezulton nga leximi i çdo vendimi.

paraqitje në policinë gjyqësore”.¹⁷⁶ Megjithatë, edhe në këto raste, duhet thënë se argumentimet e mbrojtësve ligjorë kanë qënë jo të thelluara.

Nga monitorimi i seancave gjyqësore evidentohet gjithashtu se mbrojtja nuk ka ngritur çështjen e pavlefshmërisë të provave/akteve, për shkak të mungesës së avokatit në procedurat e mbajtura nga organi i akuzës.

Një çështje tjetër problematike është mungesa e caktimit të mbrojtësve, në seancat e gjyqimit në mungesë. Nga dosjet e shqyrtuara, u gjetën 17 raste kur mungon apo nuk evidentohet prania e avokatit. Vetëm në një prej tyre i pandehuri kishte zgjedhur të mbrohej vetë, ndërsa në 16 rastet e tjera masa e sigurimit merrej në mungesë të pandehurit. Mungesa e një avokati në këto seanca, përveçse në shkelje të së drejtë për tu mbrojtur, çënon rëndë parimin e barazisë së armëve dhe debatit gjyqësor¹⁷⁷.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të gjitha vendimeve rezulton gjithashtu se avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata janë gjithmonë të njëjtët emra, përafërsisht 5-6, nga 90 avokatë që rezultojnë në listën e avokatëve kryesisht, të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitin 2015, dhe pothuaj e njëjta situatë rezulton edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në referim të rasteve konkrete, të konstatuara gjatë studimit të vendimeve nga pikëpamja cilësore vërejmë se:

Në njërin rast,¹⁷⁸ mbrojtja me anë të një avokateje të caktuar kryesisht, ka qënë tërësisht formale dhe madje në disfavor të personit nën hetim. Avokatja nuk ka arritur të sjellë në vëmendje të gjykatës se sasia e vogël e lëndës narkotike, heroinë, disponuar nga personi nën hetim, është në masën e një përdorimi vetjak dhe jo për shitje, kjo e suportuar dhe nga ekspertimi toksikologjik i personit, i cili ka rezultuar përdorues i lëndës narkotike. Në këto kushte, sipas nenit 283/1 të KP dhe Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.1/2008, bie dyshimi i arsyeshëm se personi nën hetim mund të ketë kryer veprën penale.

Në një rast tjetër,¹⁷⁹ ka të bëjë me cilësinë e mbrojtjes së të miturit, e cila rezulton të jetë tërësisht formale. Në gjithë vendimin prej 4 faqe, qëndrimi i avokatit është reflektuar në 1 fjali: “Avokatja dhe personi nën hetim kërkuar një masë sigurimi më të butë”. Në kushtet ku ndodhej i mituri si person nën hetim, avokatia ka pasur mundësi ti argumentonte gjykatës se masa e sigurimit “arrest me burg”, e caktuar fillimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe ricaktuar e rikonfirmuar me pas nga Gjykata e Tiranës, është tërësisht

¹⁷⁶ Shih psh Vendimin nr. 683/1, datë 07.04.2015

¹⁷⁷ Në një nga rastet e studiara rezulton se në seancën për caktimin e masa së sigurimit nuk ka pasur palë tjetër përveç prokurorit. Gjykata në hyrje të vendimit të saj përcakton se: “Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit që kërkoj pranimin e kërkesës, dhe si shqyrtoi dhe administroi aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se (...)”. Në vazhdim gjykata shprehet: “Bazuar në sa më lart, gjykata çmon se masa e sigurimit “Arrest në burg” është e nevojshme në funksion të sigurisë së hetimit dhe moslejimit të deformimit të procesit penal, si dhe përbën garanci për ekzekutimin e vendimit potencial, duke garantuar në këtë mënyrë interesin publik të drejtësisë.”

¹⁷⁸ Rastin i trajtuar nga Vendimi Nr. 743 Akti.

¹⁷⁹ Trajtuar nga Vendimi Nr.588 Akti.

e papërshtatshme për gjendjen, veprën penale, mënyrën e kryerjes së saj, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të vetë personit nën hetim, dhe për kushtet e nenit 228 KPrP. Sjellim në vëmendje se edhe psikologu, fjala e te cilit është reflektuar në këtë vendim, shprehet se: *“...te miturit t’i jepet një mundësi më lehtësuese për të sjellë atë në reflektim të veprimeve dhe sjelljeve të tij për t’u motivuar drejt përmirësimit vetjak dhe statusit të tij social”*.

Në disa raste të tjera, vërehet qartazi paefektshmëria e mbrojtjes nga avokatët. Në një prej vendimeve, avokati ka qënë dakort me të dyja kërkesat e prokurorit, si atë në lidhje me vleftësimin e arrestit në flagrancë ashtu edhe atë caktimit të masës “arrest në burg”.¹⁸⁰ Ndërsa në rastin tjetër, rezulton se “pasi dëgjoi mbrojtësen e të dyshuarit, e cila ishte dakort me kërkesën e parë për vleftësimin e ligjshëm të arrestit (...) gjykata vendosi të vlerësojë të paligjshëm arrestin në flagrancë të shtetasit (...) i dyshuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes”.¹⁸¹ Në një rast tjetër të studiuar,¹⁸² avokatja pa asnjë provë apo indicie nga ana e policisë, udhëzon klientin të pranojë veprën. Avokatja nuk parashtroi asnjë argument mbrojtës, ndërkohë që ekzistojnë të gjitha hapësirat ligjore për ta bërë këtë gjë, pra për të kërkuar mungesë të gjendjes së flagrances, paligjshmëri arresti dhe lirim të menjëhershëm¹⁸³.

Në një numër fare të vogël vendimesh,¹⁸⁴ personat e arrestuar kanë pasur mundësi të caktojnë mbrojtës përpara seancës gjyqësore. Kjo ju ka dhënë mundësi atyre të mbrohen, çka ka ndikuar në lehtësimin e pozitës së tyre si rezultat i caktimit të një mase sigurimi më të butë nga gjykata¹⁸⁵. Për shembull, në dy nga këto vendime,^{186 187} mbrojtja, edhe për shkak të kohës që ka pasur në dispozicion, ka mundur të paraqesë prova dhe të përgatisë argumentat ligjorë në lidhje me to dhe me revokimin e masës “arrest në burg” dhe zëvendësimin e saj me një masë më të butë.

Megjithatë, përveç se përpara gjykatës, çështja e caktimit të avokatit dhe e një mbrojtje efektive, mbetet edhe më problematike gjatë procedurave të kryera nga organi i akuzës. Në disa nga vendimet e studiara, rezulton se personi i ndaluar apo arrestuar, praktikisht ka mundësinë për të pasur avokat, vetëm kur del përpara gjykatës. Në këtë drejtim, organi i akuzës nuk zbaton detyrimet e tij ligjore, për të garantuar mbrojtjen me avokat të personit, në çdo fazë të hetimit dhe gjykimit penal. Organi akuzës nuk cakton avokat dhe as i jep mundësinë personit të arrestuar që të zgjedhë një avokat, kur në fakt ka detyrimin që ta njohë personin e arrestuar me të drejtat e tij, përfshirë të drejtën për të pasur avokat nga momenti i ndalimit. Janë vërejtur raste ku personi ka kërkuar shprehimisht avokat, madje edhe raste të tjera ku personi është shprehur “do të flas vetëm në prezencë të

¹⁸⁰ Vendimi Nr. 632 Akti

¹⁸¹ Vendimin nr. 233 datë 21.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁸² Vendimit Nr. Akti 217

¹⁸³ Për detaje referohu tek paragrafi F “Të dhëna cilësore mbi vendimet” analiza e vendimit Nr. Akti 217.

¹⁸⁴ Vendimet me Nr. Akti 590, 591, 574, 953,602, 603, 604, 605, 606

¹⁸⁵ Secili vendim është i analizuar në paragrafin F të këtij Studimi “Të dhëna cilësore mbi vendimet”.

¹⁸⁶ Vendimi Nr. Akti 84/2

¹⁸⁷ Vendimi Nr. Akti 10/1

avokatit, në një moment të dytë”,¹⁸⁸ ndërkohë policia gjyqësore ka vijuar të mbajë procesverbale dhe aktet të tjera proceduriale, pa prezencën e avokatit mbrojtës.

Në asnjë prej akteve të prokurorisë, qoftë për të mitur apo madhor, nuk rezulton të jetë mbajtur “procesverbal për caktimin e mbrojtësit”. Gjithashtu, as në vendimin e gjykatës nuk pasqyrohet asnjë historik në lidhje me caktimin e avokatit, dhe rrjedhimisht vendimmarrja rezulton të jetë e bazuar vetëm në listën e provave të sjella nga organi i akuzës, akte të cilat në shumicën e rasteve listohen në vendim nga gjykata.

Në referim të çështjeve konkrete, rezulton se në të paktën dy raste,¹⁸⁹ nuk ka asnjë evidencë shkresore që personave t’ju jetë caktuar avokat nga organi i ndjekjes penale, pavarësisht se njëri i arrestuar ishte i dehur,¹⁹⁰ dhe tjetri e ka kërkuar atë.¹⁹¹ Megjithatë këtyre personave ju janë marrë deklaramet.

Në një tjetër rast,¹⁹² trajtohet çështja e një të mituri, i cili është pyetur në prani të psikologes dhe avokatit në seancë gjyqësore, por nuk ka dokumentacion provues (procesverbal) për caktimin e detyrueshëm të tyre sipas nenit 35 të KPrP, as gjatë procedurave të policisë gjyqësore dhe as përpara prokurorisë. Në një rast tjetër po me të mitur, rezulton se avokati ka deklaruar në seancë se është dakord me masën “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”¹⁹³. Vihet re se personit të mitur nuk i është caktuar psikolog në procedurat përpara gjykatës.

7.3 Zhvillimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm (afati i parashikuar në K.Pr.P)

Në 99.5% të vendimeve të studiuara, vleftësimi i ndalimit/arrestimit dhe caktimi i masës së sigurimit personal është vendosur në të njëjtën seancë. Në 0.5% (ose në 10) të vendimeve të studiuara, procesi nuk është mbyllur brenda të njëjtës seancë. Shkak i shtyrjes në këto raste është bërë domosdoshmëria e marrjes së një prove decizive, ose mungesa e përkthyesit, kërkesa e prokurorit për t’u njohur me provat e mbrojtjes, mungesa e prezencës të të ndaluarit/të arrestuarit ose prokurorit në seancë. Në shumicën e vendimeve, kur seanca është shtyrë, nuk pasqyrohet se kur është zhvilluar seanca e radhës, ndërkohë që për pjesën tjetër, seanca rezulton të jetë zhvilluar në po të njëjtën ditë dhe vetëm në pak raste është shtyrë të nesërmen.

7.4. Barazia e armëve juridike

¹⁸⁸ Kjo është një shprehje tip e përdorur nga policia gjyqësore, për të fshehur kërkesën e qartë që personi i arrestuar bën.

¹⁸⁹ Vendimet me Nr. Akti 570 dhe 566

¹⁹⁰ I njëjti skenar është edhe në vendimin Nr. Akti 221. Shiko per detajet analizën e këtij vendimi ne Aneksin F.

¹⁹¹ Në vendimin Nr. 224 Akti, personi ka refuzuar të përgjigjet pa avokat, por kjo nuk ka penguar organin të vijojë procedurat. E njëjta situatë është edhe në vendimet Nr. Akti 752 dhe 757.

¹⁹² Vendimi Nr. Akti 970

¹⁹³ Vendimin Nr. Akti 5

“Barazia e armëve juridike” është parimi sipas të cilit, çdokush që është palë në një proces duhet të ketë mundësi të barabarta me palën tjetër, që të paraqesë çështjen e tij, të dëgjohet e të mbrohet, duke ekzistuar kështu një ekuilibër i drejtë mes palëve në një gjykim. Është detyrë e gjykatës që të krijojë mundësinë që palët përgjatë procesit gjyqësor të kenë mundësi, “armë” të barabarta mbrojtje dhe të mos vendosen në pozita të disavantazuara.

Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në procesin penal, përfshi gjykimin e masave të sigurimit, kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit dhe palët në raport me njëra tjetrën. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, dhe për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Në aspektin formal, parimi i barazisë së armëve vërejmë se është zbatuar nga analiza e vendimeve të studiuara. Me “anë formale” kuptojmë që përballë akuzës ndodhet mbrojtja e personit nën hetim (i mbrojtur gjatë gjyimit për caktimin e masës së sigurimit nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose familjarëve të tij, ose nga një mbrojtës i caktuar nga ana e gjykatës). Në aspektin substancial, vërehet se kryesisht, parimi i barazisë së armëve nuk respektohet. Kjo pasi ky parim është i lidhur në proporcion të drejtë me mbrojtjen efektive. Faktor tjetër që ndikon dobëson anën substanciale të tij është se në çështjet e caktimit të masave të sigurimit, personit nuk i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen. Pra, avokati ndodhet në seancë thjesht formalisht, pa lexuar, madje pas parë kurrë asnjë akt procedural të rastit në fjalë.

Sikurse është përmendur më herët, vendimet e studiuara tregojnë të njëjtin historik të ngjarjeve me prokurorinë, dhe iu referohen në shumicë dërmuese, vetëm provave të paraqitura nga organi i akuzës. Edhe në ato pak raste kur mbrojtja ka paraqitur prova, apo ka dhënë shpjegime për ngjarjen përpara gjykatës, këto as nuk reflektohen në vendimin e gjykatës.

Shkelja e parë e “parimit të barazisë së armëve”, fillon aty ku krijohet dosja hetimore, sa kohë që aktet e policisë dhe organit të akuzës krijohen pa praninë e avokatit, edhe atëherë kur prania e tij është detyrim ligjor. Kjo situatë evidenton arbitraritet nga prokuroria dhe policia gjyqësore. Nga ana tjetër, gjykatat kanë mundësi të korrigjojnë shkeljet e konstatuara por ato nuk evidentojnë as pasojat juridike të këtyre shkeljeve, që do të thotë pavlefshmëritë apo papërdorshmëritë e akteve përkatëse, çka do të sillte mungesën e kufizimit të lirisë së personit.

Nga ky studim rezulton gjithashtu se gjykatat nuk kanë krijuar kushtet e duhura për një respektim real të parimit të barazisë së armëve. Bazuar edhe në monitorimet e seancave, nuk rezulton se mbrojtësit, t’i jetë vënë në dispozicion dosja dhe aktet e prokurorit më parë në kohë, sesa koha e seancës. Në këtë drejtim, nuk ka kontribuar as vetë mbrojtësi i cili nuk ka ngritur pretendime, që të kërkojë kohë për tu njohur me dosjen, më qëllim që të realizojë mbrojtjen efektive, apo të ngrejë në gjykim çështje pavlefshmërie ose papërdorshmërie të provave. Sikurse është evidentuar më herët, avokati deklaroi në seancë

se “është dakort me kërkesat e prokurorit”, duke ja “dorëzuar” në këtë mënyrë tërësisht “armët juridike” prokurorit.

Edhe pse nga ky studim nuk rezultojnë të jenë të shpeshta rastet e hapura ku trupi gjykues të ketë avantazhuar njërin prej palëve, apo të ketë patur raste evidente të një kompromisi të dukshëm që mund të ketë dëmtuar cilësinë e dhënies së drejtësisë apo interesat e viktimës ose të pandehurit, përsëri ka indicje që këto raste nuk është se kanë munguar. Si shembull ilustrues mund të përmendim një prej rasteve që ka të bëjë me rilidhjen e paligjshme të energjisë elektrike, ku i akuzuar kryen detyrën “oficer policie”. Në këtë rast, në ndryshim nga rastet e tjera ku shtetas pa pozicione të tilla janë akuzuar për të njëjtën vepër, prokurori kishte kërkuar masën “detyrim paraqitje”, ndërsa gjykata shprehet se nuk ekziston fare nevoja për marrjen e masave shtrënguese. Por ndërkohë nga rrethanat e faktit, të përfshira në vërejtjet e gjykatës rezulton se: “Në datë 14.01.2015, rreth orës 22:30, shërbimet e policisë së Komisarariatit nr.5 Tiranë në bashkëpunim me punonjësit e OSHEE-së në vendin e quajtur lagjia nr.5 Bathore ..Tiranë, kanë konstatuar një lidhje të paligjshme të energjisë prej tre muajsh në banesën e shtetasit me detyrë “oficer policie” (...).”

7.5 Respektimi i kushteve për caktimin e masave të sigurimit personal

Neni 228 i Kodit të Procedurës Penale parashikon kushtet që duhet të ekzistojnë për caktimin e masave të sigurimit personal nga gjykata. Ekspertët e KShH-së kanë analizuar respektimin e disa prej këtyre kushteve, në vendimet gjyqësore që kanë qenë objekt studimi i këtij raporti. Më konkretisht:

a) Dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova

Sipas nenit 228, paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale, askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Provat duhet të jenë të tilla që pas çmuarjes nga ana e gjykatës, të gërshetuara me njëra tjetrën, të krijojnë dyshimin që personi mund të ketë kryer veprën penale.

Ky kriter, nënkupton që provat duhet të jenë të ligjshme dhe pikërisht këtë aspekt, gjykata duhet ta verifikojë, bazuar kjo edhe në parashikimin e Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit provat e marra gjatë shqyrtimit të masës së sigurisë, konsiderohen si të marra në proces. Provat e hetimeve paraprake duhet t’i nënshtrohen hetimit gjyqësor gjatë caktimit të masës së sigurimit, si për pavarshmëri, papërdorshmëri, apo aspekte të tjera ligjshmërie. Siç është sqaruar edhe më sipër, Gjykata (përgjithësisht) dhe avokatët (pothuaj në të gjitha vendimet e studiuar në këtë raport), kanë dështuar në evidentimin dhe bërjen pjesë të debatit gjyqësor të këtyre çështjeve.

Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, “*Legjislacioni ynë procedural penal, doktrina si dhe jurisprudenca gjyqësore e kanë trajtuar gjerësisht mënyrën e marrjes së provave si një aspekt i rëndësishëm i procesit. Marrja e provave, sipas Kodit të Procedurës Penale, merr një kuptim të ri bazuar në sistemin akuzator, duke ndryshuar metodën e të proceduarit në lidhje me marrjen e provave në shqyrtimin gjyqësor, duke hequr dorë përfundimisht nga të*

gjitha ato norma të cilat sanksiononin pabarazinë e palëve në procesin penal në disfavor të individit dhe të të drejtave të tij. Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor. Dispozitat e këtij kodi kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e procedimit penal në të gjitha fazat e tij. Prandaj, mosrespektimi i dispozitave ligjore të vendosura për aktet e procedimit shërben njëkohësisht dhe si shkak pavlefshmërie që ndikon drejtërdrejt mbi ecurinë e procesit gjyqësor”.

Studimi sasior i vendimeve gjyqësore evidenton se, në 58.2% (1009) të rasteve, prokurori mbështetet kërkesën për vleftësimin e ndalimit/arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit, në provat e marra po nga prokuroria, ndërsa në 40.7% (704) të rasteve, kjo kërkesë bazohet edhe në provat e marra si rezultat i hetimit dhe përpunimit të akteve të policisë. Në 0.7% (12) të rasteve, prokurori e mbështet kërkesën e tij në prova të tjera si: akt ekspertimi (2 raste); dokumentacion i ardhur nga institucionet e huaja (7 raste) dhe dëshmi të dëshmitarëve apo deklarime nga persona që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit ose vetë i arrestuari (3 raste). Në vetëm 0,2% (3) të rasteve, kjo e dhënë nuk del nga monitorimi.

Në konstatimet rast pas rasti është evidentuar, se gjykata nuk thellohet në analizën e provave të sjella nga prokurori, por i referon ato si me vlerë të plotë provuese. Gjykata duhet të mbajë parasysh, që në pjesën më të madhe të rasteve, provat janë të tilla që gjenerohen/përpilohen vetëm nga njëra palë, e cila në këtë rast është “shteti”, kështu që ekziston mundësia për t’i keqpërdorur ato. Është detyrë e gjykatës që t’i çertifikojë provat, sidomos në kushtet kur në pjesën dërmuese të rasteve, janë të vetmet prova mbi të cilat zhvillohet gjykimi. Pala tjetër, personi nën hetim, qoftë për mungesë efektive të mundësive, apo dhe për shkak të mbrojtjes së dobët, kryesisht rezulton se nuk paraqet prova.

Kriteri kryesor i përcaktuar nga KPrP lidhur me provat, është pikërisht “ligjshmëria” e tyre. Ky kriter lidhet me mënyrën se si është marrë/siguruar prova nga pala. Prova, nuk është e ligjshme nëse nuk është marrë në formën e kërkuar nga ligji dhe pasoja direkte e paligjshmërisë është papërdorshmëria e saj në gjykim.

Është konstatuar se rasti tipik i provave të marra në mënyrë të paligjshme, është ai i “kontrollit të banesës”. KPrP ka përcaktuar qartë se cilat janë kushtet dhe procedurat e kryerjes së kontrollit në banesë. Ekzistojnë disa raste të evidentuara, ku ka rezultuar se ka ndodhur kontrolli i banesës së personit nën hetim pa një mandat gjykate, jashtë kushteve të flagrances, dhe në shkelje të plotë të rregullave.

Në një rast tjetër, personi është kapur në flagrancë duke shpërndarë lëndë të dyshuara si narkotike, poshtë shtëpisë së tij. Menjëherë pas këtij konstatimi, policia gjyqësore ka ushtruar kontrollin personal (të cilin e gjykojmë të rregullt dhe të ligjshëm) dhe me pas është ngjitur në banesë, për të ushtruar kontrollin e saj. Nga ky kontroll është gjetur sasi tjetër lëndë e dyshuar si narkotike, e cila është marrë dhe vleftësuar nga gjykata në cilësinë e proves, dhe për këtë shkak e mbi bazën e kësaj prove, është arrestuar edhe vëllai i personit nën hetim, i cili ndodhej në banesë. Nenin 206 të KPrP mbi kontrollin e banesës, përcakton se “Kontrolli në një banesë ose në një vend të mbyllur ngjitur me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të ngutshme organi proçedues mund të

urdhërojë me shkrim që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve.” Në rastin e ilustruar më herët në këtë paragraf, kontrolli i banesës është kryer pa asnjë urdhër të prokurorisë dhe në tejkalim edhe të afatit të lejuar për këtë kontroll.

Veçanërisht, në vendimet ndaj shtetasve të dyshuar se kanë kryer veprat penale të “Vjedhjes” dhe “Dhunës në familje”, qëndrimi i gjykatave, ka qenë i orientuar në pranimin e kërkesave të prokurorit. Në disa prej këtyre rasteve, gjykata ka vleftësuar si të ligjshëm arrestet në flagrancë për këto vepra (edhe pas 13 ose 20 ditësh), kur vërehet se nuk ka ekzistuar gjendja e flagrancës.

Shembull ilustrues nr. 1 - Në një nga vendimet, ndaj personit është caktuar masë sigurimi për shkak të një kallëzimi për vjedhjen e një telefoni. Personi i dëmtuar dyshonte se telefoni mund t’i ishte vjedhur nga personi nën hetim, por këto dyshime nuk bazohen mbi asnjë provë, e tillë që të krijojë dyshimin e arsyeshëm se vepra penale mund të jetë kryer nga personi nën hetim. Psh dyshimi mund të ishte i përligjur nëse personit nën hetim do t’i ishte gjetur në cilësinë e provës, telefoni i vjedhur. Kështu do të përmbushej njëkohësisht edhe kriteri për “gjendjen e flagrancës” dhe i “provave që krijojnë dyshimin e arsyeshëm”. Por kjo nuk ka ndodhur. Vetëm kështu do të krijohej dyshimi i arsyeshëm te gjykata, se personi nën hetim mund të ketë kryer veprën penale të vjedhjes.

Shembull ilustrues nr.2 – Në një nga vendimet, rezulton se arrestimi është kryer mbi bazën e kallëzimit të personit të dëmtuar (bashkëshortja e personit nën hetim). Sipas deklarimeve të kallëzueses, vepra penale është kryer në datë 20.03.2015, kallëzimi është kryer në datë 21.03.2015 dhe personi nën hetim është arrestuar në datë 22.03.2015. Vetë gjykata duket se ka dhënë këtë vendim “me rezervë”, pasi në fund të arsyetimit të saj, shprehet se: *“Gjykata vlerëson faktin që nuk kishte asnjë provë për të vërtetuar thëniet e kallëzueses që ndodhen në fashikullin penal si dhe pohimet e personit nën hetim për veprën penale të kryer”*. Pra gjykata pranon vetë se nuk ka prova dhe rrjedhimisht s’mund të ketë as dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova. Gjithsesi, cakton masë sigurimi “arrest në shtëpi”.

Nga ky studim rezultoi gjithashtu se në mjaft raste, veprimet e policisë janë të parregullta, ndërkohë që gjykata nuk e verifikon ligjshmërinë e tyre por i konsideron provat e siguruara prej tyre si të rregullta. Në disa prej vendimeve, vërehet se kallëzimi ndaj një personi ka çuar në arrestimin në flagrancë të shtetasve nga policia, ndërkohë që nuk ka patur prova që krijojnë dyshimin e arsyeshëm për të mundësuar këtë. Vlen të theksohet gjithashtu se një nga provat më të shpeshta të sjella nga policia gjyqësore në proceset e analizuara, është “proçesverbali i pyetjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet”. Edhe pse kjo nuk përbën provë në vetvete, siç thekson edhe Vendimi i GjK, pyetja është kryer pa praninë e avokatit, në kundërshtim me parashikimet e KPrP. Megjithatë, kjo shkelje nuk ka përbërë temë diskutimi as për avokatët dhe nuk i është nënshtruar verifikimeve nga vetë gjykata, përgjatë seancave të vleftësimit të arrestit/ndalimit apo caktimit të masave të sigurimit.

Po ashtu, ka raste që veprimet e prokurorisë rezultojnë të jenë jashtë afateve kushtetuese, referuar nenit 28 të Kushtetutës. Për shembull, në një nga vendimet e studiuara rezulton se arrestimi në flagrancë rin rast, ka ndodhur në datë 31.01.2015, dhe personi ka dalë përpara gjykatës tre ditë më pas, në datë 03.04.2015.

b) “Rreziku i ikjes” apo “Kryerja e një vepër tjetër penale”

Si pjesë e kushteve të caktimit të masave të sigurimit personal, është ekzistenca e të paktën një prej rrethanave të parashikuara në nenin 228, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht:

- (i) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;
- (ii) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;
- (iii) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Një dukuri që evidentohet gjatë leximit të vendimeve gjyqësore, është arsyetimi standart që bëhet nga një pjesë e madhe e gjyqtarëve, mbi “rrezikun e ikjes” apo të “kryerjes së një veprë tjetër penale”, të parashikuara në gërmat b) dhe c) të kësaj dispozite. Ka patur raste kur gjykata arsyeton në vendimin e saj këto rrethana, por ndodh që ato janë të pabazuara ose kanë natyrë paragjyqëse sikurse do ta ilustrojmë në shembullin në vijim:

Shembull ilustrues nr.1 – Në një nga vendimet, gjykata, për veprën penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt” është shprehur se: *“Gjykata krijon bindjen se personi nën hetim ka rrezik ikje me qëllim që t’i shmanget procedimit penal në ngarkim të tij dhe mundësisë së dënimit. Një tregues tjetër i rrezikut të ikjes është edhe fakti se gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, personi i arrestuar në flagrancë, D.M, ka deklaruar se ai ka jetuar jashtë, fakt ky i cili e përforcon më tepër rrezikun e ikjes.”* Ky fakt, në të vërtetë nuk është tregues i bindës i mundësisë së tij për tu larguar dhe as qëllimit të tij për t’iu shmangur hetimeve. Pra, mundësia e personit nën hetim për tu larguar, duhet domosdoshmërisht të lidhet me qëllimin e tij për t’iu shmangur hetimeve dhe gjykata duhet ta evidentojë këtë, duke mos e paragjykuar personin nën hetim.

Lidhur me rrezikun e ikjes, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim unifikues, duke u shprehur se “rreziku i largimit”, krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkallë e pasojave të ardhura prej saj. Por këto elementë duhet të veprojnë në kompleksitet e të lidhur me njëri tjetrin. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyet për ta izoluar të pandehurin. Po ashtu, duhet të shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (*post delictum*), personaliteti dhe pozita e tij etj. **Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja “b” nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit.**

Shembull ilustrues nr.2 - Në një çështje tjetër, gjykata, në caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ka përdorur argumenta të tilla si: “rëndësinë e faktit, veprimet e

kundraligjshme, shkallën e nevojës së sigurimit, konkretisht shmangien e rrezikut të kryerjes së veprave të tjera penale, sanksionin që parashikohet, rëndësinë e marrëdhënieve juridike që cënohen”. Në fakt, përmendja e këtyre këtyre shkaqeve përbën një citim të ligjit, por pa e bazuar atë në fakte dhe prova konkrete që krijojnë bindjen tek gjykata, për caktimin e masës “arrest në burg”.

Shembull ilustrues nr.3 - Në një rast tjetër, Gjykata nuk i referohet asnjë prej kushteve ligjore të parashikuar në nenin 228/3 të KPrP. Në këtë vendim arsyetohet se: “Gjykata çmon se ndaj të dyshuarës (...) duhet të caktohet si masë sigurimi personal ajo e “arrestit në burg” me afat 45 ditë, bazuar në nenin 238 e 245/ç të K.Pr.Penale. Kjo masë duhet të jepet me afat, me qëllim që të krijohet kuadri i plotë në lidhje me fajësinë e saj duke u bërë e mundur verifikimi i pretendimeve të ngritura prej saj, se nuk ka kryer asnjë veprim ndaj policisë, por është kjo e fundit po sipas saj që e ka dhunuar”

Shembull ilustrues nr.4 - Në një tjetër vendim, gjykata, në caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ka reflektuar në këtë vendim se, “rrethanat e ngjarjes tregojnë për një rrezikshmëri të lartë të personit”.. Por ekzistenca e këtij kushti nuk është argumentuar konkretisht nga gjykata, si dhe nuk janë dhënë si referencë faktet konkrete dhe provat që e mbështesin atë.

Shembull ilustrues nr.5 – Në një prej vendimeve, gjykata në arsyetim është shprehur se “çmon se ekziston rreziku që personi nën hetim, t’i shmanget hetimit për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqet vepra penale që i atribuohet.....gjykata çmon se ekziston rreziku potencial që ai mund të kryejë vepra të tjera po kaq të rënda apo edhe më të rënda.....gjykata konstaton se në kushtet e përhapjes së kësaj veprë, por edhe shtimit të intensitetit të luftes ndaj saj, lidhja e energjisë në mënyrë të paligjshme, referon për rrethanë rënduese...” Arsyetimi i përdorur nga gjykata në këtë vendim mbi “përhapjen e veprës penale” dhe “luftën që institucionet shtetërore bëjnë ndaj saj” nuk është i drejtë si dhe nuk vërtetohet (provohet) ekzistenca e kushteve konkrete për dhënien e masës ndaj personit në hetim, konform kërkesave të Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër, Gjykata duhet të jetë objektive dhe e pandikuar nga politikat e ekzekutivit.

Gjyqtarët magjistratë në vitin e parë të praktikës priren të argumentojnë më gjatë, por përsëri pa arritur të thellohen se si aplikohen kushtet e nenit 228/3 të Kodit të Procedurës Penale në rastin konkret. Edhe në këto vendime ka tendenca të dukshme për të miratuar masën e kërkuar nga prokurori. Shembull ilustrues nr.6 – Në një nga këto vendime, gjyqtari (magjistrat) i cili cakton masën e sigurisë “arrest në burg” për personin arsyeton se: “Në këto kushte, duke pasur parasysh se vepra penale..... dënohet me gjobë ose me burgim deri në 7 vjet, gjykata krijon bindjen se personi në hetim ka rrezik ikje me qëllim që ti shmanget procedimit penal në ngarkim të tij dhe mundësisë së dënimit”. Pra, edhe në këtë rast, gjykata nuk bën analizë të rrezikut për ikje të personit konkret, por e thjeshton/barazon këtë koncept me “masën e dënimit” duke evidentuar se “mqë ekziston rreziku i dënimit, ekziston rreziku i ikjes për tu shmangur nga ky dënim”.

7.6 Respektimi i kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal

a) Kriteri i përshtatshmërisë së masës në raport me shkallën e nevojave të sigurimit

Neni 229, paragrafi 1, i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se “Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret”.

Në përgjithësi, nga vendimet e studiuara vërehet se, gjykatat nuk argumentojnë në vendimet e tyre përshtatshmërinë e secilës masë, me shkallën e nevojave të sigurimit ndaj personit. Tregues i këtij fakti është se pavarësisht se KPrP parashikon 9 lloje të ndryshme masash sigurimi personal (7 shtërnguese dhe 2 ndaluese), gjykatat, në shumicën dërrmuese të çështjeve japin vetëm një të një nga 3 masat e sigurimit “arrest në burg”, “arrest në shtëpi”, dhe “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”. Në vendimet e studiuara, vërehet se gjykata anashkalon arsyetimin se përse një masë sigurimi më e butë do të ishte e papërshtatshme (apo joefektishme) në rastin konkret.

Siç kemi parashtruar në seksionin e mësipërm, caktimi i masës “arrest në burg” është i lidhur me garantimin e interesit publik për ushtrimin e ndjekjes penale. Kjo e fundit, duhet të ushtrohet në mënyrë proporcionale, dhe sipas një procesi të rregullt ligjor, që respekton parimet dhe të drejtat themelore të njeriut, sic janë parimi i prezumimi i pafajësisë, dhe e drejta e lirisë së personit.

Shembull ilustrues nr.1 - Në një rast,¹⁹⁴ gjykata ka dhënë masën e sigurimit “arrest në burg”, masë e cila duket e papërshtatshme në krahasim me nevojat e sigurimit. Për të garantuar sigurimin personal të personit nën hetim, gjykata mund të urdhëronte “arrest në shtëpi”, ose “ndalimin për të qëndruar në një vend apo pranë një personi të caktuar”.

Shembull ilustrues nr.2 – Ekspertët kanë analizuar mënyrën se si gjykata ka vlerësuar nevojat e sigurimit, në katër vendime, me elementë të ngjashëm sa i takon subjekteve dhe veprës penale¹⁹⁵. Në njërin vendim,¹⁹⁶ bëhet fjalë për veprën penale “Vjedhje” e mbetur në tentativë dhe e kryer në bashkëpunim, nga një person i mitur. Në tre vendimet e tjera,¹⁹⁷ bëhet fjalë për veprën penale “Vjedhje” e kryer në bashkëpunim, nga persona të mitur. Në tre vendimet e fundit, gjykata ka vendosur “detyrim paraqitje ne policinë gjyqësore” të të miturve, ndërkohë që në vendimin e parë është vendosur masa “arrest në burg”. Elementi i përshtatshmërisë së shkallës së nevojave të sigurimit nuk është vlerësuar si duhet, po të marrim në konsideratë se për një nga të miturit, është caktuar masa ekstreme e sigurimit për të njëjtën veprë penale të mbetur në tentativë.

Po të marrim parasysh rastet e të miturve që dënohen me burg, shumë prej tyre dënohen sërish nga gjykata duke u kualifikuar si recidivistë. Nga 16 raste të miturish të shqyrtuara në dosjet e studiuara rezulton se 3 janë kthyer tashmë përsëritës. Nga 13 rastet e atyre që

¹⁹⁴ Vendimin Nr. Akti 991

¹⁹⁵ Vendimi Nr.31 Akti, datë 07.01.2015; dhe Vendimet Nr. Akti 32, 33, 34

¹⁹⁶ Vendimi Nr. Akti 31

¹⁹⁷ Vendimet Nr. 32, 33, 34 Akti

ishin të padënuar më parë, në 7 raste gjykata vendos masën “arrest në burg”. Kjo situatë, të bën të reflektosh nëse: Mos vallë vendosja në burg e mbi gjysmës së të miturve që kryejnë krime për herë të parë, i shtyn ata edhe më shumë drejt rrugës së krimit?

b) Kriteri i raportit me rëndësinë e faktit dhe sanksionin e veprës penale konkrete

Neni 229, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se “Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

- Rëndësia e faktit

Në vendimet e studiuara, ekspertët kanë analizuar raste kur gjykata nuk merr efektivisht në vlerësim të drejtë proporcionalitetin që duhet të ekzistojë midis rëndësisë së faktit në çështjen konkrete dhe masës së sigurimit ndaj personit.

Ekspertët kanë vërejtur edhe raste tipike ku masa e sigurimit e caktuar nuk përputhet aspak me rëndësinë e faktit, madje mospërputhja është e hapur.

Shembull ilustrues nr.1 - Në një rast,¹⁹⁸ gjykata ka caktuar masën e “arrestit në burg” për një aksident rrugor me pasoja vetëm materiale, për të cilën personi paraqitet vetë në komisarjat është caktuar arrest në burg.

Shembull ilustrues nr.2 - Në një rast tjetër, gjykata ka caktuar masën e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për fakte të atribuara në lidhje me veprën penale të “Vrasjes” e mbetur në tentativë dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit” të parashikuara nga nenet 76, 22 dhe 278/5 të K.P.¹⁹⁹ Megjithatë, këtu duhet theksuar se është organi i akuzës që ka kërkuar këtë masë sigurimi.

Shembull ilustrues nr.3 - Vlen të përmendim edhe disa raste konkrete në lidhje moskonsistencën e gjykatës në dhënien e masave të sigurimit²⁰⁰. Konkretisht, rezulton se pavarësisht rëndësisë së njëjtë të fakteve dhe dënueshmërisë, e njëjta gjykatë, për të njëjtën vepër penale, brenda të njëjtës ditë, ka dhënë në 3 raste masën e sigurimit “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”,²⁰¹ ndërsa në rastin e katërt ka dhënë “arrest në burg”.²⁰² Nga shqyrtimi i këtyre vendimeve rezulton jo vetëm që rrethanat e faktit ishin pothuaj identike, por gjithashtu, në vendimin ku është dhënë masa e sigurimit “arrest në burg”, vihen re konstatime dhe arsyetime tërësisht kontradiktore të gjykatës, mbi “rezikun e largimit”.

¹⁹⁸ Vendimi nr. 591 datë 28.08.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

¹⁹⁹ Vendimi nr. 469 datë 11.07.2015

²⁰⁰ Vendimi Nr. Akti 238, 239, 240 dhe Nr. 241 Akti

²⁰¹ Vendimi Nr. Akti 238, 239, 240

²⁰² Vendimi Nr. 241 Akti

Shembull ilustrues nr.4 - Në një nga çështjet, rezulton se sendet e vjedhura janë një xhup dhe një bluzë të marra nga një dyqan që shet mallra me çmime relativisht të lira, të përballueshme edhe nga shtresat e popullsisë në nivelin mesatar ekonomik. Vepra nuk është kryer në kushte apo rrethanë rënduese, ndërkohë që gjykata ka caktuar masën më të rëndë të sigurimit, “arrest në burg”. Gjykata argumenton se kjo vepër është e përhapur, dhe këtë nuk e bën mbi ndonjë statistikë zyrtare, dhe anashkalon kriterin e rëndësisë së faktit në rastin konkret.

Shembull ilustrues nr.5 - Në një tjetër vendim, rezulton se personi nën hetim ka vjedhur 10 pako kafe. Gjykata cakton masën “arrest në burg” dhe nuk merr aspak në konsideratë rëndësinë e faktit.

Shembull ilustrues nr.6 - Vihet re se për të njëjtën vepër penale “Drejtimi automjeti në mënyrë të parregullt” dhe veçanërisht pothuaj për të njëjtat fakte/rrethana, gjykata është kontradiktore në qëndrimin e saj, duke zbatuar dy lloje të ndryshme masash sigurimi, në njërin rast “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” dhe në rastin tjetër “arrest në burg”. Sidomos, në rastin e caktimit të “arrestit në burg”, nuk argumentohet aspak se përse asnjë masë tjetër nuk do të ishte e përshtatshme. Në mënyrë të ngjashme, në 4 raste të tjera të analizuara nga ekspertët që i përkasin çështjeve ndaj të miturve të dyshuar për veprën penale të “Vjedhjes”, rezultojnë dy praktika gjyqësore të ndryshme dhe jo konsekuente. Në dy vendime, gjykata cakton masën ekstreme “arrest në burg” për të miturit, dhe për dy të tjera masën më të butë “detyrim paraqitje”. Sjellim në vëmendje se, në të katër këto vendime, rëndësia e faktit paraqet elementë të ngjashëm dhe bëhet fjalë për vjedhje biçiklete, pulovre, çokollatash.

Shembull ilustrues nr.7 - Në dy vendimet të tjera, për personat nën hetim të dyshuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, gjykata ka caktuar dy lloje masash sigurimi, “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” dhe “arrest në burg”. Gjykata ka caktuar masën “arrest në burg” me arsyetimin se “ekziston rreziku potencial që personi të vazhdojë të kryejë të njëjtën vepër, aq më tepër kur në seancën e vleftësimit të masës, nuk shpreh asnjë pendesë për faktin e ndodhur por e mohon faktin”. Në fakt, pranimi i fajësisë për faktin nuk është kriter për caktimin e llojit të masës dhe ky argumentim i gjykatës cenon parimin e prezumimit të pafajësisë.

- Sanksioni i veprës penale

Të dhënat e përftuara nga studimi i vendimeve gjyqësore, evidentojnë se në 2015-ën, një vit pas ndryshimeve në Kodin Penal, ka rritje të numrit të ndalimeve/ arrestimeve, për personat e dyshuar për vepra me rrezikshmëri jo të lartë shoqërore, të parashikuara në nenin 137 të Kodit Penal “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” dhe nenin 291 “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (vepra të kriminalizuara ose të ashpërsuara në masën e dënimit me ndryshimet që pësoi Kodi Penal në vitin 2014). Gjithashtu, arresti në burg aplikohet në masë të konsiderueshme edhe për “Dhunën në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për veprat penale për vjedhjen e pasurisë, të parashikuara nga nenet 134, 135, 136, 137 të Kodit Penal, si dhe për veprat

penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuara nga neni 283 dhe neni 283/a i Kodit Penal.

Në aspektin sasior, monitorimi i kampionit të vendimeve gjyqësore nga vëzhguesit e KShH-së, për vleftësimin e arrestimit/ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit evidenton se të tilla procedura kërkohen kryesisht për këto vepra penale:

- Në 238 raste “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (neni 291 KP); 8 raste “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” (neni 290 KP); 8 raste “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi” (neni 290/2 KP);
- 135 raste “Vjedhja e kryer në bashkëpunim ose më shumë se një herë” (neni 134/2 KP); (neni 137/2 KP); 106 raste “Vjedhja” (neni 134/1 KP) dhe 6 raste “Vjedhja e kryer në bashkëpunim” (neni 134 KP + neni 25 KP); 12 raste “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën” (neni 135 KP); 8 raste “Vjedhja me dhunë” (neni 139 KP); 12 raste “Vjedhja me dhunë e kryer në bashkëpunim” (neni 139 KP & neni 25 KP); 6 raste “Vjedhja me armë” (neni 140 KP);
- 128 raste “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” (neni 137/1 KP); 33 raste “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike e kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë ose nga përdoruesit jofamiljarë të energjisë elektrike ose të rrjetit të shërbimit telefonik”
- 99 raste “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” (neni 283/1 KP); 66 raste “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve e kryer në bashkëpunim ose më shumë se një herë” (neni 283/2 KP); 4 raste “Trafikimi i narkotikëve kryer në bashkëpunim ose më shumë se një herë” (neni 283/a/2 KP); 3 raste “Kultivimi i bimëve narkotike” (neni 284 KP);
- 24 raste “Dhuna në familje e kryer në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve” (neni 130/a/4 KP); 21 raste “Dhuna në familje” (neni 130/a KP); 6 raste “Dhuna në familje kur sjell si pasojë plagosjen e kryer me dashje, ndaj familjarit duke shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë” (neni 130/a/3 KP);
- 14 raste “Plagosja e rëndë me dashje” (neni 88/1 KP) dhe 1 rast “Plagosja e rëndë me dashje e kryer në bashkëpunim” (neni 88/1 KP + neni 25 KP); 5 raste “Plagosja e rëndë me dashje” (neni 88 KP); 4 raste “Plagosja e rëndë me dashje kur është kryer kundër disa personave apo kundër familjarëve/të afërmëve ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen” (neni 88/2 KP); 7 raste “Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj familjarit/të afërmit me pasojë cënimin e integritetit psikik të tij” (neni 130/a/2 KP); 2 raste “Plagosja e lehtë me dashje e kryer në bashkëpunim” (neni 89 KP + neni 25 KP);
- 13 raste “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” (neni 189/1 KP) dhe 3 raste “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave i kryer në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasojë të rënda” (neni 189/2 KP); 6 raste “Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara” (neni 186/1 KP); 6 raste “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve kryer në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo kur ka sjellë pasojë të rënda” (neni 190/2 KP); 3 raste “Falsifikimi ose fshirja, zhvendosja ose ndryshimi i paligjshëm i shenjave mbi armët dhe municionet luftarake” (neni 278/3 KP);

- 11 raste “Goditjet për shkak të detyrës” (neni 237 KP); 10 raste “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik kur kryhet në bashkëpunim, ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë” (neni 236/2 KP); 1 rast “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik” (neni 242 KP).
- 9 raste “Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore” (neni 278/5 KP); 6 raste “Mbajtja, blerja apo shitja e armëve të ftohta në automjete apo mjedise të hapura për publikun” (neni 279/2 KP); 4 raste “Prodhimi, shitja, blerja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, tregtimi dhe transportimi pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” (neni 278/2 KP) dhe 4 raste “Mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa leje” (neni 278/6 KP);
- 13 raste “Shpërdorimi i detyrës” (neni 248 KP); 6 raste “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” (neni 245/1 KP); 4 raste “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” (neni 244 KP);
- 12 raste “Mashtrimi i kryer në bashkëpunim në dëm të disa personave ose më shumë se një herë” (neni 143/2 KP) dhe 3 raste “Mashtrimi” (neni 143/1 KP); 3 raste “Mashtrimi kompjuterik kryer në bashkëpunim, në dëm të disa personave, më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda material” (neni 143/b/2 KP);
- 10 raste “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale” (neni 287/b KP);
- 5 raste “Shkatërrimi i pronës” (neni 150 KP); 3 raste “Shkatërrimi i pronës me zjarr” (neni 151 KP);
- 7 raste “Tortura me pasoja të rënda” (neni 87 KP);
- 12 raste “Moskallëzimi i krimit” (neni 300 KP);
- 4 raste “Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit” (neni 113/2 KP);
- 4 raste “Përndjekja” (neni 121/a KP);
- 4 raste “Përkrahja e autorit të krimit” (neni 302 KP);
- 3 raste “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë e kryer në bashkëpunim” (neni 289 KP & neni 25 KP);
- 3 raste “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” (neni 323 KP);
- për 652 raste të tjera, veprat penale janë të paspecifikuara nga vëzhguesit, çka e pamundëson pasqyrimin e të dhënave statistikore.

Sikurse vërehet edhe më sipër, ka patur një numër të konsiderueshëm shtetasish që janë ndaluar/arrestuar në flagrancë si të dyshuar për veprat penale të vjedhjes. Por ndaj një pjesë e këtyre shtetasve janë aplikuar masa të përkufizuara të sigurimit personal, ndërkohë që vlerave e sendeve të dyshuara si të vjedhura ka qenë e vogël. Për ta ilustruar, ekspertët eidentojë të paktën 6 raste të studiuara, ku vjedhja në këto vendime konsiston në shuma apo sende me vlerë të ulët, si psh: 2300 Lekë, 500 Lekë, telefona të thjeshtë, çokollata, pako kafeje, etj.

Në disa raste janë evidentuar qëndrime të ndryshme dhe jo konsistente të gjykatave në lidhje me masat e sigurimit që janë caktuar, në raport me sanksionin e veprës penale. Kështu, për vepra për të cilat Kodi Penal parashikon masa dënimi të larta, si psh. neni 283/1, gjykata në disa raste cakton “arrest në burg”, ndërsa në raste të tjera cakton “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” edhe pse faktet e atribuara kanë për objekt nenin 283/2 të KP që parashikon një dënim më të lartë. Mgjith, duhet theksuar fakti që masat e

sigurimit kanë një karakter personal dhe mund të ndodhë që për të njëjtën vepër penale në raste të ndryshme të kemi masa sigurimi të ndryshme, pasi kjo vjen si pasojë e marrjes në konsideratë edhe të personalitetit të personit nën hetim. Nga vendimet e studiuara vihet re se gjykata nuk e vlerëson elementin e “personalitetit” në caktimin e masave të sigurimit.

Një tjetër problem i evidentuar është që gjykatat, në kundërshtim me orientimet unifikuese të Gjykatës së Lartë kanë referuar si shkak determinant për vendosjen e arrestit në burg, maksimumin e sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete dhe nuk kanë vlerësuar kushtet dhe kriteret e tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Masa e sigurimit personal është një veprim procedural që kufizon ose heq përkohësisht lirinë e personit, deri në përfundimin e gjykimit. Shkalla e tij varet nga nevojat e procesit të hetimit, duke pasur për qëllim që të parandalojë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të personit, prishjen apo fshehjen e provave, si dhe të garantojë shlyerjen e dënimit penal që mund të jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit.

Shembull ilustrues nr.1 - Gjykata, pavarësisht se ka referuar saktë të gjithë kuadrin ligjor që rregullon rastet dhe kushtet e arrestit me burg, nuk i analizon se si aplikohen ato në rastin konkret, por thjesht dhe vetëm duke iu referuar sanksionit të dënimit për atë vepër penale, direkt mbërrin në konkluzionin e mëposhtëm: *“Në këto kushte, duke pasur parasysh se vepra penale..... dënohet me gjobë ose me burgim deri në 7 vjet, gjykata krijon bindjen se personi në hetim ka rrezik ikje me qëllim që ti shmanget procedimit penal në ngarkim të tij dhe mundesisë së dënimit.”*. Pra gjykata, nuk bën analizë të rrezikut për ikje të personit konkret, por e barazon këtë koncept me “masën e dënimit”.

Shembull ilustrues nr.2 – Në një vendim tjetër, gjykata shprehet se: *“Rrezikshmëria e veprës është e tillë që të justifikojë caktimin e masës së sigurimit, pasi vepra penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 137/1 të Kodit Penal, është një vepër relativisht e rëndë penale dhe shoqërore. Duke marrë në konsideratë dënimin që tashmë parashikon Kodi Penal për këtë vepër penale me burgim si dhe përhapjen e kësaj vepre penale, gjykata çmon se kërkesa e prokurorit për masën e sigurimit është e drejtë.”*.

Shembull ilustrues nr.3 - Në lidhje me veprën e “Vjedhjes së energjisë elektrike”, ekspertët vërejnë qëndrime jo konsistente nga gjykata dhe prokuroria, për llojin e masës së sigurimit që është zbatuar në raport me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet. Në rastet e të paktën dy vendimeve,²⁰³ të lidhura mes tyre për shkak se personat kanë pasur kontrata qiraje, për zhvillim aktiviteti tregtar, vërehet se si prokuroria në kërkimet e saj, ashtu edhe gjykata në vendimmarrje, kanë sjellë zbatimin e masës “arrest në burg”. Kjo masë është motivuar me rrezikun e përsëritjes së veprës penale, ndërkohë që rreziku i përsëritjes mund të shmanget edhe duke urdhëruar detyrimin për qëndrimin në një vend të caktuar, ose larg një vendi të caktuar.

- **vazhdimësia, përsëritja, rrethante lehtësuese e rënduese, të parashikuara në Kodin Penal**

²⁰³ Vendimet Nr. 628 Akti dhe 630 Akti

Nga studimi i vendimeve gjyqësore rezulton se vazhdimësia apo përsëritja merret më pak në konsideratë, madje shumicën e rasteve, këto elemente nuk evidentohen. Më tepër duket se merren në konsideratë rrethanat lehtësuese apo rënduese. Megjithatë, në shumicën e rasteve, rrethanat lehtësuese nuk i kanë shërbyer gjykatës për të vendosur masa sigurimi më të lehta për personat e ndaluar/arrestuar në flagrancë. Ndërsa nga ana tjetër, rrethanat rënduese duket sikur janë përcaktuese, madje të tilla që zhvleftësojnë vetë edhe kushtet dhe kriteret e tjera të parashikuara në nenin 228 dhe 229 të KPrP.

Shembull ilustrues nr.1 – Janë vërejtur raste kur rrethanat lehtësuese kanë shërbyer si shkak për dhënien e një mase sigurimi më të butë se ajo e kërkuar nga prokurori. Konkretisht, në një vendim,²⁰⁴ gjykata ka konsideruar rrethanën lehtësuese që personi nën hetim është me aftësi të kufizuara në shikueshmëri dhe ky invaliditet nuk përputhet me masën e kërkuar “arrest në burg”, pasi personi nuk ka rrezik ikje për shkak të gjëndjes së tij.

Nga vendimet e studiuara rezulton se është shumë i përhapur qëndrimi i gjykatave sipas të cilave, nëse personi ka qënë i dënuar më parë, konsiderohet automatikisht person i rrezikshëm, dhe si i tillë i denjë për masën arrest në burg. Në këto vendime, është barazuar situata mes qënies “i/e dënuar” (edhe pse mund të mos jetë për të njëjtën vepër), dhe rrezikshmërisë apo mundësisë për të kryer. ***Shembull ilustrues nr.2*** - Sjellim këtu si shembull tipik një rast,²⁰⁵ ku gjykata ka vendosur “arrest në burg” duke argumentuar se “personi ka rrezik të iki”, por pa treguar aspak se përse ka rrezik ikje dhe si provohet ky rrezik. Me sa duket, gjykata i referohet faktit që personi ka qënë i dënuar më parë. Në fakt, kjo praktikë është tërësisht e gabuar, e bie ndesh edhe me praktikën unifikuese të GjL.²⁰⁶

Gjithashtu rezulton se gjykata është treguar e ashpër dhe nuk ka treguar asnjë kujdes të veçantë për të miturit, që dyshohen se kanë kryer vepra penale. Kjo reflektohet në llojin e masës së sigurimit personal e cila shpesh ka qënë “arrest në burg”.²⁰⁷ Në një rast ku gjykata ka vendosur “arrest në shtëpi” për një të mitur,²⁰⁸ nuk ka mbajtur parasysh që kjo masë ndërpret proceset mësimore të të miturit, njëllon si arresti në burg. Veprat penale të konsumuara nga të miturit kanë qënë përgjithësisht vepra të tilla si “Vjedhje” me shuma apo sende te papërfillshme, dhe një rast kur dy të mitur janë akuzuar për “Armëmbajtje pa leje”.²⁰⁹

c) Gjendja e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit

Mbipopullimi në sistemin e burgjeve dhe veçanërisht në institucionet apo seksionet e paraburgimit ka qënë gjithmonë një fenomen shqetësues për vendin tonë. Mbipopullimi shkakton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në rrethana të caktuara përbën edhe elementë të trajtimit ç’njerëzor dhe degradues. Ky fenomen nuk përbën një kriter ligjor të

²⁰⁴ Vendimi Nr. 486 datë 20.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

²⁰⁵ Vendimi Nr. Akti 857

²⁰⁶ Vendimi Unifikues Nr 7 i vitit 2011

²⁰⁷ Shiko analizën e Vendimit Nr. Akti 41, 220, 223, 705, 706 etj.

²⁰⁸ Vendimi Nr. Akti 970

²⁰⁹ Vendimi Nr. 41 dhe 582 Akti

parashikuar në Kodin tonë të Procedurës Penale për tu marrë në konsideratë nga gjykata, kur cakton një masë sigurimi personal, e veçanërisht të “arrestit në burg”. Por duke vlerësuar si shqetësues për sistemin tonë të drejtësisë penale këtë fenomen, gjykatat si aktori më i rëndësishëm që garanton zbatimin e drejtë të ligjit, kemi mendimin se duhet të tregojë një ndjeshmëri të caktuar ndaj tij.


Fenomeni i mbipopullimit duhet të adresohet më mirë në praktikën gjyqësore të caktimit të masave të sigurimit, në proporcionalitet me kriteret që parashikon Kodi ynë i Procedurës Penale. Psh, Gjykata mund të shmangë “arrestin në burg”, duke vlerësuar në mënyrë kumulative kriteret ligjore (psh kur fakti që hedh dritë për dyshimin se është kryer një vepër penale, nuk paraqet rëndësi të atillë apo rrezikshmëri, kur vepra penale nuk ka sanksion të lartë) me faktin se mbipopullimi në institucionet e paraburgimit që janë në kompetencën territoriale të saj është shqetësues.

Nga të gjitha vendimet e studiuara rezulton se nuk ka pasur asnjëherë referim në lidhje me gjendjen e mbipopulluar të institucioneve të paraburgimit, ndërkohë që janë vërejtur raste ku gjykata, edhe pse nuk ka pasur të paraqitur ndonjë statistikë zyrtare si provë, i referohet gjendjes të rëndë të kriminalitetit në lidhje me një vepër penale të caktuar, për të dhënë masën e sigurimit “arrest në burg”. Nëse do të përdorte të njëjtin standart, gjykata mundet që edhe kryesisht të konsideronte gjendjen e mbipopulluar të institucioneve të paraburgimit. Mosmarrja në konsideratë e gjendjes së mbipopullimit të të paraburgosurve, në caktimin e masave të sigurisë në paraburgim, duket sikur e shkëput gjykatën nga realiteti i një problematike shqetësuese për sistemin penitenciar. Gjithashtu, ky është tregues i një mungese të kohezionit por edhe bashkëpunimit mes organeve të sistemit të drejtësisë penale në vend.

7.7 Kategorizimi i të dhënave të personave ndaj të cilëve janë kërkuar dhe/ose caktuar masa të sigurimit personal

- 7.7.1** Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore referuar gjendjes arsimore të ndaluarit/arrestuarit rezulton se:
- a) Përqindja më e madhe prej 36.5% (664) i përket të arrestuarve/ndaluarve të cilët kanë arsim 8/9 vjeçar.
 - b) Në 32.4% (590) të rasteve i arrestuari/ndaluari ka arsim të mesëm.
 - c) Në 13.5% (246) raste i ndaluari/arrestuari ka arsim të lartë.
 - d) Në 12.3% (222) të vendimeve gjyqësore të monitoruara nuk del e dhëna e gjendjes arsimore të të ndaluarit/arrestuarit.
 - e) Ndërsa 5.3% (97) të rasteve rezultojnë pa arsim.

GJENDJA ARSIMORE E TË NDALUARIT/ARRESTUARIT NË FLAGRANCË




7.7.2 Referuar statusit shoqëror, në lidhje me marrëdhënien e punës dhe profesionin e kryer nga i ndaluar/arrestuari, referuar 1796 përgjigjeve nga ekspertët junior që kanë asistuar ekspertët e nivelit senior, paraqiten këto të dhëna:

- a) Në 68.7% (1235) raste nuk mund të evidentohet kjo e dhënë.
- b) Në 17.6% (316) të rasteve i ndaluar/i arrestuari nuk ka një marrëdhënie pune.
- c) Ndërsa në 13.7% (246) të rasteve personi është në marrëdhënie pune.

7.7.3 Referuar elementit të kategorizimit të ndaluarit/arrestuarit bazuar në shtetësinë, moshën, gjendjen shëndetësore, përkatësinë në një grup të ndryshëm, etj, rezulton se:

- a) 74,6% (1356) prej tyre nuk i përkasin asnjë kategorie;
- b) 13.2% (240) prej tyre janë të rinj (jean juvenile) në moshën 18-21 vjeç;
- c) 5.3% (98) prej tyre janë të mitur nën 18 vjeç;
- d) 2.5% (44) prej tyre i përkasin kategorisë “i huaj”;
- e) 1% (17) prej tyre përfshihen në kategorinë e personave me probleme të shëndetit mendor;
- f) 0.6% (8) prej tyre i përkasin kategorisë së minoriteteve, prej të cilëve gjysma Minoritetit Rom;
- g) 0.2% (3) prej tyre i përkasin personave me orientim të ndryshëm seksual;
- h) në 2.6% (47) raste kjo e dhënë nuk del nga monitorimi.

Bazuar në përmbajtjen e vendimeve, vërehet se është respektuar procedura për prezencën e detyrueshme të psikologut gjatë pyetjes së të ndaluarit/të arrestuarit të mitur. Megjithatë, në 2 nga vendimet, gjykata nuk merr parasysh kërkesën e psikologut për të caktuar një masë sigurimi më të butë. Në 1 rast, gjykata ka vendosur masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturin 15 vjeçar për veprën penale “vjedhje” të një vlerë shumë të vogël (kryesisht ushqime dhe pije). Në një nga vendimet e studiuara, gjykata nuk merr në shqyrtim kërkesën e mbrojtësit, i cili pretendon se i ndaluar është i sëmurë mendor dhe paraqet ezhenë e kokës si dhe raportin e mjekut.



7.7.4 Referuar elementit të kategorizimit të ndaluarit/arrestuarit bazuar në gjininë, rezultojnë se:


- 95.5% (1727) prej tyre i përkasin gjinisë mashkullore.
- 4.3% (77) prej tyre i përkasin gjinisë femërore, dhe
- në 0.2% (3) të rasteve kjo e dhënë nuk mund të evidentohet nga monitorimi i vendimeve gjyqësore.

7.7.5 Lidhur me gjendjen familjare të të ndaluarit/arrestuarit rezultojnë se:

- 43% (774) e tyre janë beqarë pa persona në ngarkim.
- 32.3% (582) e tyre janë të martuar dhe me fëmijë.
- 9.1% (164) e tyre rezultojnë të martuar por pa fëmijë.
- Në 13% (235) të rasteve të monitoruara rezultojnë se kjo e dhënë nuk është e qartë.
- Ndërkohë 1.9% (34) të rasteve kanë një gjendje tjetër familjare: divorcuar (21 raste); divorcuar dhe me fëmijë (6 raste); i fejuar (2 raste) dhe i ve (4 raste).
- 0.7% (12) e tyre janë beqarë por me persona në ngarkim në familje.

7.7.6 Vendimet e studiara evidentojnë këto të dhëna për gjendjen gjyqësore për të ndaluarin/arrestuarin në flagrancë:

- 76.3% (1387) prej tyre kanë qenë të padënuar më parë.
- 14.4% (263) prej tyre rezultojnë të dënuar më parë.
- 0.5% (9) e tyre janë të padënuar më parë por janë gjykuar ose hetuar për një vepër tjetër penale.
- në 8.5% (155) të rasteve nuk del e dhëna për gjendjen gjyqësore, ndërkohë që asnjë rast nuk paraqitet si i rehabilituar (0%).




7.7.7 Nga monitorimi i cilësisë procedurale të personit ndaj të cilit është caktuar masë sigurimi, bazuar në 1800 përgjigje të reflektuara nga ekspertët junior rezulton se:

- Në 78.1% (1406) të rasteve personi është në cilësinë e të arrestuarit në flagrancë.
- Në 14.3% (257) të rasteve personi është në cilësinë e të ndaluarit.
- Në 6.1% (110), personat përfshihen në një kategori tjetër si: i pandehur në kërkim (7 raste); gjykim në mungesë (13 raste); i pandehur në gjendje të lirë (4 raste); i pandehur në paraburgim (16 raste); person nën hetim (65 raste); caktim mase sigurimi me qëllim ekzekutimin e urdhrit të ndalimit ndërkombëtar ose qëllim ekstradimi (3 raste); caktim i masës sigurimit sekrete (2 raste).
- Në 1,5% (27) të rasteve, kjo e dhënë nuk paraqitet.

7.8 Vendimmarrja e Gjykatës

a) Të dhëna sasiore

Për sa i përket llojit të masës shtrënguese të vendosur nga gjykata, analiza e vendimeve të studiuara tregon përdorim tepër të lartë të masës së “arrestit në burg”, përkatësisht në 47.9% të rasteve ose për 851 persona. E renditur në vend të dytë sa i takon zbatueshmërisë është masa “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, caktuar në 42.3% të rasteve ose për 752 persona. Në vend të tretë renditet masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, e zbatuar në 8.4% të rasteve ose për 149 persona, ndërkohë që masa e sigurimit “garancia pasurore” dhe “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, rezultojnë se janë zbatuar në një masë tepër të ulët, përkatësisht në 0.9% të rasteve ose për 16 persona dhe në 0.4% të rasteve ose për 7 persona. Të renditura në fund janë masat shtrënguese “ndalim i daljes jashtë shtetit” dhe “ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar”, të zbatuara përkatësisht në 0.1% të rasteve.



Lidhur me faktin nëse masa shtrënguese është shoqëruar me masa të tjera ndaluese, nga të dhënat rezulton se, në 98.2% (1757) të rasteve gjykata nuk ka caktuar masë ndaluese. Në vetëm 1.8% (32) të rasteve, masa shtrënguese është shoqëruar me masa ndaluese të ndryshme. Konkretisht, në 7 raste është shoqëruar me masën “Sekuestro preventive”, ndërkohë që në 9 raste gjykata ka gjykuar që masa ndaluese të jetë “ndalimi i komunikimit me persona të tjerë përveç familjarëve dhe avokatit” dhe në 2 raste ka vendosur masën “Ndalimi i komunikimit me persona të tjerë, përveç familjarëve apo personave që bashketojnë me ta”. Në 6 raste është dhënë masa “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”. Ndërsa 8 raste të tjera, informacioni nuk rezulton të jetë pasqyruar.

Në lidhje me respektimin nga gjykata të afatit kohor të shpalljes së vendimit, brenda dyzet e tetë orëve nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë, rezulton se në 96.4% (1713) të rasteve, ky afat është respektuar. Në 2.6% (48) të rasteve, gjykata nuk e ka shpallur vendimin e saj brenda këtij afati, ndërkohë që në 1% (17) të rasteve, kjo e dhënë nuk evidentohet në vendimet e studiara.

Në mënyrë të pjesshme, në varësi të të dhënave dhe dokumentacionit në dosjet gjyqësore të studiara, vëzhguesit i janë përgjigjur pyetjes në lidhje me respektimin e procedurës së marrjes në pyetje të personit të arrestuar, jo më vonë se tre ditë nga zbatimi i masës së së sigurimit “Arrest në burg” ose “Arrest në shtëpi”. Nga 348 raste kur vëzhguesit (ekspertët junior) i janë përgjigjur kësaj pyetje, rezulton se në 90.8% (316) të rasteve personi për të cilin është vendosur një nga këto masa është marrë në pyetje brenda këtij afati. Ndërsa në vetëm 9.2% (31) të rasteve, rezulton që kjo procedurë nuk është zbatuar.

Referuar 847 përgjigjeve të vëzhguesve në lidhje me kohëzgjatjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, rezulton se në 87.8% (744) të rasteve, gjykata nuk e ka përcaktuar kohëzgjatjen. Në 12.2% (103) të rasteve është përcaktuar kohëzgjatja e masës së sigurimit “Arrest në burg”. Në 96, raste, kohëzgjatja është përcaktuar me qëllim garantimin e marrjes osë vërtetësisë së provës (Neni 245/1/ç K.Pr.P).

b) Cilësia e vendimeve të studiuara

Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është detyrim kushtetues, i cili buron drejpërdrejt nga neni 142/1 i Kushtetutës, ku thuhet se: “Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara”. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është garanci edhe për të drejtën për një proces të rregullt ligjor që garantohet jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe nga KEDNj si dhe nga praktika e GjEDNj dhe GjK. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë në apel. Duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë.

Referuar jurisprudencës së GJK²¹⁰, vendimi gjyqësor, në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Në këtë drejtim, arsyetimi duhet të plotësojë disa kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që çenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar.

Të njëjtat standarte të elaboruara në jurisprudencën e GJK, kërkohen të respektohen edhe në vendimet gjyqësore për vleftësimin e arrestimit/ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit, pasi këto vendime kanë efekte të dreptpërdrejta mbi lirinë e individëve.

Përgjithësisht, rezulton se vendimet e studiuara në këtë raport, janë të arsyetuara shumë pak, ose aspak. Vendimet e të dyjave gjykatave që janë monitoruar, përgjithësisht citojnë thjesht ligjin, konkretisht kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit të përcaktuara në nenet 228, 229 dhe 230 të KPrP por pa i konkretizuar me faktet dhe rrethanat e çështjes përkatëse. Arsyetimet janë kryesisht të dobëta. Në pjesën më të madhe të rasteve, gjykata nuk ka marrë në analizë as në mënyrë të përmbledhur provat mbi të cilat mbështeten faktet e referuara në vendimin gjyqësor. Gjykata është mjaftuar me citimin e provave shkresore të prokurorisë, por pa bërë referime të fakteve mbi të cilat hedhin dritë këto prova. Kjo mënyrë arsyetimi, sidomos në rastet kur gjykata ka vendosur masat më të

²¹⁰ Shih vendimin nr.20, datë 13.04.2012

rënda shtrënguese (si ajo e arrestit me burg), nuk garanton respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Një element tjetër që vërehet në vendimet e studiara, është se mungon pothuajse çdo lloj arsytimi për të rrëzuar pretendimet e mbrojtjes. Shpeshherë, prova apo diskutime në lidhje me vetë ekzistencën e veprës penale anashkalohen dhe mënjahen, ndërkohë që ekzistenca e veprës penale është kushti themelor për caktimin e masave të sigurimit, dhe si i tillë, mundet dhe duhet diskutuar gjatë gjykimit për caktimin e masës së sigurimit.

Shqipëria për shumë vite ka pasur një sistem procedimi penal të llojit inkuizitor, dhe kalimi në sistemin e pastër akuzator ende shfaq problematika të ndryshme mëndësie, ku shpesh duket se prokurori trajtohet si palë me e avantazhuar nga gjykata. **Shembull ilustrues nr.1** - Gjykata nuk argumenton përshtatshmërinë e masës së sigurimit sipas provave që i paraqiten për të formuar bindjen e saj të brendshme. Përkundrazi, gjykata shprehet se masa e sigurimit “arrest në burg”, kërkuar nga përfaqësuesi i akuzës duhet pranuar, sepse është ky organ që paraqet përpara gjykatës llojin e masës shtrënguese për efekt të procedimit penal dhe të hetimit të çështjes në ngarkim të të dyshuarit, dhe gjykata duhet ta pranojë.

Të dhënat cilësore të analizuara më herët, pasqyrojnë se, përgjithësisht arsytimi i gjykatës është shumë i ngjashëm, për të mos thënë i njëjtë, me argumentat në kërkesën e prokurorit. Vetëm në 8.6% të vendimeve të analizuara, gjykata ka vendosur dhënien e një mase më të lehtë se ajo e kërkuar nga prokurori, dhe vetëm në 1.5% të këtyre rasteve ka vendosur lirin e menjëhershëm të të ndaluarit/arrestuarit. Pothuajse të gjitha vendimet e monitoruara, janë tepër të shkurtra. Ka raste kur Gjykata përveç parashtrimit shkurtimisht të fakteve, fiks siç i ka paraqitur prokurori, nuk ka bërë asnjë lloj argumentimi qoftë edhe formal në vendimin e saj.

Ekspertët kanë vërejtur vendime gjyqësore, ku gjykata, në pjesën arsyetuese përdor argumenta të cilat bien në kundërshtim me dispozitivin e vendimit. Në vijim janë ilustruar disa prej këtyre shembujve.

Shembull ilustrues nr.2 - “Gjykata vlerëson se është e drejtë kërkesa e prokurorit për të caktuar si masë sigurimi atë të arrestit në burg dhe se duhet rrëzuar kërkesa e personit nën hetim e përfaqësuesit të tij për kërkesën për caktim sigurimi detyrim për paraqitje duke e liruar menjëherë personin nën hetim..... dhe në përfundim vendos: të caktojë për personin nën hetim M.T., masën e sigurimit personal “detyrim për paraqitje.”

Shembull ilustrues nr.3 - Gjykata vlerëson se është e drejtë kërkesa e prokurorit për të caktuar si masë sigurimi atë të arrestit në burg dhe se duhet rrëzuar kërkesa e personit nën hetim e përfaqësuesit të tij për kërkesën për caktim sigurimi detyrim për paraqitje duke e liruar menjëherë personin nën hetim..... Vepra penale për të cilën ai dyshohet dhe menyra e kryerjes së saj, si dhe nga provat e paraqitura nga prokurori i krijojnë gjykatës se personi nën hetim M. T., duhet të qëndrojë në masë sigurimi arrest me burg..... dhe në përfundim, gjykata vendos “të caktojë për personin nën hetim M.T., masën e sigurimit personal “detyrim për paraqitje.”

Shembull ilustrues nr.4 – Gjykata, pavarësisht se arsyeton se “Nuk jemi në kushtet e neneve 228/3/a dhe 245/ç të KPrP. Nuk provohet të ekzistojnë shkaqe të rëndësishme të cilat vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj nga i dyshuari, pasi siç rezultojnë kryer të gjitha veprimet e para hetimore në marrjen e të gjitha provave në vendngjarje”, në përfundim vendos të caktojë masën e sigurimit “arrest në burg”, e cila është një masë ekstreme. Gjykata nuk arsyeton se pse asnjë masë tjetër nuk është e përshtatshme, por për më tepër, argumentimi i saj bie ndesh me masën e caktuar.

Janë vërejtur raste, ku gjykata përdor në vendim, pjesë nga arsyetimi i vendimeve të mëparshme, pa u përpunuar fjalitë dhe paragrafet sipas kontekstit dhe fakteve të çështjes konkrete. Kjo mund të jetë gjithashtu shkak për natyrën kontradiktore midis pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit, të analizuar në paragrafët e mësipërm.

Shembull ilustrues nr.5 - Gjykata cakton masën e sigurimit “arrest në burg”, kur ndërkohë vetë ajo në vendim arsyeton se mungon dyshimi i arsyeshëm për caktimin e masës. Më konkretisht në këtë vendim gjykata arsyeton se: *“Në referim të dispozitave të mësipërme Gjykata çmon se në rastin konkret masa e sigurimit personal “arrest në burg” me afat 1 (një) muaj parashikuar nga neni 238 dhe 245 të Kodit të Procedurës Penale është e përshtatshme. Kjo për shkak se referuar akteve bashkëngjitur kërkesës, rezultojnë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave në të cilat ka ndodhur ngjarja, në pjesën që lidhet me pretendimet e organit të akuzës për mbajtjen e armës së zjarrit nga i arrestuari, pretendim i cili deri në këtë fazë nuk gjen mbështetje në asnjë provë, duke munguar dyshimi i arsyeshëm për këtë vepër penale”*. Megjithatë, edhe pse sipas vetë gjykatës, mungon dyshimi i arsyeshëm për këtë vepër penale, pasi nuk ka asnjë provë për të, gjykata cakton masën e sigurimit “arrest në burg” me afat 1 (një) muaj. Ky vendim duket se bie ndesh haptazi me nenin 228/1 të KPrP i cili parashikon prerazi se: “Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”.

Megjithatë, ekspertët kanë vërejtur edhe vendime, ku arsyetimi dhe mënyra se si është strukturuar vendimi nga gjykata është vërtet cilësor. Sidoqoftë, nga ky studim rezultoi se të tilla raste janë vërtet sporadike.

c) Nevoja për të individualizuar argumentimin në vendimin gjyqësor në raport me faktet, provat dhe nevojat konkrete të sigurimit (masën që caktohet)

Në disa nga vendimet e studiuara vërehet se, i njëjti shkak dhe argumentim i ka shërbyer gjykatës si për të caktuar “arrest në burg”,²¹¹ ashtu edhe për të caktuar “detyrim paraqitje”.²¹² Gjykata nuk e analizon në raport me faktet dhe provat e çështjes se përse ekziston rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale.

Shembull ilustrues nr.1 - Për dy personat nën hetim për kryerjen e dy veprave penale (ngacmimi seksual dhe moskallëzim krimi), gjykata ka mbajtur ka caktuar masën ekstreme të sigurimit “arrest në burg”, ndërsa për 2 personat nën hetim të dyshuar për veprën penale

²¹¹ Shembulli, Vendimi Nr. Akti 608

²¹² Shembulli, Vendimi Nr. Akti 621

“moskallëzim krimi”, ka mbajtur qëndrim duke caktuar masën më të lehtë të sigurimit “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”. Në lidhje me përshtatshmërinë e masave të sigurimit, gjykata, në çdo rast ka bërë të njëjtin arsyetim duke u shprehur se: *“Në rastin konkret, rrezikshmëria shoqërore e veprës dhe autorit të saj plotëson kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masave të sigurimit personal të parashikuara nga nenet 228, 229, 230 të KPrP”*.

d) Arresti në flagrancë dhe Ndalimi

Sipas neneve 244-250 të KPrP, gjykata është organi që ka të drejtë të vendosë arrestin me burg (si masa ekstreme e sigurimit personal), sipas kushteve dhe kriterëve të KPrP. Por ka dy përjashtime nga ky rregull, sipas të cilave, të drejtën për të arrestuar në flagrancë apo për të ndaluar, e ka edhe prokurori edhe policia, referuar kjo neneve 251 dhe 253 të KPrP. Për sa më sipër, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 4 datë 24.06.2009, përcaktohet edhe mënyrat për vendosjen e masave të sigurimit personal, të cilat janë:

- (i) Mënyra e parë, parashikohet nga neni 244 e vijues i këtij KPrP. Prokurori i paraqitet kërkesë gjykatës që të caktojë një masë sigurimi personal, me qëllim që të garantojë nevojat e sigurimit. Në këtë rast, gjykata verifikon nëse ekzistojnë realisht nevoja e sigurimit, dhe nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal. Gjykata pasi verifikon rrethanat faktike, përcakton llojin e masës së sigurimit në përputhje me kriteret ligjore, me kushtin e vetëm që masa të mos jetë më e rëndë se ajo që kërkohet nga prokurori. Ndërkohë, sipas nenit 248 të KPrP, jo më vonë se tre ditë nga zbatimi i masës së caktuar dhe ekzekutuar si më sipër, gjykata merr në pyetje personin me qëllim që të verifikojë kushtet e zbatimit të masës të vendosur ndaj tij dhe nevojat e sigurimit e njohur si “seanca e verifikimit”.
- (ii) Mënyra e dytë, ka të bëjë fillimisht me “seancën e vleftësimit” të ndalimit ose të arrestimit në flagrancë të personit dhe më pas me vlerësimin nëse ekzistojnë ose jo nevojat për sigurimin e personit. Në këtë seancë, gjykata verifikon nëse veprimet për heqjen e lirisë së personit (ndalimi/arresti në flagrancë) janë ose jo në përputhje me ligjin, dhe së dyti, mbi kërkesën e prokurorisë, gjykata verifikon nëse nevojat e sigurimit e kërkojnë ose jo që ndaj personit të caktohet një masë sigurimit personal, deri në përfundim të çështjes penale.

Pavarësisht nga mënyra e ndjekur, gjykimi në të dyja rastet bazohet mbi parimet e procesit të rregullt dhe gjykata e zhvillon gjykimin në prezencën si të prokurorit ashtu edhe të personit të ndaluar ose të arrestuar. Të dyja palëve, si akuzës dhe mbrojtjes, i garantohet e drejta që pretendimet e tyre t’ia parashtrojnë gjykatës në mënyrë të barabartë, të kërkojnë marrjen e provave dhe të kundërshtojnë njëra-tjetrën. Në më të shumtën e rasteve në vendimet e studiuar, rezulton se arrestimet/ndalimet kryhen nga policia për shkak të gjendjes së flagrancës, dhe kështu merr rëndësi analizimi i dy elementëve: Flagrancës dhe Ndalimit.

- Arresti në flagrancë

Referuar nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi viktimë ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Në 78,1% (1406) të vendimeve të studiuara, personi është në cilësinë e të arrestuarit në flagrancë. Ka shumë raste që gjykata, edhe pse nuk e ka vleftësuar arrestin në flagrancë si të ligjshëm, përsëri sërish ka vijuar të caktojë një masë sigurimi sipas nenit 244 KPrP. Qëndrimi i gjykatës përgjithësisht është i llojit “pavarësisht (pa)ligjshmërisë së arrestimit, është gjithmonë nevoja për masë sigurimi”.

Bazuar edhe në monitorimet që KShH ka kryer në të kaluarën në komisarate, sa i takon respektimit të të drejtave të shtetasve të ndaluar apo të arrestuar në flagrancë, rezulton që veçanërisht policia, arreston në flagrancë shtetas të cilët nuk ndodhen në kushtet e parashikuara në nenin 252 të Kodit. Gjithashtu, në disa prej këtyre rasteve, arrestimi në flagrancë i tyre përlligjet nga prokuroria dhe vleftësohet më pas nga gjykata.

Shembul ilustrues nr.1: Edhe më herët në këtë raport studimor janë evidentuar raste tepër të diskutueshme ku gjatë seancës së vleftësimit të arrestit në flagrancë, gjykata nuk ka verifikuar me rigoroitet ekzistencën ose jo të kushteve ligjore që duhet të ekzistojnë për ta legjitimuar atë. Në një nga rastet studimore, personi i arrestuar në flagrancë yshohet se ka vjedhur një një çift disqesh alumini, në datë 02.03.2015. Pas dy ditësh, është bërë kallzimi, përkatësisht në datë 04.03.2015. Arrestimi i konsideruar në flagrante nga policia, kryhet në datë 01.04.2015, domethënë rreth 1 muaj pas ngjarjes, ndërkohë që autorit nuk i është gjetur asnjë provë materiale.

Nga studimi i të dhënave të grumbulluara nga ekspertët, evidentohet qarazi se për 8 persona të arrestuar në flagrancë nuk vërehet ekzistenca e kushteve të parashikuara në nenin 252 të Kodit të Procedurës Penale, pra nuk përlligjet gjendja e arrestit në flagrancë. Konkretisht, arrestimi për këta shtetas është ekzekutuar disa orë ose disa ditë pas ndodhjes së ngjarjes, ose arrestimi është bërë pas kallëzimit ose i arrestuari është marrë në pyetje nga policia në spital pasi ka kaluar kohë nga ndodhia e ngjarjes dhe policia nuk ka qenë në ndjekje të tij.

Ekspertët kanë vërejtur vendime që bëjnë diferencë pozitive në trajtimin e gjendjes së flagrancës. Në këto vendime, vërehet një analizë adekuate e ligjit sa i takon gjendjes së flagrancës, ku gjykata ka rrëzuar kërkesën e prokurorisë për vleftësimin e ligjshëm të tij. **Shembull ilustrues nr.2:** Në një nga vendimet, gjykata arsyeton se reagimi i policisë, 5 orë pas ngjarjes, bën që flagranta të mungojë dhe arresti të jetë i paligjshëm.

Një fenomen i vërejtur rëndom në vendimet e studiuara është se, edhe në ato raste kur gjykata nuk e ka vleftësuar si të ligjshëm “arrestin në flagrancë” të personit, ajo ka vijuar në caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg” pa vendosur më parë lirimin e tij të menjëhershëm, në kundërshtim me nenin 259/4 të KPrP. Vlen të theksojmë se parashikimet e nenit 259 të KPrP, paragrafi 3 dhe 4, janë shumë të qarta. Nëse gjykata vëren se arresti në flagrancë është i paligjshëm, ajo duhet të lirojë menjëherë personin. Vetëm pasi të bëjë këtë deklaram, gjykata mund të marrë në shqyrtim kërkesën e dytë, atë të caktimit të masës së sigurimit dhe të shprehet për të.

- *Ndalimi*

Nga monitorimi i cilësisë procedurale të personit ndaj të cilit është caktuar masë sigurimi, bazuar në 1800 përgjigje të reflektuara nga ekspertët junior rezulton se në 14,3% (257) e rasteve personi është në cilësinë e të ndaluarit.

Në disa nga vendimet gjyqësor vërehet se nuk është analizuar ndalimi me iniciativë, provat që vërtetojnë ekzistencën e kushteve të ndalimit, nuk jepet argumentimi i plotë i gjykatës, pse ky ndalim konsiderohet i ligjshëm. Gjithashtu, janë vërejtur raste kur faktet e listuara në vendim, vendosin në pikëpyetje ligjshmërinë e ndalimit të personit nën hetim nga policia gjyqësore.

Ndalimi me iniciativë të policisë paraqet ndjeshmëri dhe kërkon një kujdes të veçantë nga gjykata, për të verifikuar në mënyrë rigorozë nëse ka patur ose jo arbitraritet nga policia në zbatimin e kërkesave që dikton Kodi i Procedurës Penale. Prandaj, çdo vendim i gjykatës në lidhje me këtë çështje është me shumë vlerë dhe duhet të ishte i arsyetuar për të garantuar respektimin e një procesi të rregullt.

e) Habeas Corpus

Habeas Corpus ose siç njihet ndryshe, e drejta e personit për të dalë para një autoriteti gjyqësor për të verifikuar ligjshmërinë e ndalimit apo çdo forme tjetër të kufizimit të lirisë së tij, është një e drejtë që mishërohet edhe në legjislacionin tonë të brendshëm.

Sipas nenit 251 të KPrP, kërkesa e prokurorit për vlefesimin e arrestimit në flagrancë paraqitet në gjykatë, brenda 48 orëve nga momenti i arrestimit. Sipas nenit 258 të KPrP, në rastet kur arresti është kryer në gjendjen e flagrancës ose me iniciativë nga policia, prokurori duhet të paraqesë kërkesën për mbajtjen e seancës së vlefesimit, brenda 48 orëve. Gjykata shpall vendimin brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës së prokurorit. Kushtetuta parashikon se personi të cilit i hiqet liria duhet “të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.” Llogaritja e këtyre eve fillon nga momenti i heqjes efektive të lirisë dhe jo nga momenti i mbylljes në ambientet e policisë.

Ekspertët e KShH-së janë ndalur edhe në analizë, për shkak të qëndrimit të ndryshëm që kanë mbajtur gjykatat në vendimet e studiuara, e sidomos të praktikës që është ndjekur nga policia dhe prokuroria, të cilat duket që janë në mospërputhje me nenin 27-28 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNj.

Nga vendimet e studiuara rezulton se ka patur raste kur as procesverbali i policisë, as kërkesa e prokurorit as vendimi i gjykatës, nuk reflektojnë orët e mbajtjes së tyre. Kryesisht, në vendimet e dhëna nga magjistratët e rinj (në vitin e praktikës), është evidentuar ky element i rëndësishëm që mundëson vlerësimin e drejtë të gjykatës për respektimin ose jo të afateve të cituara më sipër. Të dhënat statistikore lidhur me

respektimin e afatit 48 orësh nga gjykata për shpalljen e vendimit, janë analizuar më herët në këtë raport.

Mgjth, vlen të evidentohet ndonjë rast studimor, ku edhe organi i akuzës nuk ka respektuar afatin 48 orësh për ta dërguar personin para gjykatës, por e ka bërë këtë 3 deri në 5 ditë me vonesë, në të paktën 5 raste. **Shembull ilustrues nr.1** – Në një nga vendimet, gjykata referon se arresti në gjendjen e flagrancës është kryer nga policia, në datë 21.01.2015. Kërkesa për vleftësimin e tij është dërguar në gjykatë në datën 25.01.2015. Gjykata konstaton se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 48 orë, dhe se masa e përkohshme e arrestit në flagrancë e ka humbur fuqinë juridike. Në këtë drejtim, gjykata argumenton dhe konstaton pavlefshmërinë absolute të një procesverbali të dytë për arrestimin në flagrancë, i kryer me pas.

7.9 Zgjatja e paraburgimit

Nga vendimet e analizuara për efekt të këtij studimi rezulton se përgjithësisht zgjatja e afatit të “arrestit në burg” është justifikuar me marrjen e provave. Megjithatë, janë evidentuar dhe raste kur gjykata ka vendosur të zgjase afatet e paraburgimit, jo në plotësim të kriterëve të vendosura nga neni 264/2 i KPrP. Në këto raste, duket se gjykata ka respektuar formalisht kriterin e zgjatjes së afatit “vetëm një herë” dhe “jo më shumë se tre muaj”, por nuk ka argumentuar zgjatjen e afatit sipas kushteve ligjore, koncretisht: për nevoja të rëndësishme sigurimi, apo për kryerjen e verifikimeve veçanërisht komplekse.

Të njëjtat mangësi që janë vërejtur në praktikën e organit të akuzës për të kërkuar masa të rënda të sigurimit personal, vërehen edhe në rastin e kërkesave të prokurorit lidhur me zgjatjen e afatit të masës, veçanërisht të asaj “arrest në burg” (mungesa e proporcionalitetit në raport me rëndësinë e faktit, mungesën e provave, etj).

Lidhur me zgjatjen e afatit të paraburgimit, duhet të mbahen në konsideratë kërkesat e nenit 260 e vijues të KPrP. Sipas nenit 264/2 të KPrP: “2. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin merr vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.”

GjL ka mbajtur një qëndrim unifikues²¹³, duke u shprehur se: “Njekohesisht, gjykata duhet të mundesoje një gjykim ku të realizohet efektivisht verifikimi ezaurues, jo formal, i “gjendjes së procedimit” në teresi, pra i të gjitha rrethanave dhe kushteve thelbeëore për ligjshmerinë e vazhdimin të zbatimit të masës së arrestit në burg, ku përfshihet edhe vlerësimi mbi diligjencën e posaçme - kujdesin dhe perpjekjet e duhura, të justifikueshme, të organit të prokurorisë për përmbushjen si në kohe, ashtu edhe në substancë të veprimeve hetimore sipas ligjit, posaçërisht në raport me rrethanat e procedimit penal, objekt i atij gjykimi.”

²¹³ Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr.1, datë 08.01.2009

Gjithashtu, në praktikën e tij Kolegji Penal i GjL,²¹⁴ ka mbajtur këtë qëndrim: “nga përmbajtja e dispozitave ligjore të mësipërme, konstatohet se mundësia ligjore për të zgjidhur afatin e hetimit nga prokurori nuk përbën një rregull por një përjashtim nga rregulli. Nga ana tjetër vihet re se brenda mundësisë ligjore për të aplikuar zgjatjen e afatit të hetimit, prokurori ka mundësi të kryejë një ose më shumë zgjatje duke respektuar kufijtë maksimalë të kohëzgjatjes së paraburgimit dhe afatet e përgjithshme të hetimit.

Më tej, me anë të një vendimi tjetër,²¹⁵ Kolegji Penal i GjL ka po ashtu qëndrim se: “Neni 261 i K.Pr.Penale parashikon mundësinë e gjykatës, që në rastet e parashikuara nga neni 245/1/ç i K.Pr.Penale, pra kur masa e sigurimit është caktuar me afat, që pas mbarimit të afatit të caktuar të urdhërojë përsëritjen brenda kufijve të përcaktuar në nenet 264 dhe 267 të po këtij Kodi. Ndërsa neni 264/2 i K.Pr.Penale parashikon se: “Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin mer vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.”

Nga interpretimi i sa më sipër i legjislacionit si dhe praktikës së GjL, në mënyrë që të pranohet kërkesa për zgjatjen e afateve të paraburgimit, duhet të plotësohen dy kushte themelore: Së pari, të ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi; Së dyti, përsëritja të jetë e domosdoshme për shkak të nevojës së verifikimeve veçanërisht komplekse.

Në përgjithësi, nga vendimet studiuara rezulton se këto kushte nuk respektohen; hera herës as që përmenden nga gjykata. Në konkretizim të sa më sipër, sjellim njërën nga rastet e studiuara,²¹⁶ ku personi është arrestuar për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”.

Vendimi i parë:²¹⁷

Vepra penale :	Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor (Neni 290 KP)
Arresti:	Ne flagrance
Masa e kërkuar nga Prokurori:	Arrest me burg
Masa e kërkuar nga mbrojtësi:	Arrest me burg me afat 15 ditor
Masa e caktuar:	Arrest me burg me afat 15 ditor
Rrethana lehtësuese/rënduese:	-

Vendimi i dytë:²¹⁸

Objekti : (pranuar)	Kërkesë për zgjatjen e afatit të masës së sigurimit
------------------------	---

²¹⁴ Vendim i Gjykatës së Lartë Nr.17/3, datë 21.08.2015

²¹⁵ Vendim i Gjykatës së Lartë Nr. 33/1 datë 08.10.2015

²¹⁶ Vendimi Nr. Akti 16, datë 05.01.2015; I njëjti qëndrim është edhe në Vendimin Nr. 10 dhe 10/1 Akti.

²¹⁷ Vendimi Nr. 16 Akti, datë 02.01.2015

²¹⁸ Vendimi Nr. 16/1 Akti, datë 02.01.2015

Vendimi i tretë:²¹⁹

Objekti: Caktim përfundimtar i masës së sigurimit: Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore.

Siç shikohet nga sa më sipër, lloji i masës së aplikuar nga gjykata në vendimin e parë është “arrest me burg” me afat 15 ditor, pasi organi i akuzës do të kryejë veprime hetimore si administrimi i ekspertimit autoteknik dhe mjeko ligjor për personat e dëmtuar, të cilat nuk ishin kryer akoma. Vlen të evidentojmë se personi nën hetim, ka qënë ndërkohe i shtruar në spitalin e traumës për shkak të aksidentit dhe provat tashmë ishin marrë dhe çuar për ekspertim.

Në vendimin e dytë, afati i paraburgimit është shtyrë edhe 15 ditë të tjera pasi prokuroria nuk kishte arritur të marrë ekspertimin mjeko ligjor. Ky vendim rezulton pothuajse i paargumentuar, ku gjykata shprehet: *“se ka parasysh në caktimin e masës së sigurimit, faktin që kjo vepër është e përhapur në vend, ekzistencën e rrezikut që ai të kryejë të njëjtën vepër apo vepra të tjera penale. Gjithashtu gjykata krijon bindjen se i arrestuari mund të largohet duke iu fshehur si hetimit dhe gjykimit të çështjes në ngarkim të tij.”*. Gjkata e paragjykon personin nën hetim duke prezumuar se ai *“mund të largohet”, “mund të kryejë të njëjtën vepër, apo vepra të tjera penale”,* pa pasur asnjë provë apo indicie për këtë, dhe i ngarkon personit nën hetim barrën e masës së sigurimit personal “arrest në burg” vetëm sepse *“kjo vepër është e përhapur në vend”*.

Në përfundim të afatit të dytë të paraburgimit, masa e sigurimit që jepet nga gjykata është “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”. Në këtë vendim, gjykata argumenton se: *“Në gjykim nuk rezultoi se i arrestuari të paraqesë rrezikshmëri të veçantë pasi ai është... Edhe vepra penale për të cilën dyshohet i arrestuari nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë edhe për shkak të masës së dënimit që paraqet dispozita konkrete. Nuk ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që të vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës. ... Masa e kërkuar nga organi i akuzës nuk është në raport me shkallën e nevojave të sigurimit, me rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete.”*

Në fakt, nëse ballafaqojmë të tre vendimet dhe argumentimin e tyre, vërejmë se të njëjtat kushte dhe kriteret që janë përdorur për të caktuar “detyrim paraqitje” kanë qënë ekzistente edhe kur është caktuar masa e “arrestit në burg”, por nuk janë marrë në konsideratë nga gjykata. Siç është thënë edhe më sipër në këtë studim, qëndrimi i gjykatave nuk të jep sigurinë e konsistencës dhe zbatimit korrekt të ligjit, pasi edhe kur kemi masa favorizuese ato jepen të paargumentuara, duke lënë vend për abuzim.

Në vijim të argumentimit të mësipërm, sjellim një rast tjetër të studiuar.²²⁰ Në këtë vendim, gjykata ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për zgjatjen e afatit të paraburgimit, por këtë vendim të sajin gjykata nuk e ka bazuar në kushtet dhe kriteret e mësipërme, për zgjatjen e afatit të paraburgimit, por në arsyetime të tjera si “personi dispononte sasi të vogël lënde narkotike”, “autori ka rrezikshmëri të vogël”, të cilat, në fakt, kane qënë ekzistente edhe kur është dhënë masa e parë.

²¹⁹ Vendimi Nr. 16/2 Akti, datë 04.02.2015

²²⁰ Vendimi Nr. 75/1 Akti

Shpesh është vërejtur se gjykata ka zgjatur afatet e paraburgimit ose ka caktuar masë me afat, me qëllim kryerjen e akteve të ekspertimit. Nëse ndalojmë në analizën e këtij elementi, për gjykatat mjafton ky fakt pa asnjë analizë, për të caktuar masën më të rëndë të sigurimit personal “arrest në burg”, apo për ta zgjatur afatin e saj. Nëse pritet rezultati i një akti ekspertimi, do të thotë se provat janë marrë dhe janë çuar për analizë në organin kompetent shtetëror, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të dëmtimit apo vënies në rrezik të provës. Ndërhyrja në drejtësi, nëse do të konsiderohej si element për zgjatjen e afatit do të duhej në cdo rast të evidentohej mbi bazë provash.


7.10 Informacioni me shkrim nga prokurori

Përsa i përket ekzistencës së informacionit me shkrim nga ana e prokurorit për të arrestuarin, çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, në zbatim të nenit 246/6 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se vëzhguesit junior kanë mundur të sigurojnë informacion në 1098 raste. Konkretisht, në 99.4% (1091) të rasteve ky informacion me shkrim nuk është i pranishëm në dosje, çka është tregues i mospërmbushjes së këtij detyrimi në një masë të konsiderueshme nga prokuroria. Ndërkohë që në 0.6% (7) të rasteve, informacioni me shkrim i prokurorit për të arrestuarin është i pranishëm në dosje.

7.11 Revokimi apo zëvendësimi i masës së sigurimit (Subjekti kërkues)

Në lidhje me subjektin që ka kërkuar revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit, nga analiza e 211 përgjigjeve të vëzhguesve junior rezulton se, në shumicën dërrmuese përkatësisht 80.6% (170) të rasteve, ky revokim/zëvendësim ka si subjekt kërkues të pandehurin. Në 17% (36) të rasteve, revokimi apo zëvendësimi i masës së sigurimit është kërkuar nga prokurori. Nga 31 përgjigje të monitoruesve në lidhje me llojin e masës së pasqyruar nga prokurori në kërkesën për zëvendësimin e saj rezulton se, në 23 raste është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit me një më të lehtë. Në 8 raste është kërkuar një masë më e rëndë, nga të cilat 2 prej tyre kanë qënë zëvendësim i masës së sigurimit nga “Arrest në shtëpi” në “Arrest në burg”. Gjithashtu në kërkesat e prokurorit për zëvendësimin e masës së sigurimit paraqiten edhe 5 kërkesat për vazhdimin e masës ose zgjatjen e saj, çka përbën gjithashtu zëvendësimin e masës me një masë më të rëndë. Në vetëm 2.4% (5) të rasteve të monitoruara rezulton se gjykata ka vendosur kryesisht për revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit.

Subjekti kërkues për revokimin/zëvendësimin e masës së sigurimit personal



8. Rekomandime

Me qëllim ndërmarrjen e masave që kanë si synim të përmirësojnë këto problematikat e evidentuara në këtë studim, për të rritur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, si dhe për të përafruar praktikën e institucione shqiptare me standartet ndërkombëtare dhe veçanërisht të Bashkimit Evropian, ku Shqipëria synon të integrohet, ky studim paraqet një sërë rekomandimesh të rëndësishme.

Këto rekomandime i drejtohen një sërë aktorësh dhe institucionesh të ndryshme, konkretisht, Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatave, Prokurorisë, Policisë, Shkollës së Magjistraturës, dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

8.1 Rekomandime për Kuvendin / Ministrinë e Drejtësisë

1. Rekomandohen ndryshime në legjislacion që përforcojnë parimin e mirënjohur ndërkombëtar sipas të cilit: masa e sigurimit “arrest në burg” është masë ekstreme e përjashtimore. KShH sugjeron rishikimin e dispozitave si vijon:
 - Për prokurorinë, të parashikohet në mënyrë eksplicite që kërkesa për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të arsyetohet gjerësisht nëse masat e tjera më të buta të sigurimit janë të papërshtatshme në rastin konkret, duke u mbështetur në prova dhe duke i analizuar një nga një secilën masë.
 - I njëjti parashikim propozohet në mënyrë eksplicite sidomos ndaj gjykatës. Përpara se të marrë në konsideratë masën e sigurimit “arrest në burg”, kemi mendimin se gjykata duhet të analizojë në vendimin e saj përshtatshmërinë e secilës masë sigurimi, nga më e buta tek më e ashpra, e të arsyetojë gjërësisht duke u mbështetur në prova konkrete e në rrethanat e çështjes që ka në gjykim.
 - Në rast mospërbushje të këtyre kërkesave ligjore, si nga prokuroria, ashtu edhe nga gjykata, të parashikohet pavlefshmëria e këtyre akteve, e cila duhet të konstatohet menjëherë nga një gjykatë më e lartë (në rast apelimi).
2. Në përputhje edhe me praktikën e Gjykatës së Strasburgut, rekomandohet që të parashikohet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale parimi që gjykata duhet të udhëhiqet nga prezumimi në favor të lirit të personit nga dhomat e paraburgimit, duke konsideruar më së pari çdo masë tjetër sigurimi më të butë. Në vendimin e gjykatës për caktimin e masave të sigurimit, përveç elementit të arsyetimit në mënyrë të plotë dhe duke konkretizuar zbatimin e kushteve dhe kritereve ligjore në varësi të rastit, duhet të argumentohen veçanërisht arsyet për rrëzimin e kërkesës për lirim.²²¹
3. Rekomandohen rishikimi i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ku të parashikohen kufizime konkrete përsa i përket caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” për vepra penale me kufi të ulët në maksimumin e dënimit.

²²¹ Buzadj kundër. Moldavisë, apl 23755/07, 16 dhjetor 2014, f. 3.

4. Të rishikohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, me qëllim që të parashikohet dhënia nga gjykata, e kohës së arsyeshme, ndaj avokatëve mbrojtës, për të studiuar materialet e dosjes në ambjentet të posaçme të gjykatës (duke e dokumentuar orën e dhënies së akteve në procesverbal). Në rast se gjykata vëren se mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk është efektiv, gjykata duhet të ketë të drejtë të revokojë mbrojtësin e caktuar kryesisht gjatë procesit, duke caktuar një mbrojtës tjetër.
5. Të bëhen ndryshime veçanërisht në nenet 48 dhe 49 të KPrP në lidhje me përcaktimin në mënyrë të shprehur dhe të qartë, të së drejtës për të patur avokat që në momentin e ndalimit/arrestimit nga policia, dhe të sanksionimit në mënyrë të detyruar që organi procedues nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural pa praninë e mbrojtësit (me përjashtim të rastit kur dëshiron të mbrohet vetë²²²), përndryshe çdo veprim i tillë do të jetë i pavlefshëm/papërdorshëm²²³.
6. Për të shmangur abuzimin me kohën e paraqitjes së “Letrës së të drejtave” kemi në mendimin se në përmbajtjen e kësaj letre, përveç nënshkrimit, të pasqyrohet data dhe ora e saktë e vendosjes së saj në dispozicion nga vetë personi i ndaluar/arrestuar.
7. KPrP të përcaktojë qartazi që organi procedues duhet të respektojë me korrektësi të gjitha kërkesat që rrjedhin nga ligji për kërkimin, vleftësimin dhe caktimin e masave të sigurimit, përfshirë njohjen me “Letrën e të drejtave”, duke e konsideruar të pavlefshëm çdo akt procedural të kryer pa respektuar këto procedura, e sidomos pa praninë e avokatit.
8. Rekomandohet që të bëhen ndryshime në KPrP ku në përputhje me standartet e BE-së, sipas direktivës për të drejtën për informim, të parashikohet e drejta e të ndaluarit ose të arrestuarit për të patur akses të plotë në materialet e çështjes që janë në zotërim të organeve kompetente, të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestit ose ndalimit. Kjo mund të realizohet duke parashikuar detyrimin ligjor për organin procedues, që për çdo akt procedural që krijon, të jetë i detyruar që një kopje të çdo akti t’ia japë në disponim të ndaluarit/ arrestuarit dhe avokatit të tij. Ky parashikim ligjor që përafrohet me standartet e BE-së, jo vetëm krijon një mbrojtje më efektive, por i bën palët që të gëzojnë barazi efektive të armëve juridike.
9. Pavarësisht ndryshimeve të fundit të KPrP (neni 255/1) nevojitet përsëri që të specifikohen edhe disa garancive shtesë që mundësojnë ndër të tjerash respektimin e afateve të kufizimit të lirisë. Konkretisht, duke u mbështetur edhe në Parimet e Kombeve të Bashkuara, organi procedues duhet në çdo rast të regjistrojë në mënyrën e duhur të paktën: (a) arsyet për arrestin; (b) koha me ekzaktësi e arrestit/ndalimit dhe

²²² Për ata persona që nuk kërkojnë avokat, duhet që këtë deklaram ta bëjnë vetëm me shkrim dore, mbi procesverbalin përkatës, edhe kjo me pasojë pavlefshmërie/ papërdorshmërie aktesh.

²²³ Në fakt ndryshimet e reja të KPrP, të miratuara me ligjin Nr. 35/2017, sidomos me prezantimin e “Letrës së të drejtave” e cila do t’i jepet personit që përpara marrjes në pyetje për herë të parë, përkundrejt nënshkrimit, kanë bërë një hap më përpara në garantimin e të drejtës përgjatë procesit penal, përfshirë për të pasur avokat gjatë procedurave të kryera nga organi procedues, policia apo prokuroria.

koha me ekzaktësi e çuarjes së personit të arrestuar/ndaluar në vendin e izolimit; (c) koha me ekzaktësi e paraqitjes së akteve në gjykatë; (ç) koha me ekzaktësi e fillimit të procesit gjyqësor, pra paraqitjes së parë përpara një autoriteti gjyqësor; (d) koha me ekzaktësi e marrjes së vendimit gjyqësor; (dh) identiteti i oficerit të policisë që bëri arrestimin/ndalimin; (e) identiteti i oficerëve të policisë që kanë në ngarkim ambjentet e paraburgimit në çdo turn; (ë) dhe të dhëna të sakta për vendin e paraburgimit (qelinë konkrete). Këto informacione, në çdo rast duhet t'i komunikohen personit të ndaluar dhe avokatit të tij, në formë shkresore në gjuhën që ai kupton.

10. Rekomandohet rishikimi i nenit 246/6 të KPrP, ku parashikohet që *“Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit.”*. Ky parashikim, i cili rezultoi problematik në zbatim, bie ndesh me standartet ndërkombëtare, konkretisht me Rekomandimin 13 (2006) të Këshilli i Europës, dhe jurisprudencës së konsoliduar të GjEDNJ. Sipas këtyre standarteve, shtetet nuk duhet të mjaftohen me informimin që prokuroria duhet ti bëjë gjykatës çdo dy muaj por kërkohet që të kryhet një proces gjyqësor rishqyrtimi, në mënyrë periodike, e të detyrueshme, të çdo rasti që është dhënë *“arrest në burg”*. Pra, rishikimi i paraburgimit, nënkupton një proces gjyqësor rivlerësimi i cili duhet të ndodhë në mënyrë automatike. Sipas Rekomandimit nr 13 (2006) të Këshilli i Europës *“intervali ndërmjet rishikimeve nuk duhet të kalojë më shumë se një muaj”*. Në rastet kur paraburgimi nuk rishikohet automatikisht brenda afatit të caktuar (një mujor), duhet të parashikohet që masa e sigurimit e humbet fuqinë dhe personi duhet të lirohet menjëherë. Në rastin kur i paraburgosuri kërkon rishikimin e masës, barra e provës nuk duhet të përmbyset për ta ngarkuar personin e paraburgosur me detyrimin për të provuar ekzistencën e arsyeve të lirimit, Përkundrazi, është detyrim i organit të akuzës të provojë nevojën e paraburgimit. Të njëjtat ndryshime të rekomandohen edhe për masën e sigurimit *“shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”*.
11. Referuar çështjes **“Delijorgji kundër Shqipërisë”**, neni 263 § 2 i KPP kemi mendimin se duhet të rishikohet me qëllim që të jetë më i qartë dhe i parashikueshëm në zbatimin e tij në përputhje me Konventën...” Konkluzioni i GJEDNJ-së për këtë çështje imponon ligjvënësin për të rishikuar dispozitën përkatëse me qëllimin për të shmangur paqartësitë dhe keqinterpretimet në praktikë.
12. Për mosrespektimin e afateve, procedurave dhe standarteve për ndalimin/arrestimin në flagrancë, vleftësimin e tyre, caktimin e masave të sigurimit personal dhe rishikimin/revokimin apo zgjatjen e tyre, me pasojë shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, rekomandohet që të rishikohet legjislacioni i posaçëm për statusin e gjyqtarëve (nr 96/2016) dhe ligji për policinë e shtetit (nr.108/2014, i ndryshuar), në mënyrë që të parashikohen si shkaqe të procedimit disiplinor ndaj tyre.
13. Rekomandohet rishikimi i nenit 24, paragrafi 3 i ligjit nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, me qëllim që parimi i rotacionit për avokat e caktuar kryesisht të garantohet që në fazën më të hershme të procedurës penale, duke përfshirë

këtu momentin që personi ndalohej/arrestohet dhe i kërkon organit procedues caktimin e një avokati.

14. Rekomandohet që të rishikohet mundësia nëse ka ende interes të lejohet ndjekja penale në çështje me shuma apo objekte të papërfillshëm për shoqërinë apo për individin e dëmtuar. Kjo mund të realizohet duke bërë ndërhyrje në KP, në mënyrë të tillë që të vendosen kritere apo kufinj, që të mos lejojë ndjekjen penale për shuma apo objekte me vlera të papërfillshme, duke sugjeruar, aty ky i dëmtuari ka interes, që të zgjidhjen me anë të formave alternative të zgjidhjes të mosmarrëveshjeve, si ajo e “shmangies” apo “ndërmjetësimit”.
15. Siç këshillohet nga jurisprudence e GjEDNj,²²⁴ rekomandohet rishikimi i kuadrit ligjor me qëllim që të krijohet një agjenci shtetërore përgjegjëse për të mbledhur informacion lidhur me individët e ndaluar/arrestuar në flagrancë dhe atyre ndaj të cilëve caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg”. Ky informacion duhet të përfshijë një vlerësim për riskun e personit në fjalë dhe do të vijë në ndihmë organeve të procedimit penal.

8.2 Rekomandime për Gjykatat

1. Nën frymën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të përmendura më sipër, si dhe të jurisprudence së GjEDNj, GjK dhe vendimeve unifikuese të GjL, i rekomandojmë gjykatave të jenë veçanërisht të kujdesshme në dhënien e masës së sigurimit “arrest në burg”. Masa e sigurimit “arrest në burg”, duhet të jetë një masë përjashtimore dhe jo rregull, siç rezulton nga të dhënat e këtij studimi.
2. Rekomandojmë që gjykata të jetë e kujdesshme në arsyetimin e vendimeve në lidhje me masat e sigurimit. Në këto vendime duhet të pasqyrohet në mënyrë të plotë, argumentat dhe provat e mbrojtjes. Gjykata duhet të shmangë citimet abstrakte të ligjit, dhe të kujdeset që të analizojë kushtet dhe rrethanat konkrete, duke u mbështetur në provat e administruara para saj.
3. Inkurajojmë gjykatat të aplikojnë alternativat e masave të sigurimit personal, duke mos u limituar vetëm në tre masa, të cilat sipas këtij studimi zënë shumicën dërrmuese, përkatësisht: “arrest në burg”, “arrest në shtëpi” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”²²⁵. Në përputhje edhe me standartet ndërkombëtare, inkurajojmë aplikimin e masës shtrënguese “garanci pasurore”, e cila në praktikën e vendeve me demokraci të konsoliduar përbën masën e sigurimit më të aplikuar, sidomos për veprat penale që nuk paraqesin rrezikshmëri mjaft të theksuar shoqërore (vlen të rishikohet në këtë drejtim si model i suksesshëm legjislativ dhe praktika e Anglisë).

²²⁴ *Buzadj kundër. Moldavisë*, apl 23755/07, 16 dhjetor 2014, f. 3.

²²⁵ Në rastet e rishikimit të masës “arrest në burg”, sipas jurisprudence së GjEDNj, gjykatat duhet të jenë të hapura në interes të ekzistencës së një prezumim ligjor në favor të lirit, dhe autoritet të jenë të detyruara të shqyrtojnë nëse mund të përdoren masat alternative.

4. I rekomandojmë gjykatës që në çdo proces që ka të bëjë me masat e sigurimit, të marrë masat e nevojshme procedurale që garantojnë në mënyrë efektive të drejtën e mbrojtjes së personit. Gjykata në çdo rast duhet t’iu japë kohën e nevojshme avokatëve mbrojtës për të studiuar materialet e dosjes në ambjentet të posaçme të gjykatës. Praktika e deritanishme, ku avokati i caktuar kryesisht pyetet gjatë seancës gjyqësore nëse ka nevojë për tu njohur me dosjen hetimore duhet të ndryshojë, sepse është antikushtetuese dhe cenon mbrojtjen efektive.
5. I rekomandojmë gjykatës të tregojë veçanërisht kujdes në çështjet e masave të sigurimit me të mitur. Përveç garancive të mësipërme, gjykata duhet të kujdeset që avokatët e caktuar kryesisht për të tilla raste, të jenë nga lista e avokatëve të cilët kanë kualifikime të posaçme për mbrojtjen e të miturve.
6. Në rastin e caktimit të masave të sigurimit në mungesë, i rekomandojmë gjykatës të mundësojë efektivisht lejimin e debatit gjyqësor dhe të mos i kthejë këto seanca në formale. Caktimi i masave të sigurimit në mungesë, nuk mund të bëhen kurrsesi pa praninë e avokatit, siç u vërejtën nga ky studim.
7. I rekomandojmë gjykatës gjatë rishikimit të masës, të verifikojë me shumë kujdes nëse arsyet e dhëna më parë nga organi i akuzës vazhdojnë të legjitimojnë kufizimin e lirisë. Barra e provës nuk duhet të përmbysset për ta ngarkuar personin e paraburgosur me detyrimin për të provuar ekzistencën e arsyeve të lirimit. Standarti i analizës në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të caktimit të arrestit në burg, duhet të jetë shumë më i lartë në çdo verifikim të mëpashëm.
8. Inkurajojmë që në vendimet e gjykatave për masat e sigurimit të referohen dhe të merren në konsideratë (në raport me kushtet dhe kriteret ligjore) të dhëna të ndryshme statistikore, duke i dhënë përparësi atyre zyrtare që kanë të bëjnë me gjendjen e e kriminalitetit, mbipopullimin në burgje, etj. Nga ky studim rezultoi se gjykatat, edhe kryesisht, i referohen shpesh gjëndjes së kriminalitetit për të justifikuar dhënien e “arrestit në burg”, por pa i konkretizuar me statistika zyrtare. Gjendja shqetësuese e mbipopullimit në sistemin e burgjeve si dhe efektet negative që ka ky sistem, sidomos tek të miturit dhe të rinjtë, nuk janë konsideruar asnjëherë të vetme nga gjykata.

8.3 Rekomandime për Prokurorinë

1. I rekomandojmë organit të prokurorisë të tregojë kujdes të veçantë në respektimin rigoroz të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personit të arrestuar/akuzuar, sidomos në lidhje me të drejtën për të pasur avokat, duke mundësuar efektivisht realizimin e kësaj të drejte.
2. I rekomandojmë organit të prokurorisë të mundësojë me të gjitha mekanizmat e mundshme, ushtrimin efektiv nga personi të këtyre të drejtave (të mos e shtrëngojë personin të japë deklarata, informacione, t’i krijojë mundësi efektive kontakti me avokat dhe familjen, të mos e detyrojë personin e arrestuar të nënshkruajë akte të cilat ai nuk i ka kuptuar apo me të cilat nuk është dakord, dhe veçanërisht kur këto bëhen

në mungesë të avokatit etj).

3. Prokuroria përbën një hallkë të rëndësishme për garantimin e zbatimit të kushteve dhe kritereve të KPrP në proceset që kanë të bëjnë me masat e sigurimit. Përpara se çështja të dërgohet në gjykatë, prokuroria është mekanizmi që duhet të kontrollojë ligjshmërinë e veprimeve të policisë. Duke pasur parasysh rregullin procedural që gjykata nuk mund të japë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokuroria, roli i prokurorisë në këto procese është i rëndësishëm për të ndikuar në uljen e numrit të zbatueshmërisë së masës shtrënguese “arrest me burg”.
4. Rekomandojmë gjithashtu që prokuroria të jetë më aktive në kryerjen e veprimeve procedurale përgjatë fazës së hetimeve paraprake, duke mos i lënë çdo veprim procedural vetëm policisë gjyqësore. Pasiviteti i prokurorit përgjatë hetimeve paraprake, sidomos në marrjen e provave apo hartimin e këtyre akteve procedurale, e zbeh rolin e prokurorit gjatë hetimeve paraprake, dhe ul garancitë procedurale për të pandehurin apo personin nën hetim.
5. Rekomandojmë që për çdo akt procedural të krijuar, një kopje e saj ti vihet në dispozicion të arrestuarit/ndaluarit dhe avokatit të tij, e në fund, një kopje e të gjithë dosjes hetimore e cila paraqitet për vleftësim dhe caktim mase sigurimi në gjykatë, t'i vihet në dispozicion edhe të të arrestuarit/ndaluarit dhe avokatit të tij.
6. Kemi mendimin se prokurorët duhet të mbështeten më shumë në të dhëna të ndryshme statistikore si në vendimarrjen e tyre, ashtu edhe përgjatë proceseve gjyqësore për masat e sigurimit. Ashtu si për gjykatën, i rekomandojmë prokurorisë ti referohet statistikave zyrtare për gjendjen e kriminalitetit dhe mbipopullimit në sistemin e burgjeve, çka do të kontribuonte për të bërë një vlerësim më të drejtë dhe të dobishëm të masës së sigurimit që të kërkojnë.

8.4 Rekomandime për Institucionet e Policisë së Shtetit

1. Me qëllim që policia të mos cenojë por të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, sidomos përgjatë arrestimit në flagrancë apo ndalimit me iniciativë, i rekomandojmë Akademisë së Sigurisë të kryejë trajnime të vazhdueshme profesionale me punonjësit e policisë si dhe të rishikojë kurrikulën e këtyre trajnimeve, për ta pasuruar atë me standartet më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë këtu raste nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.
2. I rekomandojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të krijojë një praktikë të konsoliduar dhe të unifikuar për të gjitha drejtoritë vendore të policisë së shteti, për të njoftuar me shkrim personin, mbi arsyet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë dhe të drejtat që i lindin personit, praktikë e cila të shpresojmë që do të përmirësohet me prezantimin e “Letrës së të drejtave”. Praktika e njohjes me këto të drejta kemi mendimin se duhet të reflektojë nënshkrimin e personit, datën dhe orën me shkrimin e vetë personit të ndaluar apo të arrestuar në flagrancë.

3. Rekomandohet që të krijohet një mekanizëm i brendshëm meritokratik, i vlerësimit dhe promovimit të punonjësve të policisë që garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve të ndaluar apo arrestuar në flagrancë. KShH vëren se nevojitet intensifikimi i inspektimeve periodike nga strukturat hierarkike të Policisë së Shtetit, në komisaritet dhe dhomat e sigurisë së policisë së shtetit, për të verifikuar respektimin ose jo të këtyre standarteve. Ndaj punonjësve që i shkelin ato duhet të merren masa me natyrë disiplinore.

8.5 Rekomandime për strukturat e Avokatisë/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

1. I rekomandojmë Komitetit Drejtues të Dhomës së Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas që në përputhje me detyrat e parashikuara në nenet 9 dhe 24 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të mundësojë përfshirjen në listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, ata avokatë që i përmbushin kriteret e meritës profesionale dhe që garantojnë një mbrojtje efektive. Në bashkëpunim me organin procedures, i rekomandojmë Komitetit Drejtues të Dhomës së Avokatisë të mundësojë rotacionin e avokatëve që caktohen kryesisht për masat e sigurimit personal.
2. I rekomandojmë Shkollës së Avokatisë, Komitetit Drejtues të Dhomës së Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike, që në përputhje me nenin 9, pika 1, gërma “d” të ligjit nr.111/2017 dhe nenin 55/1 të ligjit nr.55/2018, të organizojë programe trajnimi të vazhdueshme për avokatët e listës së avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sa i takon tematikave lidhur me të drejtat dhe liritë e personave të ndaluar/arrestuar, problematikat në gjykimin e masave të sigurimit, jurisprudencën e GJEDNJ për nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane. Këto programe duhet të realizohen në mënyrë periodike si dhe të azhurnohen me standartet më të mira.
3. Bazuar në nenin 25, pika 4, gërma “a” të ligjit nr.55/2018 “Për profesionin e avokatit në RSH”, i rekomandojmë Dhomës së Avokatisë të krijojë një strukturë për mbikëqyrjen në mënyrë periodike të cilësisë së shërbimit për avokatët e caktuar kryesisht.
4. I rekomandojmë Komisionerit të Ankimeve të hetojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm çdo ankesë disiplinore ndaj avokatit, të paraqitur nga subjektet e parashikuara në nenin 40, pika 2 të ligjit nr.55/2018. Në raport me natyrën dhe rëndësinë e shkeljes së provuar që i atribuohet avokatit, i rekomandojmë Komitetit Disiplinor të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë të marrë masën/at disiplinore në përputhje me parashikimet e neneve 45 dhe 46 të ligjit nr.55/2018.

8.6 Rekomandime për Shkollën e Magjistraturës

Meqënëse nga ky studim rezultoi se janë konstatuar problematika lidhur me vleftësimin e ndalimit/arrestit në flagrancë, caktimin e masave të sigurimit dhe mbipërdorimin e “arrestit në burg” si dhe seancat e tjera gjyqësore që kanë për objekt rishikimin, revokimin dhe zëvendësimin e masave të sigurimit, KShH i rekomandon Shkollës së Magjistraturës të organizojë trajnime vazhduese me gjyqtarë dhe prokurorë:

1. Në drejtim të njohjes me konventat dhe standartet ndërkombëtare lidhur me të drejtën për liri dhe siguri si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, sa i takon zbatimit të nenit 5 dhe 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të njeriut.
2. Në drejtim të njohjes në nivel të avancuar me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vendimet unifikuese dhe të kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si dhe legjislacionit proceduralo-penal, si psh kërkesat e ligjit për gjendjen e flagrancës, ndalimit, kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, zbatimin e saktë të kushteve të nenit 230 të KPrP lidhur me masën “arrest në burg” (me synim që të shmangët kërkimi i kësaj mase, përveç rasteve kur është absolutisht e domosdoshme), etj
3. Zbatimin e masave të sigurimit për kategori të caktuara në nevojë si gratë, fëmijët, përfaqësues të grupeve të marxhinalizuara si minoriteti Rom, Egjyptian, të huajt, etj. Prokuroria në kërkimet e saj dhe gjykata në vendimmarrje duhet të jetë e kujdeshme dhe të shmangë çdo paragjykim apo formë diskriminimi, në caktimin e masave të sigurimit ndaj këtyre grupeve, e veçanërisht ndaj fëmijëve, duke evituar sa më shumë zbatimin e masave që kufizojnë së tepërmi lirinë e personit.
4. Zbatimin dhe respektimin me rigorozitet të parimit të “dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova”. Kemi mendimin se gjykata duhet të ndryshojë praktikën e saj për caktimin e masave të sigurimit personal, në mungesë të provave që krijojnë dyshimin e arsyeshëm, siç ka ndodhur rëndom në rastet e veprës penale të vjedhjes apo dhunës në familje. Gjykata duhet të mundësojë respektimin rigoroz të çmuarjes së provave në kuptim të nenit 152 të KPrP dhe zbatimin e drejtë të pasojave për shkak të (pa)vlefshmërisë, (pa)përdorshmërisë së provave dhe në aspekte të përgjithshme të ligjshmërisë së provës, në kuptim të KPrP.
5. Rekomandojmë që prokurorët të trajnohen për teknikën e shkrimit të akteve që përgatisin ndërkohë që për gjyqtarët rekomandohen trajnime të specializuara për mënyrën e shkrimit dhe hartimit të vendimeve gjyqësore për masat e sigurimit.

Aneksi I

Situata e Mbipopullimit të personave me masë sigurie “Arrest në Burg” në I EVP Vaqarr, Mine Peza, Jordan Misja dhe Durrës për periudhën 2015-2016

Në përmbushje të misionit të tij, Komiteti Shqiptar i Helsinkit iu drejtua me kërkesë për informacion drejtuesve të I EVP-së Vaqarr (Seksionit të paraburgimit) dhe I EVP-ve Mine Peza, Jordan Misja dhe Durrës. Kërkesa për informacion konsistonte në evidentimin e të dhënave të sakta përsa i përket numrit të personave të paraburgosur dhe kapaciteteve akomoduese në këto I EVP gjatë periudhës 2015-2016.

Lidhur me numrin e personave të paraburgosur, ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg” respektivisht dhe në mënyrë të ndarë për vitet 2015-2016 rezulton se:

a) Kapacitetet akomoduese dhe situata e mbipopullimit në këto I EVP për periudhën 2015-2016

Në I EVP Vaqarr (Seksioni i paraburgimit) numri i të paraburgosurve ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg” për vitin 2015 është 554, ndërsa për vitin 2016 numri i të paraburgosurve është 361. Përsa i përket kapacitetit akomodues në këtë institucion mund të vendosen 140 persona. Siç vihet re edhe nga të dhënat pavarësisht se numri i të paraburgosurve gjatë periudhës 2015-2016 ka qenë i ndryshëm, ka pasur mbipopullim. Më i theksuar ky fenomen ka qenë në periudhën Prill-Korrik 2015, ku niveli i mbipopullimit ka arritur në masën 27%.

Në I EVP Mine Peza numri i personave të paraburgosur ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg” për vitin 2015 është 562, ndërsa për vitin 2016 është 341 të paraburgosur. Referuar vitit 2015 rezulton se në muajin Shkurt numri i hyrjeve ka qenë më i lartë (respektivisht 271), ndërsa në muajin Dhjetor ka pasur më pak hyrje (respektivisht 5). Lidhur me kapacitetin akomodues në këtë institucion mund të vendosen vetëm 166 persona. Gjatë periudhës në fjalë, 2015-2016 ka pasur mbipopullim dhe pamjaftueshmëri ambientesh për vendosjen e të paraburgosurve. Ky fenomen ka qenë më i theksuar në muajin Shkurt 2015 ku në këtë institucion janë akomoduar 271 persona dhe mbipopullimi ka arritur deri në 157%, pra 105 persona mbi kapacitetin akomodues të kësaj I EVP. Kjo ka ndodhur për shkak se ka pasur hyrje të reja dhe të transferuar nga I EVP Jordan Misja, si rezultat i rikonstruksionit të këtij të fundit. Për vitin 2016 rezulton se numri i hyrjeve ka qenë më i madh në muajin Maj dhe Shtator (respektivisht 50 hyrje) dhe më i vogël në Qershor (11 hyrje). Gjatë këtij viti nga të dhënat e paraqitura për muajin Shkurt dhe Maj rezulton se në këtë I EVP janë akomoduar 219 persona, pra 53 persona mbi kapacitetin e lejuar që ka sjellë një nivel mbipopullimi 131%.

Në I EVP Jordan Misja për numrin e personave të paraburgosur me masë sigurimi “Arrest në burg” paraqiten të dhëna vetëm për muajin Janar, Nëntor, Dhjetor të vitit 2015 nga të cilat rezulton se janë akomoduar në këtë institucion 1361 persona të paraburgosur, ndërsa për pjesën tjetër të vitit nuk evidentohen të dhëna për shkak se I EVP Jordan Misja ka qenë

i transferuar pranë IEVP Fier. Ndërsa për vitin 2016 rezultojnë 3811 të paraburgosur me masë sigurimi "Arrest në burg", të vendosur pranë këtij institucioni. Lidhur me fenomenin e mbipopullimit, nga ana e drejtuesve paraqitet një gjendje joproblematike për periudhën Janar, Nëntor, Dhjetor 2015 – viti 2016 por nga një llogaritje e kapacitetit akomodues dhe personave të vendosur në këtë IEVP evidentohet se ky fenomen ka qënë ekzistues dhe të dhënat e paraqitura për periudhën në fjalë përbëjnë një shifër tepër të lartë në kushtet e kapacitetit të këtij insitucioni.

Në IEVP Durrës numri i të paraburgosurve ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit personal "Arrest në burg" për vitin 2015 është 609, ndërsa për vitin 2016 është 630 të paraburgosur. Nga të dhënat e IEVP Durrës evidentohet se gjendja e kapacitetit akomodues të këtij institucioni paraqet një mbipopullim të lehtë.

b) Rrezikshmëria e veprave penale për të cilat janë dhënë masat e sigurimit ndaj personave të akomoduar në këto institucione

Në IEVP Vaqarr (Seksioni i paraburgimit) veprat penale për të cilat të paraburgosurit kanë marrë masë sigurimi "Arrest në burg" janë të ndryshme. Rreth 90% të rasteve e zënë personat e paraburgosur të akuzuar për vepra penale si: "Vjedhje", "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", "Dhuna në familje", "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt", "Mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe municionit". Ndërsa rreth 10% të rasteve paraqiten vepra penale të tjera të paeventuara. Në këtë institucion rezulton se sipas rasteve të eventuara, në 60% të tyre është vendosur masa e sigurimit "Arrest në burg" për vepra penale të një rrezikshmërie të ulët shoqërore për të cilat nga ligjvënësi është parashikuar marzhi dënimit minimal me 10 ditë burg ndërsa në maksimum 3 vite burgim. Ndërkohë në 40% të rasteve rezulton të jetë dhënë kjo masë sigurimi për vepra penale me një rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Në IEVP Mine Peza veprat penale për të cilat është dhënë masa e sigurimit personal "Arrest në burg" për të paraburgosurit të vendosur në këtë IEVP për vitet 2015-2016 janë: "Vjedhja e energjisë elektrike", "Vjedhje me dhunë dhe armë", "Vjedhje", "Vjedhje e bankave dhe arkës së kursimit", "Vrasje me dashje", "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", "Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje", "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike", "Trafikim të lëndëve narkotike", "Kultivim të lëndëve narkotike", "Mashttrim", "Armëmbajtje pa leje", "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur", "Ndërtim pa leje", "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", "Ngacmim seksual", "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personave", "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë", "Plagosje e lehtë", "Plagosje e rëndë", "Trafikim i personave të rritur", "Shfrytëzim prostitucioni", "Moskallëzim krimi", "Trafikimi i të miturve", "Dhunë në familje", "Krim ekonomik", "Largim i të burgosurve nga vendqëndrimi", "Organizata kriminale", "Vepra me qëllime terroriste", "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufinjve", "Shkatërrim i pronës", "Përndjekja". Në këtë institucion rezulton se në 90% të rasteve është dhënë masa e sigurimit personal "Arrest në burg" për vepra penale me një rrezikshmëri të lartë shoqërore me një marzh dënimi maksimal deri në 20 vite burgim ose burgim të përjetshëm, ndërsa 10% e rasteve i përkasin veprave penale të një rrezikshmërie të ulët shoqërore.

Në IEVP Jordan Misja për vitin 2015 (periudha Janar, Nëntor, Dhjetor) janë dhënë masa "Arrest në burg" për këto vepra penale: "Trafikim i narkotikëve" (216 raste); "Vrasje e punonjësve të policisë" (50 raste); "Trafikim i të miturve, rriturve, Prostitucion" (53 raste); "Prodhim dhe trafikim i lëndëve plasëse dhe armëve luftarake" (93 raste); "Falsifikim, Korrupsion, Mashtrim dhe Shpërdorim detyrë" (56 raste); "Shtrëngim me anë të kanosjes, dhunës, Heqje e paligjshme e lirisë" (88 raste); "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" (170 raste); "Vrasje" (84 raste); "Ngacmim seksual" (13 raste); "Dhunë në familje" (61 raste); "Vjedhje" (192 raste); "Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit" (3 raste); "Kultivim i bimëve narkotike" (27 raste); "Kundësthitim, Goditje e punonjësve të policisë" (5 raste); "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale" (17 raste); "Vepra të turpshme" (3 raste)", "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt" (13 raste); "Përndjekje" (10 raste); "Plagosje" (2 raste); "Vepra të tjera" (5 raste). Ndërsa për vitin 2016 veprat penale për të cilat është dhënë masa e sigurimit "Arrest në burg" janë: "Trafikim i narkotikëve" (714 raste); "Vrasje e punonjësve të policisë" (79 raste); "Trafikim i të miturve, rriturve, Prostitucion" (92 raste); "Prodhim dhe trafikim i lëndëve plasëse dhe armëve luftarake" (160 raste); Falsifikim, Korrupsion, Mashtrim dhe Shpërdorim detyrë" (289 raste); Shtrëngim me anë të kanosjes, dhunës, Heqje e paligjshme e lirisë" (97 raste); "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike" (704 raste); "Vrasje" (190 raste); "Ngacmim seksual" (104 raste); "Dhunë në familje" (286 raste); "Vjedhje" (613 raste); "Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit" (148 raste); "Kultivim i bimëve narkotike" (75 raste); "Kundësthitim, Goditje e punonjësve të policisë" (39 raste); "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale" (44 raste); "Vepra të turpshme" (20 raste)", "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt" (66 raste); "Përndjekje" (30 raste); "Plagosje" (20 raste); "Vepra të tjera" (23 raste). Në 85 % të rasteve të evidentuara në këtë institucion rezulton se veprat penale për të cilat është dhënë masë sigurimi personal "Arrest në burg" janë të një rrezikshmërie të lartë shoqërore me një marzh dënimi maksimal deri në 20 vite burgim ose burgim të përjetshëm, ndërsa 15% e rasteve i përkasin veprave penale me një rrezikshmëri të ulët shoqërore referuar marzhit të dënimit respektiv të parashikuar nga ligji. Në IEVP Durrës veprat penale për të cilat është dhënë masa e sigurimit "Arrest në burg" janë kryesisht vepra penale "Vjedhje"; "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike". Kategoria e veprave penale për të cilat është dhënë masa e sigurimit personal "Arrest në burg" në këtë institucion përkon me një marzh dënimi minimumi dënim me gjobë dhe maksimumi i dënimit burgim deri në 10 vite.

c) Koha mesatare e qëndrimit të personave me masë sigurie "Arrest në Burg" në këto IEVP

Në IEVP Vaqarr (Seksioni i paraburgimit) koha mesatare e qëndrimit të paraburgosurve është 6 muaj.

Në IEVP Mine Peza koha mesatare e qëndrimit të paraburgosurve është 5 muaj (gjithashtu paraqiten të dhëna se ekzistojnë të paraburgosur që kanë qëndruar në këtë IEVP mbi 365 ditë).

Në IEVP Jordan Misja për periudhën 3 mujore Janar, Nëntor, Dhjetor 2015 koha mesatare e qëndrimit është 3 muaj, ndërsa për vitin 2016 koha mesatare e qëndrimit të të paraburgosurve është 1 vit e 3 muaj, mesatare kjo e lartë e cila ndikon në mbipopullimin e institucionit.

Në IEVP Durrës koha mesatare e qëndrimit në paraburgim është nga 6 muaj deri në 1 vit e 6 muaj.

d) Gjykatat të cilat kanë dhënë vendimet për caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg"

Në IEVP Vaqarr (Seksioni i paraburgimit) vendimet për caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg" janë dhënë nga: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (892 masa sigurimi); Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (13 masa sigurimi); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (3 masa sigurimi); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë (2 masa sigurimi); Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Kukës dhe Dibër (nga 1 masë sigurimi) dhe Gjykata e Apelit Tiranë (2 masa sigurimi).

Në IEVP Mine Peza për kategoritë e të paraburgosurve janë dhënë vendime për caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg" nga këto gjykata: Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini.

Në IEVP Jordan Misja për periudhën Janar, Nëntor, Dhjetor 2015 gjykatat të cilat kanë dhënë vendime për caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg" janë: Gjykata e Apelit Tiranë (6 masa sigurimi); Gjykata e Vlorës (50 masa sigurimi); Gjykata e Fierit (40 masa sigurimi); Gjykata e Krujës (6 masa sigurimi); Gjykata e Sarandës (4 masa sigurimi); Gjykata e Gjirokastrës (5 masa sigurimi); Gjykata e Shkodrës (13 masa sigurimi); Gjykata e Tiranës (844 masa sigurimi) dhe Gjykata e Krimeve të Rënda (398 masa sigurimi). Ndërsa për vitin 2016 vendimet për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" janë dhënë nga këto gjykata: Gjykata e Apelit Tiranë (31 masa sigurimi); Gjykata e Shkodrës (7 masa sigurimi); Gjykata e Krujës (7 masa sigurimi); Gjykata e Rrëzimit (2 masa sigurimi); Gjykata e Kurbinit (3 masa sigurimi); Gjykata e Përmetit (8 masa sigurimi); Gjykata e Lezhës (3 masa sigurimi); Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë (1459 masa sigurimi) dhe Gjykata e Tiranës (2291 masa sigurimi).

Në IEVP Durrës gjykatat që kanë dhënë vendimet për caktimin e masës së sigurimit "Arrest në burg" për kategorinë e të paraburgosurve janë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe për një pjesë të vogël të këtyre personave vendimet janë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Aneksi II

Neni 5 KEDNJ në vështrim të Jurisprudencës së GJEDNJ-së deri në fund të vitit 2016

(nga faqja zyrtare e GJEDNJ)

1. Qëllimi i arrestimit dhe paraburgimit

63. Pjesa e fjalisë “me qëllim që të dërgohet para autoritetit gjyqësor kompetent” i referohet tre hipotezave alternative të arrestimit ose të paraburgimit që synon neni 5 § 1 c) (Lavvess kundër Irlandës (nr. 3), §§ 13-14; Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 196).

64. Një person nuk mund të paraburgoset në lidhje me nenin 5 § 1 c) veçse në kuadrin e një procedure penale, me qëllim që ai të dërgohet para autoritetit gjyqësor kompetent sepse dyshohet se ai ka kryer një shkelje (Ječius kundër Lituanisë, § 50; Schvabe dhe M.G. kundër Gjermanisë, § 72).

65. Përveç kësaj, rasti i dytë i kësaj dispozite (“motive/arsye të arsyeshme për të besuar në domosdoshmërinë e parandalimit të kryerjes së një shkeljeje”) ka për qëllim vetëm paraburgimin e përkohshëm dhe jo paraburgimin me efekte parandaluese, kur personi në fjalë nuk dyshohet se ka kryer një shkelje (Ostendorf kundër Gjermanisë, § 82).

66. Ekzistenca e një qëllimi të tillë duhet të konsiderohet paravarësisht realizimit të tij. Paragrafi c) i nenit 5 § 1 nuk supozon që policia të ketë mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur akuza, qoftë në momentin e arrestimit, qoftë gjatë paraburgimit (Petkov dhe Profirov kundër Bullgarisë, § 52; Erdagöz kundër Turqisë, § 51). Marrja në pyetje gjatë paraburgimit në kuptim të paragrafit c) të nenit 5 & 1 ka për synim të plotësojë hetimin penal, duke konfirmuar ose duke mënjanuar dyshimet konkrete mbi të cilat është bazuar arrestimi (Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, §§ 52-54; Labita kundër Italisë [GC], § 155; O’Hara kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 36).

67. Lidhur me nenin 5 § 1 c), paraburgimi duhet të jetë një masë në përpjestim me objektivin e deklaruar (Ladent kundër Polonisë, §§ 55-56).

68. Shprehja “autoritet gjyqësor kompetent” ka të njëjtin kuptim me shprehjen “një gjykatës ose një magjistrat i autorizuar me ligj në ushtrimin e funksioneve gjyqësore”, shprehje kjo e përdorur në nenin 5 § 3 (Schiesser kundër Zvicrës, § 29).

2. Domethënia e shprehjes “arsye të besueshme për të dyshuar”

69. Ekzistenca e “arsyeve të besueshme për të dyshuar” se është kryer një vepër penale presupozon ekzistencën e fakteve ose informacioneve që janë të afta të bindin një vëzhgues objektiv se individ i në fjalë mund të ketë kryer një vepër penale (Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit, § 88; Erdagöz kundër Turqisë, § 51; Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 32). Për pasojë, dështimi i autoriteteve për të kryer një hetim të vërtetë mbi faktet kryesore të një çështjeje me qëllim verifikimin e

themelit të një ankese analizohet në shkelje të nenit 5 § 1 c) (Stepuleac kundër Moldavisë, § 73; Elçi dhe të tjerë kundër Turqisë, § 674).

70. Ajo që mund të konsiderohet si “e besueshme” varet, megjithatë, nga tërësia e rrethanave të çështjes (Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 32).

71. Përderisa, në fushën e terrorizmit, nuk mund t’i kërkohej shteteve kontraktuese që ata të vendosin mbi besueshmërinë e dyshimeve që justifikojnë arrestimin e një terroristi të prezumuar/të dyshuar nëpërmjet shpërndarjes së burimeve konfidenciale të informacioneve, Gjykata gjykon se domosdoshmëria për të luftuar krimin terrorist mund të justifikohet vetëm duke zgjeruar nocionin e “besueshmërisë” deri në pikën sa të mos cenohet thelbi i garancisë që sigurohet nga neni 5 § 1 c) (O’Hara kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 35).

72. Gjykata gjykon se dëshmitë jo të drejtpërdrejta dhe të pakonfirmuara që vijnë nga informatorë anonimë nuk mund të konsiderohen se janë një bazë e mjaftueshme për të vendosur mbi ekzistencën e “arsyeve të besueshme për të dyshuar” se kërkuesi kishte qenë i përfshirë në aktivitetet mafioze (Labita kundër Italisë [GC], §§ 156 dhe të mëposhtëm). Nga ana tjetër, ajo vlerëson se deklaratat inkriminuese që datojnë prej shumë vitesh, të cilat të dyshuarit i kanë mohuar më vonë, nuk vënë në dyshim ekzistencën e arsyeve të besueshme për të dyshuar se kërkuesi ka kryer një vepër penale dhe se ato nuk kanë efekt mbi ligjshmërinë e mandat-arrestit (Talat Tepe kundër Turqisë, § 61).

IV. GARANCITË PËR PERSONAT E PRIVUAR NGA LIRIA

A. Komunikimi i arsyeve të arrestimit (neni 5 § 2)

Neni 5 § 2 : « 2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë të kuptueshme për të, lidhur me arsyet e arrestimit të tij dhe me çdo akuzë të ngritur kundrejt tij. »

1. Zbatueshmëria

113. Termat e përdorura në nenin 5 § 2 duhet të kenë një interpretim autonom, veçanërisht në përputhje me objektin dhe qëllimin e nenit 5: mbrojtjen e çdo personi nga privimet arbitrare të lirisë. Termi «arrestim» e tejkalon kuadrin e masave me karakter penal dhe shprehja «çdo akuzë» (« any charge ») nuk nënkupton formulimin e një kushti për zbatueshmërinë e tij, por caktimin e një rrethane që ai merr parasysh. Neni 5 § 4 nuk bën asnjë dallim ndërmjet personave të privuar nga liria e tyre nëpërmjet arrestimit dhe të atyre që janë të tillë nëpërmjet paraburgimit. Prandaj, nuk ka asnjë arsye për t’i përjashtuar këta të fundit nga përfitimet e nenit 5 § 2 (Van der Leer kundër Vendeve të Ulëta, §§ 27-28), gjë që vlen gjithashtu edhe për paraburgimin në pritje të ekstradimit (Chamaïev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Rusisë, §§ 414-415), ose për trajtime mjekësore (Van der Leer kundër Vendeve të Ulëta, §§ 27-28; X. kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 66), si dhe për personat që kthehen në burg pas lirimit të tyre me kusht (ibidem; X kundër Belgjikës, vendim i Komisionit).

2. Qëllimi

114. I integruar në sistemin e mbrojtjes që ofron neni 5, paragrafi 2 i kësaj dispozite përcakton një garanci bazë: çdo person i arrestuar duhet të njohë përse-në e arrestimit. Sapo një person informohet mbi arsyet e arrestimit apo paraburgimit të tij, ai duhet të jetë gjendje, nëse ai e vlerëson të domosdoshme, të diskutojë ligjshmërinë e arrestimit apo paraburgimit të tij përpara një gjykate, në përputhje me nenin 5 § 4 (Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 40; Çonka kundër Belgjikës, § 50).

115. Cilido, i cili ka të drejtë të paraqesë një rekurs me qëllim marrjen e një vendimi të shpejtë mbi ligjshmërinë e paraburgimit të tij, nuk mund të përfitojë prej kësaj në mënyrë efektive nëse atij nuk i janë hequr, brenda një afati sa më të shkurtër dhe brenda një periudhe të mjaftueshme, arsyet për të cilat atij i është privuar liria (Van der Leer kundër Vendeve të Ulëta § 28; Chamaïev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Rusisë, § 413).

3. Personat të cilëve duhet t'u komunikohen arsyet

116. Nga formulimi i nenit 5 § 2 del qartë se shteteve u kërkohet që t'i japin të interesuarit ose përfaqësuesit të tij informacione specifike (Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], §§ 53, konfirmuar nga Dhoma e Madhe në vitin 2008). Nëse kërkuesi nuk është në gjendje të marrë informacionet përkatëse, këto informacione duhet t'i komunikohen në terma të përgjithshme personit që e përfaqëson atë, për shembull avokatit ose kujdestarit të tij (X kundër Mbretërisë së Bashkuar, raport i Komisionit, § 106 ; Z.H. kundër Hungarisë, §§ 42-43).

4. Arsyet duhet të komunikohen «brenda një afati sa më të shkurtër »

117. Për të përcaktuar nëse këto informacione janë komunikuar mjaftueshëm herët në kohë, duhet të mbajmë parasysh veçantitë e rastit. Megjithatë, oficeri i policisë që procedon me arrestimin mund të mos japë në tërësi arsyet gjatë momentit të arrestimit (Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 40; Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 72).

118. Kufizimet kohore që vendosen nga kërkesa që lidhet me shpejtësinë do të përmbushen nëse personi i arrestuar informohet mbi arsyet e arrestimit të tij brenda një afati prej disa orësh (Kerr kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim); Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 42).

5. Mënyrat e komunikimit të arsyeve

119. Arsyet nuk duhet të ekspozohen në tekstin e ndonjë autorizimi që autorizon paraburgimin dhe ato nuk duhet të jepen me shkrim, as të paraqiten në një formë specifike (X. kundër Gjermanisë, vendim i Komisionit, 13 dhjetor 1978; Kane kundër Qipros (vendim)).

Megjithatë, nëse situata e një personi me aftësi mendore të kufizuara nuk është marrë parasysh gjatë këtij procesi, kjo situatë nuk mund të kalojë pa u marrë informacionet e nevojshme me qëllim bërjen efektive dhe inteligjente të së drejtës, garantuar nga neni 5 § 4, për të kundërshtuar ligjshmërinë e një paraburgimi, vetëm nëse një avokat ose një person tjetër i autorizuar është njoftuar në vend të tij (Z.H. kundër Hungarisë, § 41).

120. Arsyet e arrestimit mund të jepen ose mund të bëhen të dukshme në kontekstin e marrjeve në pyetje ose të pyetjeve që bëhen pas arrestimit (Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 41; Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 77; Kerr kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim).

121. Një person i arrestuar nuk mund të pretendojë se nuk i kupton arsyet e arrestimit të tij në rastin kur ai është kapur menjëherë pas kryerjes së një akti me natyrë kriminale dhe të qëllimshëm (Dikme kundër Turqisë, § 54) ose kur, në rastin e mandateve të arrestimit dhe të kërkesave të mëparshme për ekstradim, personi në fjalë është informuar në detaje për faktet kriminale që pretendohen ndaj tij (Öcalan kundër Turqisë (vendim).

6. Mjaftueshmëria e arsyeve që do të komunikohen

122. Për të përcaktuar nëse kërkuesi ka marrë informacione të mjaftueshme, duhen mbajtur parasysh karakteristikat e veçantisë së rastit në fjalë (Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 40). Megjithatë, treguesi i vetëm i bazës juridike të arrestimit nuk është i mjaftueshëm për qëllimet e nenit 5 § 2 (ibidem, § 41; Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 76; Kortesis kundër Greqisë, §§ 61-62).

123. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi arsyet juridike dhe faktike të privimit të lirisë së tij, me qëllim që ai të ketë mundësi të diskutojë ligjshmërinë e këtij privimi përpara një gjykate, në përputhje me nenin 5 § 4 (Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 40; Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 72). Megjithatë, neni 5 § 2 nuk kërkon që këto informacione të përbëjnë një listë të plotë të akuzave kundër personit të arrestuar (Bordovskiy kundër Ruisë, § 56; Novvak kundër Ukrainës, § 63; Gasiņš kundër Letonisë, § 53).

124. Për personat e arrestuar me qëllim ekstradimin e tyre, informacionet që do të jepen mund të mos jenë aq të plota, (Suso Musa kundër Maltës, §§ 113 dhe 116; Kaboulov kundër Ukrainës, § 144; Bordovskiy kundër Ruisë, § 56), pasi arrestimi për një qëllim të tillë nuk kërkon asnjë vendim lidhur me themelin e akuzës (Bejaoui kundër Greqisë, vendim i Komisionit). Megjithatë, këta persona duhet të marrin informacionet e mjaftueshme që do t'i bëjnë të mundur atyre të ushtrojnë rekursin e kontrollit të ligjshmërisë, parashikuar nga neni 5 § 4 (Chamaïev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Ruisë, § 427).

7. Në një gjuhë të kuptueshme

125. Kur mandat-arresti, nëse ka një të tillë, është shkruar në një gjuhë të cilën personi i arrestuar nuk e kupton, do të respektohet neni 5 § 2 nëse kërkuesi është marrë në pyetje më

pas, duke e informuar në këtë mënyrë mbi arsyet e arrestimit të tij në një gjuhë të cilën ai e kupton (Delcourt kundër Belgjikës, vendim i Komisionit).

126. Megjithatë, në rastin kur për këtë qëllim nevojiten përkthyes, i takon autoriteteve të sigurojnë që kërkesat për përkthim të formulohen me kujdes dhe në mënyrë të saktë (Chamaïev dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë dhe Rusisë, § 425).

B. E drejta për t'u paraqitur menjëherë përpara një magjistrati (neni 5 § 3)

Neni 5 § 3: «3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur, në kushtet e parashikuara në paragrafin 1 c) të këtij neni, duhet të paraqitet menjëherë përpara një gjykatësi ose një magjistrati tjetër, të cilin ligji e njeh për ushtrimin e funksioneve gjyqësore (...) »

1. Qëllimi i dispozitës

127. Neni 5 § 3 u jep personave të arrestuar ose në paraburgim, të cilët dyshohen për kryerjen e një vepre penale, garanci kundrejt çdo lloj privimi arbitrar ose të pajustificuar të lirisë (Aquilina kundër Maltës [GC], § 47; Stephens kundër Maltës (nr.2), § 52).

128. Kontrolli gjyqësor i ndërhyrjeve të ekzekutivit në të drejtën individuale të lirisë përbën një element thelbësor të garancisë që jep neni 5 § 3 (Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 58; Pantea kundër Rumanisë, § 236); Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, § 146). Është e kuptueshme se kjo gjë shkon krahas me përparësinë e të drejtës, si një nga “parimet themelore” të një “shoqërie demokratike”, së cilës “i referohet shprehimisht preambula e Konventës” dhe ndaj së cilës Konventa frymëzohet plotësisht” (Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 58).

129. Një kontroll i tillë duhet të japë garanci efektive kundrejt rrezikut të keqtrajttimeve, ç’ka përbën maksimumin e vet gjatë kësaj faze fillestare të paraburgimit dhe kundër një abuzimi të oficerëve të zbatimit të ligjit ose një autoriteti tjetër që i është dhënë pushtet, të cilët duhet të ushtrohen për qëllime të kufizuara dhe në përputhje të plotë me procedurat e kërkuara (Ladent kundër Polonisë, § 72).

2. Kontrolli gjyqësor i shpejtë dhe automatik

130. Dispozita e parë e nenit 5 § 3 ka për qëllim sigurimin e një kontrolli gjyqësor të shpejtë dhe automatik në rastin e një paraburgimi të urdhëruar nga policia ose nga administrata në kushtet e paragrafit 1 c) (De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Vendeve të Ulëta, § 51; Aquilina kundër Maltës [GC], §§ 48-49).

131. Kontrolli gjyqësor gjatë paraqitjes së parë të personit të arrestuar duhet, para së gjithash, të jetë i shpejtë sepse ai duhet të bëjë të mundur zbulimin e ndonjë keqtrajtimi ose të minimizojë çdo cenim të pajustificuar të lirisë individuale. Afati i ngushtë kohor që imponohet nga kjo kërkesë nuk lë aspak vend për fleksibilitet në interpretim, përndryshe kjo gjë do të deformonte garancinë procedurale që ofrohet nga ky nen, në kurriz të individit,

dhe do të rezultonim në pasoja që do të ishin në kundërshtim ndaj vetë thelbit të së drejtës së mbrotjur prej tij (McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 33).

132. Neni 5 § 3 nuk parashikon asnjë përjashtim të mundshëm ndaj detyrimit për të sjellë menjëherë një person para një gjykatësi ose një magjistrati tjetër pas arrestimit ose parandalimit të tij, madje as me arsyen se gjykatësi mund të ketë ndërhyrë paraprakisht. (Bergmann kundër Estonisë, § 45).

133. Çdo vonesë prej më shumë se katër ditësh është absolutisht shumë e gjatë (Oral dhe Atabay kundër Turqisë, § 43; McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 47; Năstase-Silivestru kundër Rumanisë, § 32). Një afat më i shkurtër mund të shkelë gjithashtu edhe kërkesën për shpejtësi, në rastin kur nuk ka asnjë vështirësi të veçantë ose rrethanë të jashtëzakonshme që të pengojë autoritetet për të sjellë menjëherë personin e arrestuar para gjykatësit (Gutsanovi kundër Bullgarisë, §§ 154-159; İpek dhe të tjerë kundër Turqisë, §§ 36-37, dhe Kandzhov kundër Bullgarisë, § 66).

Detyrimi i shpejtësisë është edhe më i madh në rastin kur vendosja në paraburgim pason një periudhë të privimit real të lirisë (Vassis dhe të tjerë kundër Francës, § 60, lidhur me ndalimin e një ekuipazhi në det të hapur).

134. Fakti se personi i arrestuar ka patur akses tek një instancë gjyqësore nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur pjesën e parë të nenit 5 § 3 (De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Vendeve të Ulëta, § 51; Pantea kundër Rumanisë, § 231).

135. Kontrolli duhet të jetë automatik dhe nuk mund të jetë i ndërruar nga kërkesa që mund të bëjë personi i ndaluar (McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 34; Varga kundër Rumanisë, § 52; Viorel Burzo kundër Rumanisë, § 107). Një kërkesë e tillë do të ndryshonte natyrën e garancisë së parashikuar nga neni 5 § 3, që është e dallueshme nga ajo që parashikohet nga neni 5 § 4, sipas të cilit personi i ndaluar ka të drejtë të nxisë një gjykatë për të shqyrtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij. Madje, kjo kërkesë mund ta privojë atë nga thelbi i tij, duke qenë se neni 5 § 3 ka për qëllim mbrojtjen e individit kundër mbajtjes arbitrare, duke kërkuar që akti i privimit të lirisë t'i nënshtrohet një kontrolli juridiksional të pavarur (Aquilina kundër Maltës [GC], § 49; Niedbała kundër Polonisë, § 50).

136. Karakteri automatik i kontrollit është i nevojshëm për të arritur qëllimin e këtij paragrafi, duke qenë se një person i cili është subjekt i keqtrajtimit mund të gjendet në pamundësi për t'iu drejtuar gjykatësit lidhur me kërkesën për kontrollin e ligjshmërisë së ndalimit të tij; e njëjta gjë mund të ndodhë edhe për një kategori vulnerabel personash të arrestuar, siç janë personat me aftësi të kufizuara mendore ose personat të cilët nuk flasin të njëjtën gjuhë me gjykatësin (McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 34; Ladent kundër Polonisë, § 74).

3. Caktimi i magjistratit kompetent

137. Shprehja “një gjykatës ose një magjistrat tjetër i autorizuar me ligj për të ushtruar funksionet gjyqësore” është sinonim me “autoritetin gjyqësor kompetent”, në kuptim të nenit 5 § 1 c) (Schiesser kundër Zvicrës, § 29).

138. Ushtrimi i “funsioneve gjyqësore” nuk është domosdoshmërisht i kufizuar me faktin e gjykimit. Neni 5 § 3 përfshin magjistratët e prokurorisë së përgjithshme si dhe ata të rretheve (ibidem, § 28).

139. “Magjistrati” që referohet në nenin 5 § 3 duhet të ofrojë garancitë e duhura dhe të përshtatshme ndaj funksioneve “gjyqësore” që i janë caktuar me ligj (ibidem, § 30).

140. Garancitë formale dhe të dukshme të përcaktuara në "ligj", në ndryshim me praktikën e zakonshme, janë veçanërisht të rëndësishme në përcaktimin e autoritetit gjyqësor i cili do të vendosë mbi lirinë e një individi (Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 60; De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Vendeve të Ulëta, § 48).

141. Në rastin kur “magjistrati” nuk ngatërrohet me “gjykatësin”, ai duhet të zotërojë disa prej cilësive të tij, domethënë të përmbushë kushtet që përbëjnë po aq garanci për personin e arrestuar (Schiesser kundër Zvicrës, § 31).

4. Pavarësia

142. Kushti i parë është pavarësia kundrejt ekzekutivit dhe palëve. Ajo nuk përjashton ndonjë nënshtim karshi gjykatësve ose magjistratëve të tjerë, me kusht që vetë ata të gëzojnë një pavarësi të ngjashme (ibidem).

143. Një magjistrat kompetent që vendos mbi paraburgimin mund të përmbushë gjithashtu edhe funksione të tjera, por paanësia e tij rrezikon të frymëzojë palët ndërgjyqësore me dyshime të ligjshme, nëse ai vepron në procedurën pasuese si një palë në procedim (Huber kundër Zvicrës, § 43; Brincat kundër Italisë, § 20).

144. Në këtë aspekt, mbahen parasysh paraqitjet objektive që ekzistojnë në datën e marrjes së vendimit të paraburgimit: nëse rezulton se në atë kohë “magjistrati i autorizuar me ligj për të ushtruar funksionet gjyqësore” mund të ndërhyjë në një stad të mëvonshëm të instancës penale si përfaqësues i autoritetit të ndjekjes, mund të lindin dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij (ibidem, § 21; Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 57; Nikolova kundër Bullgarisë [GC], § 49; Pantea kundër Rumanisë, § 236).

5. Kërkesa formale

145. Kërkesa formale e ngarkon “magjistratin” me detyrimin për ta dëgjuar personalisht individin e paraqitur para tij, përpara se ai të marrë vendimin që nevojitet (Schiesser kundër Zvicrës, § 31; De Jong, Baljet dhe Van den Brink kundër Vendeve të Ulëta, § 51; Nikolova kundër Bullgarisë, § 49; Aquilina kundër Maltës [GC], § 50).

146. Prania e një avokati në seancën dëgjimore nuk është e detyrueshme (Schiesser kundër Zvicrës, § 36). Megjithatë, përjashtimi i një avokati nga seanca dëgjimore mund të cenojë aftësinë e kërkuarit në paraqitjen e argumenteve të tij (Lebedev c. Russie, §§ 83-91).

6. Kërkesa për themelin (motivimi)

a) Kontrolli i themelit mbi paraburgimin

147. Kërkesa për themel e detyron “magjistratin” të shqyrtojë rrethanat që veprojnë në favor ose jo të paraburgimit dhe të shprehet sipas kriterëve juridike mbi ekzistencën e arsyeve që e justifikojnë këtë gjë (Schiesser kundër Zvicrës, § 31; Pantea kundër Rumanisë, § 231). Thënë ndryshe, neni 5 § 3 e detyron magjistratin të shqyrtojë me themel paraburgimin (Aquilina kundër Maltës [GC], § 47; Krejčír kundër Republikës Çeke, § 89).

148. Kontrolli fillestar automatik që ka të bëjë me arrestimin apo ndalimin duhet të lejojë shqyrtimin e çështjeve të rregullshmërisë dhe njohjen e ekzistencës së arsyeve të mundshme/të besueshme për të dyshuar se personi i arrestuar ka kryer një vepër penale, domethënë nëse paraburgimi përfshihet nga përjashtimet e autorizuara të listuara në nenin 5 § 1 c) (McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 40; Oral dhe Atabay kundër Turqisë, § 41).

149. Çështjet, për të cilat magjistratit i kërkohet të vendosë, shkojnë përtej asaj të ligjshmërisë. Përsa i takon përcaktimit nëse privimi i lirisë së një personi është i justifikuar, kontrolli i kërkuar nga neni 5 § 3 duhet të jetë mjaft i gjerë në mënyrë që ai të përfshijë rrethanat e ndryshme që janë në favor ose disfavor të paraburgimit (Aquilina kundër Maltës [GC], § 52).

150. Në varësi të rrethanave të veçanta të rastit, shtrirja e kontrollit të ligjshmërisë mund të jetë më e kufizuar se terreni i nenit 5 § 4 (Stephens kundër Maltës (nr. 2), § 58).

c) Pushteti/kompetenca për të urdhëruar lirimin

151. Nëse nuk ka asnjë arsye për të justifikuar paraburgimin, “magjistrati” duhet të ketë pushtetin/kompetencën për të urdhëruar lirimin e të paraburgosurit (Assenov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, § 146; Nikolova kundër Bullgarisë, § 49; Niedbała kundër Polonisë, § 49; McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 40).

152. Për të minimizuar vonesat, do të ishte shumë e dëshirueshme që gjyqtari që procedon me kontrollin e parë automatik të ligjshmërisë të privimit të lirisë dhe të ekzistencës së një arsyeje për paraburgim të ketë gjithashtu edhe pushtetin/kompetencën e shqyrtimit të çështjes për lirimin e përkohshëm. Megjithatë, kjo nuk është një kërkesë e Konventës dhe nuk ka asnjë arsye parimore përse këto çështje nuk mund të shqyrtohen nga dy magjistratë, brenda kohës së kërkuar. Sidoqoftë, nuk mund të avancojmë me një interpretim që do të donte që shqyrtimi për lirimin e përkohshëm të kryhet brenda një periudhe sa më të shkurtër, krahasuar me kontrollin e parë automatik, për të cilin Gjykata ka përcaktuar një afat maksimal prej katër ditësh (ibidem, § 47).

C. E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u liruar gjatë procedurës (neni 5 § 3)

Neni 5 § 3

“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur, në kushtet e parashikuara në paragrafin 1 (c) të këtij neni (...), ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund t'i nënshtrohet një garancie që siguron paraqitjen e të interesuarit në seancë.”

1. Periudha që duhet marrë në konsideratë

153. Për të përcaktuar kohëzgjatjen e një paraburgimi të përkohshëm sipas nenit 5 § 3, periudha që duhet marrë në konsideratë fillon ditën në të cilën i akuzuari është burgosur dhe përfundon ditën në të cilën është caktuar akuza, kjo edhe në shkallën e parë (shiko, për shembull, Solmaz kundër Turqisë, §§ 23-24; Kalashnikov kundër Ruisë, § 110; VVemhoff kundër Gjermanisë, § 9).

154. Duke pasur parasysh lidhjen themelore ndërmjet paragrafit 3 dhe paragrafit 1 c) të nenit 5 të Konventës, një individ i dënuar në shkallë të parë nuk mund të konsiderohet si i paraburgosur me qëllim që "të paraqitet përpara autoritetit gjyqësor kompetent, në rastin kur ka arsye të mundshme/të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale", në kuptim të kësaj dispozite të fundit: ai gjendet në situatën e parashikuar në nenin 5 § 1 a), që autorizon privimin e lirisë "pas dënimit nga një gjykatë kompetente" (shiko, në mesin e rasteve të shumta të mësipërme, Belevitskiy kundër Ruisë, § 99; Piotr Baranovvski kundër Polonisë, § 45; Górski kundër Polonisë, § 41).

2. Parime të përgjithshme

155. Pjesa e dytë e nenit 5 § 3 nuk i ofron autoriteteve gjyqësore asnjë mundësi midis gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe lirimit të përkohshëm. Deri në dënimin e tij, personi i akuzuar duhet të konsiderohet i pafajshëm dhe dispozita e analizuar ka për objekt kryesisht të imponojë lirimin e përkohshëm sapo paraburgimi pushon së qenuri i arsyeshëm.

156. Vazhdimi i paraburgimit nuk mund të justifikohet për një rast të caktuar, vetëm nëse treguesit konkretë kanë të bëjnë me një kërkesë të mirëfilltë me interes publik që mbizotëron, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, mbi rregullën e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të Konventës.

157. I takon në rradhë të parë autoriteteve gjyqësore kombëtare të sigurojnë që për një çështje të caktuar paraburgimi i përkohshëm për një person të akuzuar të mos tejkalojë një kohëzgjatje të arsyeshme. Për këtë qëllim, atyre u duhet, duke pasur parasysh parimin e prezumimit të pafajësisë, të shqyrtojnë të gjitha rrethanat që manifestojnë ose shmangin ekzistencën e kërkesës për interes publik që justifikon shkeljen nga rregulli i përcaktuar nga neni 5 dhe të raportojnë mbi to në vendimet e tyre lidhur me kërkesat për lirim. Gjykata duhet të përcaktojë nëse ka patur ose jo shkelje të nenit 5 § 3, kryesisht duke u bazuar tek

arsyet e dhëna gjatë vendimeve dhe duke u bazuar tek faktet e padiskutueshme që paraqet i interesuari përmes mjeteve të tij.

158. Persistimi/këmbëngulja tek arsyet e mundshme/të besueshme për të dyshuar se personi i arrestuar ka kryer vepër penale është një kusht sine qua non i rregullshmërisë së mbajtjes në paraburgim, por pas një periudhe të caktuar kohore kjo gjë nuk është më e mjaftueshme. Atëherë, Gjykata duhet të vendosë nëse arsyet e tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të legjitimojnë privimin e lirisë. Kur ato provohen se janë "relevante" dhe "të mjaftueshme", ajo kërkon gjithashtu të konstatojë nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar një "kujdes të veçantë" për vazhdimin e procedurës.

159. Si përfundim, juridiksionet e brendshme duhet të ushtrojnë një kontroll lidhur me mbajtjen në paraburgim të përkohshëm të një personi me qëllim garantimin e liritë të tij në rastin kur rrethanat nuk e justifikojnë më privimin e lirisë së tij. Të paktën, gjatë një periudhe fillestare, ekzistenca e dyshimeve të arsyeshme mund ta justifikojë paraburgimin, por vjen një kohë kur këto të fundit nuk janë më të mjaftueshme. Duke pasur parasysh se karakteri i arsyeshëm i periudhës së paraburgimit nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe se ai duhet të verifikohet për secilin rast në funksion të veçantive të tij, mund të themi se nuk ekziston asnjë kohë fikse e zbatueshme për secilin rast (McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], §§ 41-45; Bykov kundër Rusisë [GC], §§ 61-64; Idalov kundër Rusisë [GC], §§ 139-141; shiko gjithashtu Labita kundër Italisë [GC], §§ 152-153, dhe Kudła kundër Polonisë [GC], §§ 110-111).

160. Arsyet pro dhe kundër liritë duhet të mos jenë "të përgjithshme dhe abstrakte" (Boicenco kundër Moldavisë, § 142; Khoudoïorov kundër Rusisë, § 173), por duhet të bazohen mbi fakte të sakta si dhe tek rrethanat personale të kërkuarit që justifikojnë paraburgimin e tij (Aleksanyan kundër Rusisë, § 179).

161. Mbajtja pothuajse automatike në paraburgim është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara në nenin 5 § 3 (Tase kundër Rumanisë, § 40).

162. Barra e provës nuk duhet të përmbysët për ta ngarkuar personin e paraburgosur me detyrimin për të provuar ekzistencën e arsyeve të liritë (Bykov kundër Rusisë [GC], § 64).

163. Në rastin kur ekzistojnë rrethana të cilat mund të justifikojnë paraburgimin e një personi, por që nuk përmenden në vendimet e juridiksioneve të brendshme, nuk i takon Gjykatës që të vendosë për to dhe të marrë rolin e autoriteteve kombëtare të cilat kanë vendosur për paraburgimin e kërkuarit (ibidem, § 66; Giorgi Nikolaishvili kundër Gjeorgjisë, § 77). Kontrolli publik mund të ushtrohet mbi administratën e drejtësisë vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar (Tase kundër Rumanisë, § 41).

3. Arsyet e mbajtjes në paraburgim

164. Jurisprudenca që rrjedh nga Konventa ka identifikuar katër arsye kryesore të pranueshme për të refuzuar lirimin me kusht: a) rreziku se i akuzuari nuk do të paraqitet në

procesin e tij dhe b) rreziku që, nëse ai lirohet, i akuzuari do të ndërmarrë një veprim në dëm të administratës së drejtësisë, c) kryerje të veprave të reja penale ose d) prishje të rendit publik (Tiron kundër Rumanisë, § 37; Smirnova kundër Rusisë, § 59; Piruzyan kundër Armenisë, § 94).

a) Rreziku i largimit

165. Rreziku i largimit nuk mund të vlerësohet vetëm në bazë të peshës së dënimit që mund të merret. Ai duhet të jetë në funksion të një numri faktorësh të tjerë të rëndësishëm që do të bëjnë të mundur qoftë konfirmimin e ekzistencës së një rreziku të tillë, qoftë paraqitjes së tij në një formë aq të dobët sa paraburgimi nuk mund të justifikohet (Panchenko kundër Rusisë, § 106).

166. Rreziku i largimit duhet të vlerësohet në dritën e faktorëve që kanë të bëjnë me personalitetin e të interesuarit, në kuptimin moral të tij, me vendbanimin e tij, me profesionin e tij, me burimet e tij, me lidhjet e tij familjare dhe llojet e tjera të lidhjeve me vendin në të cilin ai ndiqet (Becciev kundër Moldavisë, § 58).

167. Mungesa e një vendbanimi të caktuar nuk përbën në vetvete një rrezik për t'u larguar (Sulaoja kundër Estonisë, § 64)

168. Rreziku i largimit zvogëlohet domosdoshmërisht me kalimin e kohës së kaluar në paraburgim (Neumeister kundër Austrisë, § 10).

169. Edhe nëse pesha e dënimit që rrezikohet mund të merret parasysht në përcaktimin nëse i akuzuari rrezikon t'i shmanget drejtësisë, ajo nuk mund të përdoret për të justifikuar periudhat e gjata të paraburgimit të përkohshëm (Idalov kundër Rusisë [GC], § 145; Garycki kundër Polonisë, § 47; Chraidi kundër Gjermanisë, § 40; Ilijkov kundër Bullgarisë, §§ 80-81).

170. Edhe pse, në mënyrë të përgjithshme, "gjendja e provave" është një element që mund të merret parasysht në përcaktimin nëse kanë ekzistuar ose ekzistojnë gjithmonë tregues seriozë të fajësisë, ajo nuk mund të justifikojë kohën e gjatë të paraburgimit (Dereci kundër Turqisë, § 38).

b) Pengesë për drejtësinë

171. Rreziku që i akuzuari mund të bëhet pengesë për mbarëvajtjen e drejtësisë nuk mund të përdoret në kuptimin abstrakt: ai duhet të mbështetet me prova faktike (Becciev kundër Moldavisë, § 59).

172. Rreziku i presioneve ndaj dëshmitarëve është i pranueshëm në fazat fillestare të procedurës (Jarzynski kundër Polonisë, § 43).

173. Sidoqoftë, në fund fare, kërkesat e hetimit bëhen të pamjaftueshme për të justifikuar paraburgimin e një të dyshuari: normalisht, rreziqet e supozuara humbasin/fshihen me

kalimin e kohës, ndërkohë që kemi arritur të kemi hetime të përfunduara, depozitime të regjistruara dhe verifikime të kryera (Clooth kundër Belgjikës, § 43).

c) Recidivizmi

174. Rëndësia/pesha e një akuze mund të bëjë që autoritetet gjyqësore ta lënë të dyshuarin në paraburgim të përkohshëm me qëllim parandalimin e përpjekjeve për vepra të reja penale. E nevojshme është që rrethanat e rastit, dhe veçanërisht rastet e mëparshme dhe personaliteti i të interesuarit të bëjnë që rreziku të jetë i besueshëm/i mundshëm dhe masa të jetë e përshtatshme (ibidem, § 40).

175. Dënimet e mëparshme mund të krijojnë një frikë/alarm të arsyeshme se i akuzuari do të kryejë një vepër të re penale (Selçuk kundër Turqisë, § 34; Matznetter kundër Austrisë, § 9).

176. Nuk mund të arrihet në konkluzionin se një person që nuk ka as punë, as familje, ai rrezikon të kryejë vepra të reja penale (Sulaoja kundër Estonisë, § 64).

d) Ruajtja e rendit publik

177. Është e njohur se, për shkak të rëndësisë së tyre të veçantë dhe reagimit të publikut ndaj kryerjes së tyre, disa vepra të caktuara penale mund të shkaktojnë shqetësime sociale të tilla që të justifikojnë një paraburgim të përkohshëm, të paktën për një periudhë kohore. Në rrethana të jashtëzakonshme, ky element mund të merret në konsideratë sipas Konventës, të paktën për aq sa legjislacioni i brendshëm njeh nocionin e prishjes/shqetësimit të rendit publik që shkaktohet nga një vepër penale.

178. Megjithatë, arsyetimi i drejtë dhe i mjaftueshëm mund të vlerësohet vetëm nëse ai bazohet në fakte të tilla që tregojnë se lirimi i të paraburgosurit do të përbënte me të vërtetë një shqetësim për rendin publik. Për më tepër, paraburgimi mbetet legjitim vetëm nëse rendi publik vazhdon tjetë efektivisht i kërcënuar; vazhdimësia e paraburgimit nuk mund të përdoret për të parashikuar një dënim me burg (Letellier kundër Francës, § 51; I.A. kundër Francës, § 104; Prencipe kundër Monakos, § 79; Tiron kundër Rumanisë, §§ 41-42).

4. Kujdesi i veçantë

179. Kompleksiteti dhe veçoritë e hetimit janë elementët që duhet të merren parasysh për të shqyrtuar nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar një "kujdes të veçantë" në ndjekjen e e procedurës (Scott kundër Spanjës, § 74).

180. Shpejtësia e veçantë me të cilën një i akuzuar i paraburgosur ka të drejtë për të shqyrtuar çështjen e tij nuk duhet të dëmtojë përpjekjet e magjistratëve që ata të kryejnë detyrën e tyre me kujdesin e duhur (Shabani kundër Zvicrës, § 65; Sadegül Özdemir kundër Turqisë, § 44).

5. Masat alternative

181. Në rastin kur autoritetet vendosin nëse një person duhet liruar ose duhet të jetë i paraburgosur, ato duhet të shqyrtojnë nëse ka masa të tjera për të siguruar paraqitjen e tij në proces (Idalov kundër Ruisë [GC], § 140). Neni 5 § 3 jo vetëm që sanksionon "të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës", por ai parashikon gjithashtu se "lirimi mund t'i nënshtrohet një garancie që siguron paraqitjen e të interesuarit në seancë" (Khoudoïorov kundër Ruisë, § 183; Lelièvre kundër Belgjikës, § 97; Shabani kundër Zvicrës, § 62).

6. Lirimi me kusht

182. Garancia e parashikuar në nenin 5 § 3 të Konventës nuk është që të sigurojë dëmshpërblimin e dëmit, por në veçanti paraqitjen e të akuzuarit në seancë. Prandaj, shumica e dëmshpërblimit duhet të vlerësohet kryesisht "lidhur me të interesuarin, burimet e tij, lidhjet e tij me personat e thirrur që do shërbejnë si garanci dhe, mbi të gjitha, me besimin se perspektiva nga humbja e garancisë ose nga ekzekutimi i garancisë në rast të mosparaqitjes së tij në seancë do të jetë për të një frenim i mjaftueshëm për të shmangur çdo përpjekje për t'u larguar" (Mangouras kundër Spanjës [GC], § 78; Neumeister kundër Austrisë, § 14).

183. Garancia mund të kërkohej vetëm për atë kohë sa mbizotërojnë arsyet që justifikojnë paraburgimin (Muşuc kundër Moldavisë, § 42, Aleksandr Makarov kundër Ruisë, § 139). Nëse rreziku për t'u larguar mund të shmanget me një kusht ose një garanci tjetër, i akuzuari duhet të lirohet, duke ditur se nëse avancohet me një dënim më të lehtë, kjo gjë zvogëlon rrezikun e largimit dhe duhet të merret në konsideratë (Vrenčev kundër Serbisë, § 76). Autoritetet duhet të bëjnë sa më shumë kujdes që të caktojnë një garanci të përshtatshme se sa të vendosin nëse mbajtja e një personi të akuzuar në paraburgim është apo jo e nevojshme (shiko, në rastet e tjera të mëparshme, Piotr Osuch kundër Polonisë, § 39; Bojilov kundër Bullgarisë, § 60; Skrobol kundër Polonisë, § 57).

184. Përveç kësaj, shumica e garancisë duhet të justifikohet në mënyrën e duhur në vendimin që e përcakton atë (Georgieva kundër Bullgarisë, §§ 15 et 30-31) dhe të mbahen parasysh burimet e të interesuarit (Hristova kundër Bullgarisë, § 111) si dhe aftësive të tij paguese (Toshev kundër Bullgarisë, §§ 69-73). Në disa rrethana, marrja në konsideratë e madhësisë së dëmit mund të mos jetë e paarsyeshme (Mangouras kundër Spanjës [GC], §§ 81 et 92).

185. Refuzimi automatik i garancisë në zbatim të ligjit, në mungesë të çdo lloj kontrolli nga ana e gjykatësit, ëshë i papajtueshëm me garancitë e nenit 5 § 3 (Piruzyan kundër Armenisë, §105; S.B.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar, §§ 23-24).

7. Justifikimi për çdo periudhë të paraburgimit

186. Neni 5 § 3 nuk mund të interpretohet si një autorizim pa kushte i paraburgimit të përkohshëm, me kusht që ai të mos tejkalojë një kohëzgjatje minimale të caktuar. Autoritetet duhet të demonstrojnë në mënyrë bindëse se çdo periudhë e paraburgimit, sado

e shkurtër qoftë ajo, duhet të justifikohet (Idalov kundër Ruisë [GC], § 140; Tase kundër Rumanisë, § 40; Castravet kundër Moldavisë, § 33; Belchev kundër Bullgarisë, § 82).

8. Paraburgimi i përkohshëm i minorenëve

187. Një minoren mund të paraburgoset vetëm në rastin më të fundit: ky paraburgim duhet të jetë sa më i shkurtër i mundshëm dhe, në rastin kur ai është tepër i domosdoshëm, minorenët duhet të ndahen nga adultët (Nart kundër Turqisë, § 31; Güveç kundër Turqisë, § 109).

D. E drejta për një vendim të shpejtë të gjykatës mbi ligjshmërinë e paraburgimit (article 5 § 4)

Neni 5 § 4

« 4. Çdo person i privuar nga liria e tij me arrestim ose me paraburgim ka të drejtë të paraqesë një rekurs përpara gjykatës, me qëllim që gjykata të vendosë brenda një afati të shkurtër mbi ligjshmërinë e paraburgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin e tij nëse paraburgimi është i paligjshëm.»

1. Qëllimi i dispozitës

188. Neni 5 § 4 është l'habeas corpus i Konventës. Ai i njeh çdo të paraburgosuri të drejtën për të urdhëruar me shpejtësi kontrollin e paraburgimit të tij nga ana e një gjykatësi (Mooren kundër Gjermanisë [GC], § 106; Rakevich kundër Ruisë, § 43).

189. Fakti i moskonstatimit të asnjë mangësie ndaj kërkesave të paragrafit 1 të nenit 5 nuk e përjashton Gjykatën që të shqyrtojë paragrafin 4: bëhet fjalë për dy dispozita të veçanta dhe repektimi i të parës nuk kërkon me domosdoshmëri respektimin e të dytës (Douiyebe kundër Vendeve të Ulëta [GC], § 57; Kolompar kundër Belgjikës, § 45).

2. Natyra e kontrollit të kërkuar

190. Sipas nenit 5 § 4, çdo person i arrestuar ose i paraburgosur ka të drejtë e shqyrtimit nga ana e gjyqtarit të respektimit të kërkesave procedurale dhe të themelit që janë të nevojshme për "rregullshmërinë" e privimit të tij, në kuptim të nenit 5 § 1 të Konventës (shiko, tek rastet e mëparshme, Idalov kundër Ruisë [GC], § 161; Reinprecht kundër Austrisë, § 31).

Nocioni i "rregullshmërisë" në kuptim të nenit 5 § 4 ka të njëjtin kuptim si ai i nenit 5 § 1, edhe pse çdo person i arrestuar ose i paraburgosur ka të drejtë të kërkojë kontrollin e rregullshmërisë jo vetëm nën dritën e kërkesave të së drejtës së brendshme, por edhe të Konventës, parimeve të përgjithshme që parashtrohen aty dhe të qëllimit të kufizimeve të lejuara nga neni 5 § 1 (Suso Musa kundër Maltës, § 50).

191. Mënyrat e kontrollit gjyqësor që plotësojnë kërkesat e nenit 5 § 4 mund të ndryshojnë nga një fushë tek tjetra dhe varen nga lloji i privimit të lirisë (M.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 75).

192. Nuk përjashtohet që sistemi i rishqyrtimit automatik periodik për rregullshmërinë e një paraburgimi nga ana e gjykatës të mund të garantojë respektimin e kërkesave të nenit 5 § 4. Megjithatë, për aq kohë sa ka filluar një kontroll automatik, vendimet që kanë të bëjnë me rregullshmërinë e paraburgimit duhet të ndjekin “intervale të arsyeshme” (Abdulkhanov kundër Rusisë, §§ 209 dhe 212-214, për një vlerësim të jurisprudencës në fushën e paraburgimit sipas paragrafëve a), c), e) dhe f) të nenit 5 § 1).

193. Nëse një person paraburgoset në kuptim të nenit 5 § 1 c), “gjykata” duhet të shqyrtojë nëse ka apo jo elementë të mjaftueshëm për të patur një dyshim të arsyeshëm se personi në fjalë ka kryer një vepër penale, sepse ekzistenca e një dyshimi të tillë është thelbësore për “ligjshmërinë” e paraburgimit të tij kundrejt Konventës (Nikolova kundër Bullgarisë [GC], § 58).

194. Për aq kohë sa një person është i privuar nga liria si rezultat i shpalljes së dënimit nga një gjykatë kompetente, kontrolli i kërkuar nga neni 5 § 4 gjendet i mishëruar në vendimin e dhënë në përfundim të procesit (De Vilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës, § 76) dhe nuk kërkohet asnjë kontroll tjetër. Megjithatë, në rastin kur arsyeja që justifikon privimin e lirisë mund të ndryshojë me kalimin e kohës, duhet të ekzistojë mundësia e një rekursi përpara një organi që përmbush kërkesat e nenit 5 § 4 (Kafkaris kundër Qipros (vendim), § 58).

195. Neni 5 § 4 i lejon çdo të paraburgosuri që t’i kërkojë një “gjykatë” kompetente të vendosë “brenda një afati të shkurtër” nëse privimi i tij i lirisë është bërë ose jo “i parregullt” nën dritën e elementëve të reja që kanë dalë si pasojë e vendimit fillestar që ka urdhëruar këtë masë (Abdulkhanov kundër Rusisë, § 208; Azimov kundër Rusisë, §§ 151-152).

196. Çdo i burgosur në një institut psikiatrik për një periudhë të gjatë kohore duhet të ketë mundësinë e kundërshtimit para drejtësisë “në intervale të arsyeshme” të rregullshmërisë së paraburgimit të tij (M.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 77). Sistemi i kontrollit periodik vetëm me iniciativën e autoriteteve nuk është i mjaftueshëm (X. kundër Finlandës, § 170; Raudevs kundër Letonisë, § 82).

197. Kriteret e “rregullshmërisë” së një “paraburgimi” në kuptim të nenit 5 § 1 e) kërkojnë që shqyrtimi i rregullshmërisë, garantuar nga neni 5 § 4 lidhur me mbajtjen në burgim të një pacienti mendor, duhet të bazohet mbi gjendjen aktuale shëndetësore të pacientit, duke përfshirë ose jo rrezikshmërinë e tij, ashtu siç rezulton nga ekzaminimet mjekësore të përditësuara dhe jo mbi ngjarjet që kanë qenë në origjinë të vendimit mbi paraburgimin e tij fillestar (Juncal kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim), § 30; Ruiz Rivera kundër Zvicrës, § 60 ; H.VV. kundër Gjermanisë, § 107).

198. Me “gjykatë” ndaj së cilës i paraburgosuri duhet të ketë akses, neni 5 § 4 nuk nënkupton domosdoshmërisht një juridiksion të tipit klasik, të integruar në strukturat gjyqësore të zakonshme të vendit (VWeeks kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 61). Kjo gjykatë duhet të jetë, megjithatë, një organ “me natyrë gjyqësore” që ofron disa garanci të

caktuara procedurale. Pra, ajo duhet të jetë e pavarur jo vetëm nga ekzekutivi, por edhe nga palët në mosmarrëveshje (Stephens kundër Maltës (nr. 1), § 95).

199. Për të përmbushur kërkesat e Konventës, kontrolli i gjykatësit kombëtar duhet të respektojë normat bazë të formës së legjislacionit kombëtar dhe të ushtrohet në përputhje me qëllimin e nenit 5: mbrojtja e individit kundrejt arbitraritetit (Koendjbiharie kundër Vendeve të Ulëta, § 27).

200. Neni 5 § 4 nuk i detyron shtetet kontraktuese të vendosin një shkallë të dyfishtë juridiksioni për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit. Megjithatë, një shtet që ka një sistem të tillë duhet parimisht t'i njohë të paraburgosurve të njëjtat garanci si në apel, ashtu edhe në shkallën e parë (Kuçera kundër Sllovakisë, § 107; Navarra kundër Francës, § 28; Toth kundër Austrisë, § 84)

201. Neni 5 § 4 i Konventës nuk nënkupton që gjykatësi që shqyrton një rekurs kundër paraburgimit të ketë detyrimin për të studjuar secilin prej argumenteve të parashtruara nga i burgosuri. Megjithatë, gjykatësi nuk mund të konsiderojë si të parëndësishme ose të mos marrë parasysh faktet konkrete të përmendura nga i paraburgosuri, të cilat mund të jenë në gjendje të hedhin një dyshim mbi ekzistencën e kushteve të domosdoshme për "ligjshmërinë" e privimit të lirisë, në kuptim të Konventës (Ilijkov kundër Bullgarisë, § 94).

202. "Gjykata" duhet të ketë mundësinë për të urdhëruar lirim nëse ajo gjykon se paraburgimi është i paligjshëm: vetëm një mundësi rekomandimi është e pamjaftueshme (Benjamin dhe VWilson kundër Mbretërisë së Bashkuar, §§ 33-34).

3. Garancitë procedurale

203. Kërkesa për drejtësi procedurale që rrjedh nga neni 5 § 4 nuk kërkon zbatimin e kriterëve uniforme dhe të pandryshueshme në varësi të kontekstit, fakteve dhe rrethanave të rastit. Nëse një procedurë që ka të bëjë me nenin 5 § 4 nuk duhet të shoqërohet gjithnjë me garanci të njëjta me ato që parashikon neni 6 për mosmarrëveshjet civile ose penale, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe duhet t'i ofrojë individit që është i dyshuar garanci të përshtatura me natyrën e privimit të lirisë për të cilin ai ankohet (A. dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 203; Idalov kundër Rusisë [GC], § 161).

204. Për çdo person, paraburgimi i të cilit ka të bëjë me fushën e zbatimit të nenit 5 § 1 c), seanca është e detyrueshme (Nikolova kundër Bullgarisë [GC], § 58). Mundësia për një të paraburgosur që të dëgjohet vetë ose nëpërmjet një forme të caktuar përfaqësimi është në disa raste një nga garancitë thelbësore të procedurës që zbatohen në fushën e privimit të lirisë (Kampanis kundër Greqisë, § 47).

Megjithatë, neni 5 § 4 nuk kërkon që një i paraburgosur të dëgjohet çdo herë që ai paraqet një rekurs kundër mbajtjes së tij në paraburgim, por ai duhet të ketë mundësinë të ushtrojë në intervale të arsyeshme të drejtën për t'u dëgjuar (Çatal kundër Turqisë, § 33; Altınok kundër Turqisë, § 45).

205. Procedura duhet të jetë kontradiktore dhe duhet të garantojë në të gjitha rastet “barazinë e armëve” midis palëve (Reinprecht kundër Austrisë, § 31; A.dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], § 204). Në rastet e paraburgimit të përkohshëm, i dyshuari që është privuar nga liria duhet të shikojë se atij i ofrohet një rast i vërtetë për të kundërshtuar elementët fillestarë të akuzave në ngarkim të tij sepse qëndrueshmëria tek dyshimet e arsyeshme se ai ka kryer një vepër penale është një kusht sine qua non i ligjshmërisë të mbajtjes së tij në paraburgim. Kjo kërkesë mund ta detyrojë Gjykatën kompetente të dëgjojë dëshmitarët, depozitimet e të cilëve duken, në pamje të parë, se kanë një efekt vendimtar mbi ligjshmërinë e mbajtjes në paraburgim (Turcan kundër Moldavisë, §§ 67-70).

Barazia e armëve nuk garantohet nëse kërkuesit ose avokatit të tij i mohohet aksesit tek elementët e dosjes hetimore, të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë efektive rregullshmërinë e paraburgimit (Ovsjannikov kundër Estonisë, § 72; Fodale kundër Italisë; Korneykova kundër Ukrainës, § 68). Ndonjëherë, është po aq e nevojshme që i interesuari të ketë jo vetëm mundësinë për t’u dëgjuar personalisht, por ai duhet të përfitojë nga ndihma efektive e avokatit të tij (Cernák kundër Sllovakisë, § 78).

206. Parimet e kontradiktarit dhe barazisë së armëve duhet të respektohen në apel si njëri, ashtu edhe tjetri (Çatal kundër Turqisë, §§ 33-34 dhe çështjet që janë përmendur aty).

4. Kërkesa për “shpejtësi”

207. Duke u garantuar të paraburgosurve rekursin për të kundërshtuar rregullshmërinë e burgimit të tyre, neni 5 § 4, si rezultat i krijimit të një procedure të tillë, parashikon për ta të drejtën për të patur brenda një afati të shkurtër një vendim gjyqësor lidhur me rregullshmërinë e paraburgimit të tyre dhe duke i dhënë fund këtij paraburgimi nëse ai rezulton të jetë i paligjshëm (Idalovkc. Ruisë [GC], § 154; Baranoëski kundër Polonisë, § 68). Në çdo rast, është e nevojshme të vlerësohet nën dritën e rrethanave të rastit nëse e drejta për një vendim të shpejtë është respektuar sic duhet (Rehbock kundër Sllovenisë, § 84).

208. Mundësia e një rekursi në drejtësi duhet ofruar që me vendosjen në paraburgim të të interesuarit dhe, nëse është e domosdoshme, kjo gjë bëhet më pas në intervale të arsyeshme (Molotchko kundër Ukrainës, § 148; Varbanov kundër Bullgarisë, § 45; Kurt kundër Turqisë, § 123).

209. Shprehja «në një afat të shkurtër» («speedily» në anglisht) tregon një urgjencë më të vogël se fjala “menjëherë” («promptly» në anglisht) (E. kundër Norvegjisë, § 64; Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 59).

Megjithatë, në rastin kur vendimi që urdhëron paraburgimin e një personi është dhënë nga një autoritet jo gjyqësor dhe jo nga një gjykatë, kriteri për “shpejtësi” të kontrollit gjyqësor në kuptim të nenit 5 § 4 është më afër kriterit për “nxitim/shpejtësi” në kuptim të nenit 5 § 3 (Shcherbina kundër Ruisë, §§ 65-70, ku afati 16 ditor brenda të cilit gjykatësi duhet të

kontrollojë vendimin e prokurorit që urdhëron paraburgimin e kërkuar është konsideruar i tepërt.)

210. Kriteri i «shpejtësisë» është më pak strikt në rastin kur bëhet fjalë për procedurën para instancës së apelit (Abdulkhanov kundër Rusisë, § 198). Kur vendimi për paraburgimin fillestar është dhënë nga një gjykatë në një procedurë që ofron garanci të duhura për një proces të drejtë, Gjykata përgatitet të tolerojë afate më të gjata për rishqyrtim gjatë procedurës përpara juridiksionit të shkallës së dytë (Shcherbina kundër Rusisë, § 65).

a) Periudha që duhet marrë në konsideratë

211. Gjykata merr si pikë nisjeje datën e formulimit të kërkesës për lirim ose të paraqitjes së rekursit. Periudha që duhet marrë në konsideratë përfundon sapo të merret vendimi përfundimtar mbi ligjshmërinë e paraburgimit të kërkuar, duke përfshirë edhe apelin (Sanchez-Reisse kundër Zvicrës, § 54; E. kundër Norvegjisë, § 64).

212. Nëse një rekurs administrativ është i domosdoshëm përpara se ai të paraqitet para drejtësisë, afati fillon nga data e kërkesës së administratës (Sanchez-Reisse kundër Zvicrës, § 54).

213. Nëse procedura është dërguar para dy shkallëve të juridiksionit, ajo duhet të shqyrtohet në tërësinë e saj me qëllim që të përcaktohet nëse është respektuar kërkesa për “shpejtësi” (Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 78; Navarra kundër Francës, § 28).

b) Elementët që duhen marrë në konsideratë në shqyrtimin e respektimit të kërkesës për shpejtësi

214. Shprehja «brenda një afati të shkurtër» nuk mund të përkufizohet në kuptimin abstrakt. Ashtu si edhe kërkesa për “afat të arsyeshëm” që përmendet në nenet 5 § 3 dhe 6 § 1, është e detyrueshme që ne të kemi një vlerësim nën dritën e rrethanave të rastit (R.M.D. kundër Zvicrës, § 42).

215. Për të verifikuar nëse është respektuar kërkesa për afat të shkurtër që paraqitet tek neni 5 § 4 mund të merren në konsideratë elementë të krahasueshëm me ata që luajnë një rol në shqyrtimin e kërkesës së procesit brenda një afati të arsyeshëm tek neni 5 § 3 et 6 § 1, për shembull kujdesin e manifestuar nga autoritetet, vonesat e shkaktuara nga i paraburgosuri si dhe çdo element tjetër që ka çuar në vonesa dhe që nuk ka të bëjë me përgjegjësinë e shtetit (Mooren kundër Gjermanisë [GC], § 106; Kolompar kundër Belgjikës, § 42).

216. Nëse për çështjet që kanë të bëjnë me nenin 6 § 1 mund të konsiderojmë se një kohëzgjatje prej një viti për çdo shkallë të juridiksionit mund të shërbejë si një normë e përafërt, neni 5 & 4, i cili ka të bëjë me çështje të lirisë, kërkon një kujdes të veçantë (Panchenko kundër Rusisë, § 117). Duke qenë se vihet në lojë liria e një individi, Gjykata zbaton kritere shumë strikte për të përcaktuar nëse, ashtu siç e ka edhe detyrimin, shteti ka marrë vendim brenda një afati të shkurtër mbi rregullshmërinë e paraburgimit (shiko, për

shembull, Kadem kundër Maltës, §§ 44-45, ku Gjykata e gjykoi të tepërt afatin prej 17 ditësh për të vendosur mbi rregullshmërinë e paraburgimit të një kërkuesi, dhe Mamedova kundër Rusisë, § 96, ku afatet e shqyrtimit në apel – 26 ditë – u gjykuan se vinin në kundërshtim me kërkesën për “shpejtësi”).

217. Nëse kjo përpjekje ngre probleme komplekse – për shembull, gjendja shëndetësore e të paraburgosurit – këto të fundit mund të merren parasysh për të vlerësuar atë që përbën një kohëzgjatje “të arsyeshme” tek neni 5 § 4. Megjithatë, edhe në rastet komplekse, ka elementë që i detyrojnë autoritetet që të vendosin me një shpejtësi të veçantë, pikërisht prezumimi i pafajësisë kur bëhet fjalë për një paraburgim të përkohshëm (Frasik kundër Polonisë, § 6; Jablonski kundër Polonisë, §§ 91-93).

218. Paraburgim i përkohshëm për çështjet në fushën penale kërkon intervale të shkurtra ndërmjet rishqyrtimeve (Bezicheri kundër Italisë, § 21).

219. Nëse koha e marrë për të marrë vendim është a priori e papajtueshme me kërkesën për shpejtësi, Gjykata do t’i kërkojë shtetit që të shpjegojë këto vonesa ose t’i justifikojë ato nëpërmjet arsyeve të jashtëzakonshme (Musiał kundër Polonisë [GC], § 44; Koendjibiharie kundër Vendeve të Ulëta, § 29).

220. As ngarkesa e madhe e punës, as periudhat e pushimit nuk mund të justifikojnë periudhën e mosveprimit nga ana e autoriteteve gjyqësore (E. kundër Norvegjisë, § 66; Bezicheri kundër Italisë, § 25)